REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

# V E N D I M

**K.P.P. 217/2020**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

| | |
|---|---|
| Enkeleda Bega | Nënkryetar |
| Vilma Zhupaj | Anëtar |
| Lindita Skeja | Anëtar |
| Merita Zeqaj | Anëtar |

Në mbledhjen e datës 25.06.2020, shqyrtoi ankesën me:

**Objekt**: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e operatorit ekonomik "Alko Impex General Construction" d.sh.h. në procedurën e prokurimit "*Procedurë e hapur",* me nr. *REF-41658-10-30-2019*, Loti I, me objekt "*Shërbimi i pastrimit në Qytetin Vlorë",* me fond limit 584.587.476 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 06.01.2020, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.

**Ankimues:** Operatori ekonomik "Alko Impex General Construction" d.sh.h.
Rruga "Rreshit Petrela", Kompleksi Usluga, Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Vlorë
Sheshi "4 Heronjtë", Rruga "Osman Haxhiu", Vlorë

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 *"Për Prokurimin Publik",* i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik",* i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 "*Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*".

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**Vëren:**

**I**

*Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

**II**

*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 31.10.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit *"Procedurë e hapur",* me nr. *REF-41658-10-30-2019*, Loti I, me objekt "*Shërbimi i pastrimit në Qytetin Vlorë",* me fond limit 584.587.476 lekë (pa TVSH).

II.2. Në datën 06.01.2020, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.
Referuar informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor, në këtë procedurë prokurimi, kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë si më poshtë, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike përkatësisht:

| | | |
|---|---|---|
| 1. | "Alko Impex General Construction" d.sh.h. | 543.573.407 lekë, skualifikuar |
| 2. | "Duka" sh.p.k. | 581.685.822 lekë, kualifikuar |
| 3. | "Ante Group" sh.p.k. | nuk ka paraqitur ofertë ekonomike |

II.3. Në datën 10.02.2020 operatori ekonomik “Alko Impex General Construction” d.sh.h. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me arsyet si më poshtë vijon:

*- Në pikën 3.3.4 të kritereve të vecanta të kualifikimit për lotin 1 është përcaktuar: ”Subjekti te jete i pajisur me licence nga QKB për kategorinë III.1.A Leje e thjeshte mjedisore për Shërbimi i pastrimit dhe i largimit të mbeturinave urbane, Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme”. Për të përmbushur këtë kriter prej shoqërisë ”ALKO-IMPEX GENERAL CONSTRUCTION” është paraqitur Leje PN-0928- 10-2015 me Kod III.1.A e lëshuar prej QKL me emërtim përshkrues të veprimtarisë ”Leje mjedisi e tipit C: Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme” e shoqëruar me Akt Miratimi nr.370 prot datë 28.09.2015. Subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion që të vërtetojë se disponon leje nga QKB për kategorinë III.1.A me emërtimin “Leje e thjeshte mjedisore për Shërbimi i pastrimit dhe i largimit të mbeturinave urbane”.*

*- Në pikën 3.3.10 të kritereve të vecanta të kualifikimit për lotin 1 është përcaktuar: ” Subjekti ofertues duhet te jete i pajisur me autorizim ose leje për përdorimin e burimeve ujore, per efekt te perdorimit te ujit me te cilin do te kryhen sherbimet objekt i ketij prokurimi”. Për të përmbushur këtë kriter prej shoqërisë ”ALKO-IMPEX GENERAL CONSTRUCTION” është paraqitur*
*• Autorizim nr.239 prot datë 11.11.2019 i lëshuar prej ”Ujësjellës Kanalizime Devoll” sh.a ku përcaktohet se autorizon shoqërinë ”ALKO-IMPEX GENERAL CONSTRUCTION” për përdorimin e burimeve ujore nën administrimin e e kësaj shoqërie. Ky dokument nuk e plotëson kriterin e kualifikimit për dy arsye pasi së pari burimet ujore të ndërmarrjeve të ujësjellës kanalizime janë të pijshme dhe për pasojë subjekti duhet të tarifohet si për përdorimin e ujit të pijshëm, kurse përdorimi i ujit për shërbimet komunale duhet të kryhet nga burimet ujore sipas VKM nr.662 datë 21.09.2016, së dyti përdorimi i ujit me të cilin do të kryhen shërbimet objekt i këtij prokurimi nevojitet për qytetin e Vlorës, ndërkohë që autorizimi është për Bashkinë Devoll.*
*• Shkresë Kthim përgjigje nr.1505/1 prot datë 11.12.2019 e lëshuar prej Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore ku sqarohet shoqëria ”ALKO-IMPEX GENERAL CONSTRUCTION” se ”pas plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor të përcaktuar në VKM nr.416 datë 13.05.2015 duhet të aplikojë pranë Zyrës së Administrimit të Basenit Ujor përkatës dhe më tej miratohen pranë Këshillit të Basenit Ujor. Lejet apo autorizimet lëshohen për një afat të caktuar kohor, sipas parashikimeve të pikës 5 të VKM nr.416 datë 13.05.2015”. Subjekti ofertues shoqëria ”ALKO-IMPEX GENERAL CONSTRUCTION” nuk rezulton të ketë paraqitur ndonjë dokumentacionin pranë Zyrës së Administrimit të Basenit Ujor sipas sqarimeve në shkresë për tu pajisur me lejë apo autorizim për përdorimin e burimeve ujore. Në bazë të pikës 4/b të VKM nr.416 datë 13.05.2015 ku përcaktohet shprehimisht se ”Lejet dhe autorizimet për përdorimin e ujit shqyrtohen nga Këshilli i Basenit Ujor (KBU), referuar nenit 50, të ligjit nr. 111/2012, i cili merr vendim jo më vonë se 2 (dy) muaj, nga data e paraqitjes së kërkesës”.*

*Kjo procedurë prokurimi ka qenë e publikuar në SPE në datë 30.10.2019 dhe ofertat janë hapur në datë 06.01.2020, cka provon qartë se subjekti ofertues e ka patur kohën e nevojshme për të aplikuar për të përmbushur kriterin e kualifikimit.*

*- Në pikën 3.3.11 të kritereve të vecanta të kualifikimit për lotin 1 është përcaktuar: "Shoqeria ofertuese duhet te disponoje dokumentacion qe per realizimin e kesaj kontrate te kete keto mjete (ne pronesi ose qira). Keto mjete duhet te jene te pajisur me dokumentacion sipas legjislacionit ne fuqi. Per mjetet qe jane me qira duhet te paraqitet edhe kontrata e qirase me nje afat vlefshmerie jo me pak se nje vit. Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), policen e sigurimit, taksat vjetore te mjetit, si dhe lejen e transportit nga bashkia per vete ose te trete. Mjetet duhet te paraqiten ne formen e nje deklarate ku te percaktohen targat, lloji, numri i shasise." Dokumentacioni për të përmbushur këtë kriter i paraqitur prej shoqërisë "ALKO-IMPEX GENERAL CONSTRUCTION", për të gjitha mjetet e ngarkuar në SPE dhe të shoqëruar me deklaratën përkatëse, nuk përmban dokumentin për taksat vjetore te mjetit, sikurse përcaktohet në kriterin e kualifikimit për dokumentacionin që duhet të paraqesë.*

*- Në pikën 3.3.10 të kritereve të vecanta të kualifikimit për lotin 1 është përcaktuar: "Shoqeria ofertuese duhet te disponoje dokumentacion qe per realizimin e kesaj kontrate te kete keto mjete (ne pronesi ose qira): e. Autofshesa 3 cope (ne pronesi ose me qira) f. Mjet te posacem me goma qe kryen funksionin fshirje dhe larje njekohesisht 1 cope (ne pronesi ose me qira)" Bazuar në dokumentacionin e paraqitur në SPE prej shoqërisë "ALKO-IMPEX GENERAL CONSTRUCTION" dhe të shoqëruar me deklaratën përkatëse, ka paraqitur mjetet me targa AA198TI, AGMT47, AGMT48 për të përmbushur kriterin 3.3.10.e, si dhe ka paraqitur mjetin me targa AA857XM për të përmbushur kriterin 3.3.10.f. Sikurse u sqarua edhe më sipër për këto mjete nuk ka paraqitur dokumentin për taksat vjetore te mjetit, por nga verifikimet e kryera zyrtarisht në Autoritetet Kontraktore ku ky subjekt ushtron aktivitet të ngjashëm me objektin e prokurimit, rezulton se:*

*• Mjeti me targa AA198TI me nr.shasie VF644ACA000013207 i deklaruar si "Autofshesë" në Bashkinë Vlorë, rezulton se është deklaruar për tu përdorur si kamion 7.5 – 18 ton në Bashkinë Kavajë, dhe për tu përdorur si Autobot në Bashkinë Tiranë. Bazuar në korrespodencën e mbajtur me këto institucione rezulton se jo vetëm që ky mjet nuk mund përdoret për realizimin e kontratës në Bashkinë Vlorë, pasi është në shërbim të njëkohshëm në dy Bashki të tjera, por edhe të dhënat për llojin dhe funksionin e mjetit janë kondradiktore, pasi në tre Bashki të ndryshme i njëjti mjet me të njëjtin shasi deklarohet njëkohësisht si autofshesë, si autobot, si kamion transportues.*

*• Mjeti me targa AGMT48 me nr.shasie SA92V5CXXA4068157 i deklaruar si "Autofshesë" në Bashkinë Vlorë, rezulton se është deklaruar edhe në Bashkinë Kavajë dhe në Bashkinë Tiranë. Bazuar në korrespodencën e mbajtur me këto institucione rezulton se ky mjet nuk mund përdoret për realizimin e kontratës në Bashkinë Vlorë, pasi është në shërbim të njëkohshëm në dy Bashki të tjera.*

*• Mjeti me targa AA857XM me nr.shasie VF644ACA000013903 i deklaruar si "Mjet te posacem me goma qe kryen funksionin fshirje dhe larje njekohesisht" në Bashkinë Vlorë, rezulton se është deklaruar për tu përdorur si kamion 7.5 – 18 ton në Bashkinë Kavajë. Bazuar në korrespodencën e mbajtur me këto institucione rezulton se jo vetëm që ky mjet nuk mund përdoret për realizimin e kontratës në Bashkinë Vlorë, pasi është në shërbim të njëkohshëm edhe në një Bashki tjetër, por edhe të dhënat për llojin dhe funksionin e mjetit janë kondradiktore, pasi në dy Bashki të ndryshme i njëjti mjet me të njëjtin shasi deklarohet njëkohësisht si mjet fshirës dhe si kamion transportues. Për sa më lart, shoqëria "ALKO-IMPEX GENERAL CONSTRUCTION" jo vetëm nuk ka plotësuar kriterin e vecantë të kualifikimit për sasinë dhe llojet e mjeteve, por edhe bazuar në nenin 46/1/b të LPP-së, nuk ka vërtetuar se "zotëron makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës", si dhe bazuar në nenin 53/3 të LPP-së, oferta e paraqitur "nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit".*

*- Në pikën 3.3.10 të kritereve të vecanta të kualifikimit për lotin 1 është përcaktuar: "Shoqeria ofertuese duhet te disponoje dokumentacion qe per realizimin e kesaj kontrate te kete keto mjete (ne pronesi ose qira): b. Kamion me kapacitet transportues 15 - 25 ton 2 cope (ne pronesi ose me qira)" Bazuar në dokumentacionin e paraqitur në SPE prej shoqërisë "ALKO-IMPEX GENERAL CONSTRUCTION" dhe të shoqëruar me deklaratën përkatëse, ka paraqitur mjetet me targa AA081RS, AA539TI, AA631PB, AA865SD, AA871SD për të përmbushur kriterin 3.3.10.b. Sikurse u sqarua edhe më sipër për këto mjete nuk ka paraqitur dokumentin për taksat vjetore, por nga verifikimet e kryera zyrtarisht në Autoritetet Kontraktore ku ky subjekt ushtron aktivitet të ngjashëm me objektin e prokurimit rezulton se:*
*• Mjeti me targa AA081RS i deklaruar në deklaratën e mjeteve të paraqitur në Bashkinë Vlorë si kamion me kapacitet transportues 15 – 25 ton, bazuar në lejen e qarkullimit të paraqitur rezulton se është me kapacitet 27 ton (40000 kg me ngarkesë – 12912 kg pa ngarkesë). Ky mjet është mbi kapacitetin transportues të kërkuar në kriterin e kualifikimit.*
*• Mjeti me targa AA853NJ i deklaruar në deklaratën e mjeteve të paraqitur në Bashkinë Vlorë si kamion me kapacitet 20 ton, i marrë me qira me kontratën me nr.9778rep dhe nr.6809 kol, bazuar në dokumentin për pagimin e taksave vjetore të paraqitur rezulton se është lëshuar dhe paguar në datë 13.12.2018 që me një afat vlefshmërie prej 1 vit del që ka përfunduar në datë 12.12.2019, ndërkohë që afati për hapjen e ofertave të kësaj procedure ka qenë data 06.01.2020.*
*• Mjeti me targa AA539TI i deklaruar në deklaratën e mjeteve të paraqitur në Bashkinë Vlorë si kamion pastrimi, rezulton se është me kapacitet 6,8 ton ton (19000 kg me ngarkesë – 12150 kg pa ngarkesë). Ky mjet është nën kapacitetin e kërkuar në kriterin e kualifikimit. Për këtë mjet edhe pse shkruhet në deklaratën e mjeteve të paraqitur më emërtimin "kamion pastrimi", pa u sqaruar nëse është mjet teknologjik apo kamion, në të dyja rastet, si do që të jetë është nën kapacitetin e kërkuar në dst.*
*• Mjeti me targa AA631PB i deklaruar në deklaratën e mjeteve të paraqitur në Bashkinë Vlorë si kamion pastrimi, rezulton se është me kapacitet 5,8 ton ton (19000 kg me ngarkesë – 13200 kg pa ngarkesë). Ky mjet është nën kapacitetin e kërkuar në kriterin e kualifikimit.*

*Për këtë mjet edhe pse shkruhet në deklaratën e mjeteve të paraqitur më emërtimin "kamion pastrimi", pa u sqaruar nëse është mjet teknologjik apo kamion, por që sipas fotots rezulton të jetë mjet teknologjik, në të dyja rastet, si do që të jetë është nën kapacitetin e kërkuar në dst.*
*• Mjeti me targa AA865SD i deklaruar në deklaratën e mjeteve të paraqitur në Bashkinë Vlorë, me emërtimin "kamion pastrimi", rezulton se është deklaruar për tu përdorur në Bashkinë Kavajë, rezulton se është deklaruar për tu përdorur si makinë teknologjike në Bashkinë Devoll, si dhe rezulton se është deklaruar për tu përdorur si kompatator në Bashkinë Tiranë. Bazuar në korrespodencën e mbajtur me këto institucione rezulton se jo vetëm që ky mjet nuk mund përdoret për realizimin e kontratës në Bashkinë Vlorë, pasi është në shërbim të njëkohshëm në tre Bashki të tjera, por edhe të dhënat për llojin dhe funksionin e mjetit janë kontradiktore, pasi në katër Bashki të ndryshme i njëjti mjet me të njëjtin shasi deklarohet njëkohësisht si kamion transportues, si makinë teknologjike, si kompatator.*
*• Mjeti me targa AA871SD i deklaruar në deklaratën e mjeteve të paraqitur në Bashkinë Vlorë, me emërtimin "kamion pastrimi", rezulton se është deklaruar për tu përdorur në Bashkinë Kavajë, rezulton se është deklaruar për tu përdorur si makinë teknologjike në Bashkinë Devoll, si dhe rezulton se është deklaruar për tu përdorur si kompatator në Bashkinë Tiranë. Bazuar në korrespodencën e mbajtur me këto institucione rezulton se jo vetëm që ky mjet nuk mund përdoret për realizimin e kontratës në Bashkinë Vlorë, pasi është në shërbim të njëkohshëm në tre Bashki të tjera, por edhe të dhënat për llojin dhe funksionin e mjetit janë kontradiktore, pasi në katër Bashki të ndryshme i njëjti mjet me të njëjtin shasi deklarohet njëkohësisht si kamion transportues, si makinë teknologjike, si kompatator.*

*Për sa më lart, shoqëria "ALKO-IMPEX GENERAL CONSTRUCTION" jo vetëm nuk ka plotësuar kriterin e vecantë të kualifikimit për sasinë dhe llojet e mjeteve, por edhe bazuar në nenin 46/1/b të LPP-së, nuk ka vërtetuar se "zotëron makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës", si dhe bazuar në nenin 53/3 të LPP-së, oferta e paraqitur "nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit".*

II.4. Në datën 13.02.2020, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, ku kundërshton skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e mësipërme të prokurimit. Konkretisht operatori ekonomik ankimues pretendon se:
*[...]*
*Shoqeria ALKO IMPEX GENERAL CONSTRUCTION dshh, (ketu e ne vijim OE ankimues), ka marre pjese ne proceduren e prokurimit me objekt "Sherbim i Pastrimit ne Qytetin Vlorë", me autoritet kontraktor Bashkia Vlore (ketu e ne vijim AK), procedure e zhvilluar ne sistemin e prokurimit elektronik (ketu e ne vijim SPE) me dt. 06.01.2020. Me dt. 10.02.2020, me ane te sistemit te prokurimit elektronik jemi njoftuar per skualifikimin e ofertes se paraqitur prej nesh dhe kualifikimin e ofertuesit te tjere pjesmarres ne kete procedure prokurimi si me poshte:*
*"Alko Impex General Construction" 543573407 skualifikuar*
*"Duka" 581685822 kualifikuar*
*Arsyeja e refuzimit të ofetës së paraqitur prej nesh është:*

*- Në pikën 3.3.4 të kritereve të vecanta të kualifikimit për lotin 1 është përcaktuar: ”Subjekti te jete i pajisur me licence nga QKB për kategorinë III.1.A Leje e thjeshte mjedisore për Shërbimi i pastrimit dhe i largimit të mbeturinave urbane, Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme”. Për të përmbushur këtë kriter prej shoqërisë ”ALKO-IMPEX GENERAL CONSTRUCTION” është paraqitur Leje PN-0928- 10-2015 me Kod III.1.A e lëshuar prej QKL me emërtim përshkrues të veprimtarisë ”Leje mjedisi e tipit C: Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme” e shoqëruar me Akt Miratimi nr.370 prot datë 28.09.2015. Subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion që të vërtetojë se disponon leje nga QKB për kategorinë III.1.A me emërtimin “Leje e thjeshte mjedisore për Shërbimi i pastrimit dhe i largimit të mbeturinave urbane”.*

*- Në pikën 3.3.10 të kritereve të vecanta të kualifikimit për lotin 1 është përcaktuar: ” Subjekti ofertues duhet te jete i pajisur me autorizim ose leje për përdorimin e burimeve ujore, per efekt te perdorimit te ujit me te cilin do te kryhen sherbimet objekt i ketij prokurimi”. Për të përmbushur këtë kriter prej shoqërisë ”ALKO-IMPEX GENERAL CONSTRUCTION” është paraqitur*
*• Autorizim nr.239 prot datë 11.11.2019 i lëshuar prej ”Ujësjellës Kanalizime Devoll” sh.a ku përcaktohet se autorizon shoqërinë ”ALKO-IMPEX GENERAL CONSTRUCTION” për përdorimin e burimeve ujore nën administrimin e e kësaj shoqërie. Ky dokument nuk e plotëson kriterin e kualifikimit për dy arsye pasi së pari burimet ujore të ndërmarrjeve të ujësjellës kanalizime janë të pijshme dhe për pasojë subjekti duhet të tarifohet si për përdorimin e ujit të pijshëm, kurse përdorimi i ujit për shërbimet komunale duhet të kryhet nga burimet ujore sipas VKM nr.662 datë 21.09.2016, së dyti përdorimi i ujit me të cilin do të kryhen shërbimet objekt i këtij prokurimi nevojitet për qytetin e Vlorës, ndërkohë që autorizimi është për Bashkinë Devoll.*
*• Shkresë Kthim përgjigje nr.1505/1 prot datë 11.12.2019 e lëshuar prej Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore ku sqarohet shoqëria ”ALKO-IMPEX GENERAL CONSTRUCTION” se ”pas plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor të përcaktuar në VKM nr.416 datë 13.05.2015 duhet të aplikojë pranë Zyrës së Administrimit të Basenit Ujor përkatës dhe më tej miratohen pranë Këshillit të Basenit Ujor. Lejet apo autorizimet lëshohen për një afat të caktuar kohor, sipas parashikimeve të pikës 5 të VKM nr.416 datë 13.05.2015”. Subjekti ofertues shoqëria ”ALKO-IMPEX GENERAL CONSTRUCTION” nuk rezulton të ketë paraqitur ndonjë dokumentacionin pranë Zyrës së Administrimit të Basenit Ujor sipas sqarimeve në shkresë për tu pajisur me lejë apo autorizim për përdorimin e burimeve ujore. Në bazë të pikës 4/b të VKM nr.416 datë 13.05.2015 ku përcaktohet shprehimisht se ”Lejet dhe autorizimet për përdorimin e ujit shqyrtohen nga Këshilli i Basenit Ujor (KBU), referuar nenit 50, të ligjit nr. 111/2012, i cili merr vendim jo më vonë se 2 (dy) muaj, nga data e paraqitjes së kërkesës”.*
*Kjo procedurë prokurimi ka qenë e publikuar në SPE në datë 30.10.2019 dhe ofertat janë hapur në datë 06.01.2020, cka provon qartë se subjekti ofertues e ka patur kohën e nevojshme për të aplikuar për të përmbushur kriterin e kualifikimit.*
*- Në pikën 3.3.11 të kritereve të vecanta të kualifikimit për lotin 1 është përcaktuar: ”Shoqeria ofertuese duhet te disponoje dokumentacion qe per realizimin e kesaj kontrate te kete keto mjete (ne pronesi ose qira). Keto mjete duhet te jene te pajisur me dokumentacion sipas legjislacionit ne fuqi. Per mjetet qe jane me qira duhet te paraqitet edhe kontrata e qirase me nje afat vlefshmerie*

*jo me pak se nje vit. Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), policen e sigurimit, taksat vjetore te mjetit, si dhe lejen e transportit nga bashkia per vete ose te trete. Mjetet duhet te paraqiten ne formen e nje deklarate ku te percaktohen targat, lloji, numri i shasise." Dokumentacioni për të përmbushur këtë kriter i paraqitur prej shoqërisë "ALKO-IMPEX GENERAL CONSTRUCTION", për të gjitha mjetet e ngarkuar në SPE dhe të shoqëruar me deklaratën përkatëse, nuk përmban dokumentin për taksat vjetore te mjetit, sikurse përcaktohet në kriterin e kualifikimit për dokumentacionin që duhet të paraqesë.*

*- Në pikën 3.3.10 të kritereve të vecanta të kualifikimit për lotin 1 është përcaktuar: "Shoqeria ofertuese duhet te disponoje dokumentacion qe per realizimin e kesaj kontrate te kete keto mjete (ne pronesi ose qira): e. Autofshesa 3 cope (ne pronesi ose me qira) f. Mjet te posacem me goma qe kryen funksionin fshirje dhe larje njekohesisht 1 cope (ne pronesi ose me qira)" Bazuar në dokumentacionin e paraqitur në SPE prej shoqërisë "ALKO-IMPEX GENERAL CONSTRUCTION" dhe të shoqëruar me deklaratën përkatëse, ka paraqitur mjetet me targa AA198TI, AGMT47, AGMT48 për të përmbushur kriterin 3.3.10.e, si dhe ka paraqitur mjetin me targa AA857XM për të përmbushur kriterin 3.3.10.f. Sikurse u sqarua edhe më sipër për këto mjete nuk ka paraqitur dokumentin për taksat vjetore te mjetit, por nga verifikimet e kryera zyrtarisht në Autoritetet Kontraktore ku ky subjekt ushtron aktivitet të ngjashëm me objektin e prokurimit, rezulton se:*

*• Mjeti me targa AA198TI me nr.shasie VF644ACA000013207 i deklaruar si "Autofshesë" në Bashkinë Vlorë, rezulton se është deklaruar për tu përdorur si kamion 7.5 – 18 ton në Bashkinë Kavajë, dhe për tu përdorur si Autobot në Bashkinë Tiranë. Bazuar në korrespodencën e mbajtur me këto institucione rezulton se jo vetëm që ky mjet nuk mund përdoret për realizimin e kontratës në Bashkinë Vlorë, pasi është në shërbim të njëkohshëm në dy Bashki të tjera, por edhe të dhënat për llojin dhe funksionin e mjetit janë kondradiktore, pasi në tre Bashki të ndryshme i njëjti mjet me të njëjtin shasi deklarohet njëkohësisht si autofshesë, si autobot, si kamion transportues.*
*• Mjeti me targa AGMT48 me nr.shasie SA92V5CXXA4068157 i deklaruar si "Autofshesë" në Bashkinë Vlorë, rezulton se është deklaruar edhe në Bashkinë Kavajë dhe në Bashkinë Tiranë. Bazuar në korrespodencën e mbajtur me këto institucione rezulton se ky mjet nuk mund përdoret për realizimin e kontratës në Bashkinë Vlorë, pasi është në shërbim të njëkohshëm në dy Bashki të tjera.*

*• Mjeti me targa AA857XM me nr.shasie VF644ACA000013903 i deklaruar si "Mjet te posacem me goma qe kryen funksionin fshirje dhe larje njekohesisht" në Bashkinë Vlorë, rezulton se është deklaruar për tu përdorur si kamion 7.5 – 18 ton në Bashkinë Kavajë. Bazuar në korrespodencën e mbajtur me këto institucione rezulton se jo vetëm që ky mjet nuk mund përdoret për realizimin e kontratës në Bashkinë Vlorë, pasi është në shërbim të njëkohshëm edhe në një Bashki tjetër, por edhe të dhënat për llojin dhe funksionin e mjetit janë kondradiktore, pasi në dy Bashki të ndryshme i njëjti mjet me të njëjtin shasi deklarohet njëkohësisht si mjet fshirës dhe si kamion transportues. Për sa më lart, shoqëria "ALKO-IMPEX GENERAL CONSTRUCTION" jo vetëm nuk ka plotësuar kriterin e vecantë të kualifikimit për sasinë dhe llojet e mjeteve, por edhe bazuar në nenin 46/1/b*

*të LPP-së, nuk ka vërtetuar se "zotëron makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës", si dhe bazuar në nenin 53/3 të LPP-së, oferta e paraqitur "nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit".*

*- Në pikën 3.3.10 të kritereve të vecanta të kualifikimit për lotin 1 është përcaktuar: "Shoqeria ofertuese duhet te disponoje dokumentacion qe per realizimin e kesaj kontrate te kete keto mjete (ne pronesi ose qira): b. Kamion me kapacitet transportues 15 - 25 ton 2 cope (ne pronesi ose me qira)" Bazuar në dokumentacionin e paraqitur në SPE prej shoqërisë "ALKO-IMPEX GENERAL CONSTRUCTION" dhe të shoqëruar me deklaratën përkatëse, ka paraqitur mjetet me targa AA081RS, AA539TI, AA631PB, AA865SD, AA871SD për të përmbushur kriterin 3.3.10.b. Sikurse u sqarua edhe më sipër për këto mjete nuk ka paraqitur dokumentin për taksat vjetore, por nga verifikimet e kryera zyrtarisht në Autoritetet Kontraktore ku ky subjekt ushtron aktivitet të ngjashëm me objektin e prokurimit rezulton se:*
*• Mjeti me targa AA081RS i deklaruar në deklaratën e mjeteve të paraqitur në Bashkinë Vlorë si kamion me kapacitet transportues 15 – 25 ton, bazuar në lejen e qarkullimit të paraqitur rezulton se është me kapacitet 27 ton (40000 kg me ngarkesë – 12912 kg pa ngarkesë). Ky mjet është mbi kapacitetin transportues të kërkuar në kriterin e kualifikimit.*
*• Mjeti me targa AA853NJ i deklaruar në deklaratën e mjeteve të paraqitur në Bashkinë Vlorë si kamion me kapacitet 20 ton, i marrë me qira me kontratën me nr.9778rep dhe nr.6809 kol, bazuar në dokumentin për pagimin e taksave vjetore të paraqitur rezulton se është lëshuar dhe paguar në datë 13.12.2018 që me një afat vlefshmërie prej 1 vit del që ka përfunduar në datë 12.12.2019, ndërkohë që afati për hapjen e ofertave të kësaj procedure ka qenë data 06.01.2020.*
*• Mjeti me targa AA539TI i deklaruar në deklaratën e mjeteve të paraqitur në Bashkinë Vlorë si kamion pastrimi, rezulton se është me kapacitet 6,8 ton ton (19000 kg me ngarkesë – 12150 kg pa ngarkesë). Ky mjet është nën kapacitetin e kërkuar në kriterin e kualifikimit. Për këtë mjet edhe pse shkruhet në deklaratën e mjeteve të paraqitur më emërtimin "kamion pastrimi", pa u sqaruar nëse është mjet teknologjik apo kamion, në të dyja rastet, si do që të jetë është nën kapacitetin e kërkuar në dst.*
*• Mjeti me targa AA631PB i deklaruar në deklaratën e mjeteve të paraqitur në Bashkinë Vlorë si kamion pastrimi, rezulton se është me kapacitet 5,8 ton ton (19000 kg me ngarkesë – 13200 kg pa ngarkesë). Ky mjet është nën kapacitetin e kërkuar në kriterin e kualifikimit.*

*Për këtë mjet edhe pse shkruhet në deklaratën e mjeteve të paraqitur më emërtimin "kamion pastrimi", pa u sqaruar nëse është mjet teknologjik apo kamion, por që sipas fotots rezulton të jetë mjet teknologjik, në të dyja rastet, si do që të jetë është nën kapacitetin e kërkuar në dst.*
*• Mjeti me targa AA865SD i deklaruar në deklaratën e mjeteve të paraqitur në Bashkinë Vlorë, me emërtimin "kamion pastrimi", rezulton se është deklaruar për tu përdorur në Bashkinë Kavajë, rezulton se është deklaruar për tu përdorur si makinë teknologjike në Bashkinë Devoll, si dhe rezulton se është deklaruar për tu përdorur si kompatator në Bashkinë Tiranë. Bazuar në korrespodencën e mbajtur me këto institucione rezulton se jo vetëm që ky mjet nuk mund përdoret për realizimin e kontratës në Bashkinë Vlorë, pasi është në shërbim të njëkohshëm në tre Bashki*

*të tjera, por edhe të dhënat për llojin dhe funksionin e mjetit janë kontradiktore, pasi në katër Bashki të ndryshme i njëjti mjet me të njëjtin shasi deklarohet njëkohësisht si kamion transportues, si makinë teknologjike, si kompatator.*

*• Mjeti me targa AA871SD i deklaruar në deklaratën e mjeteve të paraqitur në Bashkinë Vlorë, me emërtimin "kamion pastrimi", rezulton se është deklaruar për tu përdorur në Bashkinë Kavajë, rezulton se është deklaruar për tu përdorur si makinë teknologjike në Bashkinë Devoll, si dhe rezulton se është deklaruar për tu përdorur si kompatator në Bashkinë Tiranë. Bazuar në korrespodencën e mbajtur me këto institucione rezulton se jo vetëm që ky mjet nuk mund përdoret për realizimin e kontratës në Bashkinë Vlorë, pasi është në shërbim të njëkohshëm në tre Bashki të tjera, por edhe të dhënat për llojin dhe funksionin e mjetit janë kontradiktore, pasi në katër Bashki të ndryshme i njëjti mjet me të njëjtin shasi deklarohet njëkohësisht si kamion transportues, si makinë teknologjike, si kompatator.*

*Për sa më lart, shoqëria "ALKO-IMPEX GENERAL CONSTRUCTION" jo vetëm nuk ka plotësuar kriterin e vecantë të kualifikimit për sasinë dhe llojet e mjeteve, por edhe bazuar në nenin 46/1/b të LPP-së, nuk ka vërtetuar se "zotëron makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës", si dhe bazuar në nenin 53/3 të LPP-së, oferta e paraqitur "nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit".*

*Sa më sipër, gjykojmë dhe vleresojme paraprakisht se skualfikimi i ofertes se paraqitur prej nesh eshte ne kundershtim me dokumentacionin e paraqitur ne tender dhe ne kundershtim me kriteret per kualifikim. Arsyet e skualfikimit bien ndesh me ligjin e si njedhoje persa me poshte sqarojme, cmojme te theksojme se vendimi i AK-se per skualifikimin e ofertes tone eshte i kundraligjshern e si njedhoje ai duhet ndryshuar.*

1. *Lidhur me arsyen e parë të skualifikimit*

   *- Në pikën 3.3.4 të kritereve të vecanta të kualifikimit për lotin 1 është përcaktuar: "Subjekti te jete i pajisur me licence nga QKB për kategorinë III.1.A Leje e thjeshte mjedisore për Shërbimi i pastrimit dhe i largimit të mbeturinave urbane, Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme". Për të përmbushur këtë kriter prej shoqërisë "ALKO-IMPEX GENERAL CONSTRUCTION" është paraqitur Leje PN-0928- 10-2015 me Kod III.1.A e lëshuar prej QKL me emërtim përshkrues të veprimtarisë "Leje mjedisi e tipit C: Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme" e shoqëruar me Akt Miratimi nr.370 prot datë 28.09.2015. Subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion që të vërtetojë se disponon leje nga QKB për kategorinë III.1.A me emërtimin "Leje e thjeshte mjedisore për Shërbimi i pastrimit dhe i largimit të mbeturinave urbane". - Në pikën 3.3.10 të kritereve të vecanta të kualifikimit për lotin 1 është përcaktuar*

*Lidhur me këtë arsye gjykojmë se kjo arsye për skualifikimin e ofertës tonë nuk qëndron pasi:*

*Në nenin 46, pika 2 dhe 3 ligjit nr. 9643 dt. 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar parashikohet se:*

*2. Autoriteti kontraktor mund të kërkojë edhe certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit. 3. Kërkesat për kualifikim duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit public.*

*Ndërkohë dokumentat e tenderit është kërkuar:*

*Subjekti te jete i pajisur me licence nga QKBper kategorine III.1.A Leje e thjeshte mjedisore per Sherbimi i pastrimit dhe i largimit te mbeturinave urbane, Stacion transferimi per mbetje jo te rrezikshme*

*Referuar ligjit Nr. 10448 date 14.07.2011 "Per lejet e mjedisisit" te ndryshuar, por dhe ligjit Nr. 60/2014 "Per nje Ndryshim ne Ligjin 10448 date 14.07.2011", rezulton se nje Leje mjedisi me kete emertim nuk ekziston. Situata behet akoma me groteske kur pikerisht kerkimi i nje leje mjedisore qe nuk ezkiston ligjerisht perben shkak per skualifikimin e ofertes se paraqitur prej nesh.*

*Nuk rezulton te kete asnje leje me kod III.1.A me kete emertim.*

*Ne nenin 23 te ligjit nr. 9643/2006 "Per Prokurirnin Publik" i ndryshuar parashikohet se:*

*1. Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.*

*2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.*

*3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar:*

*a) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve;*

*b) kërkesave në terma funksionalë, kur një gjë e tillë kërkon t'u referohesh standardeve kombëtare ose ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;*

*c) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni për mallra, shërbime apo punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj*

*4. Përshkrimi i punimeve, mallrave apo shërbimeve duhet të përmbajë specifikimet teknike, që duhet të plotësohen në rast nevoje, edhe plane, vizatime, modele, makete etj. Në rast të përshkrimit funksional të punimeve apo të mallit, specifikimet teknike duhet të përshkruajnë në mënyrë të saktë dhe neutrale qëllimin e punimeve për njohjen e të gjitha kushteve dhe rrethanave me rëndësi për hartimin e ofertës.*

*Ne nenin 30 te VKM nr. 914 dt.29.12.2014 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", i ndryshuar parashikohet se:*

*"Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga sistemet e standardizimit kombëtar ose ndërkombëtar. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit."*

*2.Certifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.*

*Ne analize te dispozitave ligjore te cituara me siper, sqarojme se, Autoriteti Kontraktor gjate percaktimit te kritereve te vecanta duhet te shmangi cdo kerkese apo procedure qe lidhet me kualifikimin e operatoreve ekonornike, e cila perben diskriminim ndaj nje ose midis furnizuesve apo kontraktoreve ose ndaj kategorive te tyre. Por ne percaktimin/apo vendosjen e kritereve specifike, qe ne thelb konsiderohen si kritere fituese (aëard criteria), per shkak te rendesise qe kane, ligjvenesi i ka parashikuar kufizime autoritetit kontraktor brenda diskrecionit qe ka ne perzgjedhjen e tyre. Ne kete menyre, dispozitat e siperperrnendura, urdherojne se percaktimi i ketyre kritereve duhet te jete: (i) ne perpjesetim me natyren dhe permasat e kontrates qe do te prokurohet dhe (ii) jodiskriminuese, duke krijuar kushte per konkurrim te paanshern e te hapur nderrnjet te gjithe kandidateve e ofertuesve.*

*Ne nenin 46, pika 1, te ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: " 1. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese."*

*Eshte detyrim i autoretitet kontraktor te siguroje qe kerkesat/specifikimet teknike te jene te shkruara ne nje mënyrë te tille qe te hapin prokurimin publik ndaj konkurences, te lejojne akses te barabarte për ofertuesitsi dhe nuk duhet te kene efektin e krijimit te pengesave të pajustifikuara në hapjen e prokurimit public ndaj konkurencës.*

*Si rrjedhoje, eshte detyrim qe ligjvenesi i ka vendosur autoriteteve kontratkore, te cilet ne perzgjedhjen e kritereve te vecanta duhet te argumentoje nevojen qe e dikton vendosja e nje kriteri te caktuar.*

*Vleresojme se kriteri i vecante i kualifikimit qe ka te beje me licensen e kerkuar me KOD III.1.A me emërtimin e kerkuar, bie ndesh me dispozitat urdheruese te ligjit nr. 9643/2006 "Per Prokurimin Publik" i ndryshuar, per shkak se ky kriter nuk argumentohet dhe nevojitet ne proceduren e prokurimit objekt gjvkimi e akoma me tej nuk rezulton që një leje/Iicense e tille te Ieshohet nga Qendra Kombetare e Licensimit sot Qendra Kombetare e Biznesit. Si i tille ky kriter eshte absolutisht i pavlefshm kjo sipas pikes i) te germes a) te nenit 108 te K.Pr. Administrativ e nuk mund te perbeje shkak per skualifikimin e OE ankimues.*

*Referuar ligjit Nr. 10448 date 14.07.2011 "Per lejet e mjedisit" te ndryshuar, por dhe ligjit Nr. 60/2014 Per nje Ndryshim ne Ligjin 10448 date 14.07.2011, e vetmja Leje e leshuar nga QKB qe lidhet ngushtesisht dhe pashmangerisht me kontraten objekt prokurimi (sherbim pastrimi) eshte ajo me KOD III.1.A. me objekt "Pastrim, larje, sprucim ose veshje e mbetjeve te ambalazhuara/paketimeve ose kontienrev qe menyre qe te riperdoren dhe KOD III.2.B ( Transport i mbetjeve jo te rrezikshme te cilat zotrerohen nga OE ankimues.*

*Ne nenin 23 pika 1, 2, 3 dhe 5 "Specifikimet teknike" te Ligjit nr.9643 date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik" i ndryshuar parashikohet se:'*
*c) te dyja metodave te percaktuara ne shkronjat "a" dhe "b" te pikes 3 te ketij neni per mallra, shërbime apo pune te ndryshme, te perfshira ne te njejtin objekt kontrate. Cdo reference duhet te shoqerohet nga fjalet "ose ekuivalenti i tij/saj. Si rrjedhoje ne permbushje te kriterit te kerkuar te vetmet dokumenta ligjor te leshuara nga QKL (sot QKB) jane ato te paraqitura nga OE ankimues. Ne veshtrim te faqes zyrtare te QKB-se rezulton se ofertuesi tjeter shoqeria DUKA shpk, zoteron nje autorizim mjedisor pikerisht me emertimin e kerkuar prej Jush. Kjo sjell dyshimin se percaktimi i ketij kriteri te kundraligjshem ka patur si qellim favorizimin e ketij subjekti dhe skualifikimin me pa te drejte te shoqerise sone. Akoma me tej bejme me dije se referuar ndryshimeve Iigjore ne fuqi autorizimet mjedisore jane te pavlefshme ne momentin e zhvillimit te procedures se prokurimit.*
*Keto autorizime mjedisore jane leshuar mbi Iigjin Nr. 8934 date 05.09.2002 "Per mbrojtjen e mjedisit", Iigji i cili eshte shfuqizuar dhe me ndryshimet ligjore OE DUKA shpk duhet te kishte here rishikimin e tyre bazuar ne ligjin 10448 date 14.07.2011 "Per lejet e mjedisit" neni 4 pika 3. Sa më sipër arsyeja e pretenduar për skualifikim nuk qëndron ose AK duhet të bëjë dhe skualifikimin e operatorit tjetër ekonomik pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi.*

*2.Lidhur me arsyen tjetër për skualifikim:*

*Subjekti ofertues duhet te jete i pajisur me autorizim ose leje për përdorimin e burimeve ujore, per efekt te perdorimit te ujit me te cilin do te kryhen sherbimet objekt i ketij prokurimi". Për të përmbushur këtë kriter prej shoqërisë "ALKO-IMPEX GENERAL CONSTRUCTION" është paraqitur Autorizim nr.239 prot datë 11.11.2019 i lëshuar prej "Ujësjellës Kanalizime Devoll" sh.a ku përcaktohet se autorizon shoqërinë "ALKO-IMPEX GENERAL CONSTRUCTION" për përdorimin e burimeve ujore nën administrimin e e kësaj shoqërie. Ky dokument nuk e plotëson kriterin e kualifikimit për dy arsye pasi së pari burimet ujore të ndërmarrjeve të ujësjellës kanalizime janë të pijshme dhe për pasojë subjekti duhet të tarifohet si për përdorimin e ujit të pijshëm, kurse përdorimi i ujit për shërbimet komunale duhet të kryhet nga burimet ujore sipas VKM nr.662 datë 21.09.2016, së dyti përdorimi i ujit me të cilin do të kryhen shërbimet objekt i këtij prokurimi nevojitet për qytetin e Vlorës, ndërkohë që autorizimi është për Bashkinë Devoll. Shkresë Kthim përgjigje nr.1505/1 prot datë 11.12.2019 e lëshuar prej Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore ku sqarohet shoqëria "ALKO-IMPEX GENERAL CONSTRUCTION" se "pas plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor të përcaktuar në VKM nr.416 datë 13.05.2015 duhet të aplikojë pranë Zyrës së Administrimit të Basenit Ujor përkatës dhe më tej miratohen pranë Këshillit të Basenit Ujor. Lejet apo autorizimet lëshohen për një afat të caktuar kohor, sipas parashikimeve të pikës 5 të VKM nr.416 datë 13.05.2015". Subjekti ofertues shoqëria "ALKO-IMPEX GENERAL CONSTRUCTION" nuk rezulton të ketë paraqitur ndonjë dokumentacionin pranë Zyrës së Administrimit të Basenit Ujor sipas sqarimeve në shkresë për tu pajisur me lejë apo autorizim për përdorimin e burimeve ujore. Në bazë të pikës 4/b të VKM nr.416 datë*

*13.05.2015 ku përcaktohet shprehimisht se "Lejet dhe autorizimet për përdorimin e ujit shqyrtohen nga Këshilli i Basenit Ujor (KBU), referuar nenit 50, të ligjit nr. 111/2012, i cili merr vendim jo më vonë se 2 (dy) muaj, nga data e paraqitjes së kërkesës". Kjo procedurë prokurimi*

*ka qenë e publikuar në SPE në datë 30.10.2019 dhe ofertat janë hapur në datë 06.01.2020, cka provon qartë se subjekti ofertues e ka patur kohën e nevojshme për të aplikuar për të përmbushur kriterin e kualifikimit.*

*Nga autoriteti Kontraktor ne DST eshte kerkuar:*
*Subjekti ofertues duhet te jete i pajisur me autorizim e leje perperdorimin e burimeve ujore, per efekt te perdorimit te ujit me te cilin do le kryhen sherbimet objekt i ketij prokurimi*
*Nga ana e OE ankimues ne SPE eshte paraqitur dokumenti i emertuar: Autorizim*
*Në brendësi të këtij dokumenti gjenden:*

1. *Autorizim lëshuar nga Ujësjellës Kanalizime Devoll sha Nr. 239prot. datë 11.11.2019*
2. *Shkesë "Kthim përgjigje" lëshuar nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore Nr. 1505.1prot datë 11.12.2019.*

*Ne autorizimin e leshuar nga Ujesjelles Kanalizme Devoll sha eshte autorizuar shoqeria ALKO IMPEXGENERAL CONSTRUCTION dshh, per perdorimin e burimeve Ujore nën administratimin e Nderrnarrjes Ujesjelles Kanalizimeve Devoll shaper shkak te veprimtarisë së tij.*
*Autoriteti juaj pretendon se ky dokument nuk eshte i vlefshem pasi se pari shoqeria jone duhet:*
*se pari burimet ujore te ndermarrjes le ujsjelles kanalizimeve jane te pijshme dhe per pasoje subjekti duhet te tarifohet si per perdorimin e ujit të pijshem kurse perdorimimi i ujit per sherbime komunale duhet te kryhet nga burimet ujore sipas VK.M-se Nr. 662, dale 21. 09. 2016,*
*se dyti perdorimi i ujit me te cilin do le kryhen sherbimet objeki i ketij prokurimi nevojitet per qytetin e Vlores, nderkohe qe autorizimi eshte per Bashkine Devoll.*
*Të dy këto pretendime janë sa të pavërteta aq dhe në kundështim me ligjin. Fillimisht sqarojmë se institucioni juaj e aq më pak Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nuk ka tagrat e duhura për të vlerësuar apo zhvleftësuar ligjshëmrinë e këtij dokumenti. Ai rezulton të jetë lëshuar nga organ i pavarur dhe dokumentat e lëshuara pej tij janë të vlefshme deri në shfuqizimin e tyre nga gjykata kompetente apo mënyra të tjera të parashikuaranë Kodin e Procedurës Administrative.*
*Së dyti tarifimi shoqërisë në lidhje me Ujin është një problematikë që nuk hyn në Juridiksionin apo kompetencës tuaj. Për Autoritetin Kontraktorv është e vlefshme që OE pjesmarrës të provojë se zotëron apo do të zotërojë kapacitete e duhura për realizimin me sukses të kontratës.*
*Së treti në asnjë fjalë të autorizimit, ndryshe nga sa KVO në mënyrë abusive citon, nuk përmendet fakti se ky autorizim është i vlefshëm vetëm në qytetin e Devollit.*
*Së katërti tarifi dhe kosto e përballit të mbushjes së Ujit në Devoll dhe larja e qytetit në Vlorë është një risk i subjektit pjesmarrës dhe mbetet në diskrecionin e tij vleësimi i mundshëm i këtyre mundësive.*
*Së pesti në kërkesën e autoritetit kontraktor në Dst nuk specifikohet organi apo cili tip leje do të konsiderohet i vlefshëm apo jo për përmbushjen e kriterit të sipërcituar.*
*Nga verifikimi i dokumentave të tenderit, rezulton se janë përcaktuar kriteret e përgjithshme dhe kriteret e veçanta për kuaifikim , nga ku evidentohet të jetë përcaktuar vetëm kriteri që akt kërkohet një dokument (leje ose autorizim për përdorim të burimit ujor) dhe në asnjë rast nuk është përcaktuar ndonjë kërkesë në lidhje me faktin se kush është organ ii vetëm kompetentë apo që KVO vlerëson sit ë domosdoshëm për plotësimin e kriterit.*
*Në rastin konkret nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, rezulton se nga autoriteti kontraktor nuk është përcaktuar apo vendosur ndonjë kërkesë specifike në lidhje me autorizimin apo lejen,*

*por është kërkuar thjesht paraqitja e këtij dokumenti pa ndonjë përcaktim tjetër të veçantëapo specific ndaj arsyeja e skualifikimit të dhënë nga ana e AK-së nuk qëndron, dhe një kriter i pakërkuar në dokumentat e tenderit nuk duhet të përbëjë shkak për skualifikim.*

*Autoriteti kontraktor duhet të bëjë vlerësimin e ofertave mbi bazën e kritereve të përcaktuara në dokumentat e tenderit, duke përjashtuar këtu vlerësimin mbi dokumenta shtesë të pakërkuara nga autoriteti kontraktor, të cilat për më tepër janë paraqitur nga OE nkimues. Për pasojë, operatorët ekonomikë pjesmarrës në nëjë procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosuara në dokumentat e tenderit e, rrjedhimisht vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.*

*Në rastin konkret, kur oferta e paraqitur është me çmim më të ulët dhe me leverdi ekonomike, duke kursyer buxhetin e shtetit në një vlerë të konsiderueshme autoriteti kontraktor nuk mund të skualifikojë OE ankimues duke kryer vetëm një vlerësim sipërfaqësordhe tendecioz. Ndaj OE ankimues.*

*Gjithashtu nga ana tjetër oe ankimues ka nënshkruar deklaratën e përmbushjes së specifikimeve teknike, ku deklaron plotësimin e të gjitha specifikimeve teknike, duke marrë përsipër nën përgjegjësinë e tij përmbushjen e këtyre të fundit, ka nënshkruar një sërë deklaratash , ku deklaron se përmbush të gjitha kriteret e kërkuara nga AK.*

*Sa më sipër autoriteti kontraktor duhet të udhëhiqet nga parimi i mirëpërdorimit të fondeve publike dhe përfitimi i një produkti me cilësi të mirë dhe me çmim më të ulët, si dhe nuk duhet të gjykojë në mënyrë sipërfaqësoree formale, aq më tepër në kushte kur kemi një përcaktim të qartë të kritereve dhe dokumentacionit që duhet të paraqitet, dokumentacion ky i cili provohet më së miri se operatori ekonomik ankimues e disponon.*

*Gjithashtu në bazë të nenit 62 "Detyrimet gjatë zbatimit të kontratës" të LPP-së, autoriteti kontraktor ka një rol të posaçëm, për vet cilësimin ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin me sukses të kontratës. Rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për tu siguruar nëse cilësia e mallit/shërbimit do të jetë e njëjtë me cilësinë dhe specifikimet teknike të premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë. Në këtë rast të shkeljes së kushteve të kërkuara, autoriteti kontraktor zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë, apo detyrimet, në mbështetje të nenit 62 të LPP-së, si më sipër cituar.*

*Së gjashti Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, është organi më i lartë në fushën e menaxhimit të burimeve ujore. Ndërmjet shkresës së saj Nr. 1505.1prot, datë 11.12.2019 ka theksuar se subjektet që do të pajisen me leje apo autorizim për përdorimin e burimit ujorduhet të ushtrojnë veprimtarinë pas miratimit të saj. Pra, kushti për pajisjen me leje për përdorim të burimit ujor ndodh pas miratimit të veprimtarisë, më konkretisht pas lidhjes së kontratës administrative të rast të shpalljes fitues të kësaj procedure prokurimi.*

*Referuar ligjit nr. 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore" në asnjë dispozitë të saj nuk parashikohet marrja apo shfrytëzimi i këtyre burimeve ujore sipas pretendimeve të ngritura nga ana e Autoritetit Kontraktor. Edhe nëse i referohemi VKM-së nr. 416 datë 13.05.2015 "Për miratimin e kushteve të posaçme, dokumentet sghoqëruese, afatit të vlefshmërisë. Formularëve të Aplikimit për autorizim dhe leje, proçedurave të shqyrtimit e vendimarrjes dhe fomateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore" qartësisht kuptohet seautorizimi për marrjen e një leje apo autorizim të posaçëm që lidhet me ujin që do të shërbejë enkas për*

*shërbimin e pastrimit të qytetit Vlorë, kryhet vetëm pas miratimit të kontratës (thënë ndryshe shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës përkatëse).*
*Edhe në këtë rast, ky kiter ka shërbyer për favorizimin e shoqërisë DUKA shpk. Në kushtet kur kjo shoqëri është dhe shoqëria që ka ushtruar dhe ka akoma në administrim shërbimin e pastrimit të Qytetit Vlorë, mbetet i vetmi subject juridik i mundshëm i cili të dispononte një dokument ekzaktësisht sipas pretendimeve tuaja. Dokumentat e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit Publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesmarrjen dhe konkurrencën e opeartorëve keonomikë, të stimulojnë pjesm,arrjen e biznesit të vogël e të mesëmsi dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të të gjithë operatorët ekonomikë pjesmarrës në këto procedura, për realizimin me sukses t kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesmarrjes së operatorëve ekonomikë në respect të nenit 1 pika2të LPP-së i cili parashikon shprehimisht:*
*1. Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave që zbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve nga autoritetet kontraktore.*
*2. Qëllimi i këtij ligji është:*
*a) të rrisë efiçencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore;*
*b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
*c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
*ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
*d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*

*Sa më sipër arsyeja e pretenduar për skualifikim nuk qëndron.*

*Lidhur me arsyet për skualifikim:*

*Në pikën 3.3.11 të kritereve të veçanta të kualifikimit për lotin 1 është përcaktuar "Shoqëria ofertuese duhet të disponojë dokumentacionin që për realizimin e kësaj kontrate të ketë këto mjete (në pronësi apo me qira). Këto mjete duhet të jenë të pajisur me dokumentacionin sipas legjislacionit në fuqi. Për mjetet me qira duhet të paraqitet dhe kontrata e qirasë dhe më një afat vlefshmërie jo më pak se një vit. Për mjetet që shënohen në regjistrat public duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton regjistrimin e mjetetit (leje qarkullimi), policën e sigurimit, taksat vjetore të mjetit, si dhe lejen e transportit nga bashkia për vete ose për të tretët. Mjetet duhet të paraqitet në formën e një deklarate ku të përcaktohet targa lloji numri i shasisë. Dokumentacioni për të përmbushur këtë kriter i paraqitur prej shoqërisë "Alko Impex General Construksion" për të gjitha mjetet e ngarkuara në SPE dhe të shoqëruar me deklaratën përkatëse , nuk përmban dokumentin për taksat vjetore të mjetit, sikurse përcaktohet në kriterin e kualifikimit për dokumentacionin që duhet të paraqesë.*

*Kjo arsye e pretenduar për skualifikim nuk qëndron. Në asnjë*
*Në ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008 "Për taksat kombëtare" i ndryshuar, neni 4 "Niveli i taksave kombëtare" ë shtë parashikuar:*

*"[...] e ardhura nga taksa për cdo rast mblidhet nga Strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, drejtorisë Rajonale, para kryerjes së kontrllit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit[...]"*
*Ndërsa në Udhëzimin nr. 8/1, datë 15.05.2013 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 26, datë 09.04.2008 "Për taksat kombëtare" i ndryshuar, thuhet:*
*"[....] Pagesa e taksës bëhet brenda afatit të vlefshmërisë, por gjithsesi përpra kryerjes së kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit pronari i mjetit i cili nuk kryen pagesën e kësaj tase Brenda 10 ditëve nga mbarii i afatit të vlefshmërisë së parashikuar , deyrohet të paguajë një gjobë prej 5% të shumës së detyrimit të papaguar për cdo muaj , por jo më humë se 25% për cdo vit[...]".*
*Bazuar sa më sipër gjykojmë se OE ankimuesi me dokumentacionin e paraqitur, plotëson kriterin e sipërcituar, pasi përpara se automjeti të kalojë procesin e kontrollit, duhet të jenë paguar taksat vjetore të automjetit.*
*Sa më sipër arsyeja e pretenduar për skualifikim nuk qëndron.*

*Lidhur me arsyet për skualifikim:*

*Në pikën 3.3.10 të kritereve të vecanta të kualifikimit për lotin 1 është përcaktuar: "Shoqeria ofertuese duhet te disponoje dokumentacion qe per realizimin e kesaj kontrate te kete keto mjete (ne pronesi ose qira): e. Autofshesa 3 cope (ne pronesi ose me qira) f. Mjet te posacem me goma qe kryen funksionin fshirje dhe larje njekohesisht 1 cope (ne pronesi ose me qira)" Bazuar në dokumentacionin e paraqitur në SPE prej shoqërisë "ALKO-IMPEX GENERAL CONSTRUCTION" dhe të shoqëruar me deklaratën përkatëse, ka paraqitur mjetet me targa AA198TI, AGMT47, AGMT48 për të përmbushur kriterin 3.3.10.e, si dhe ka paraqitur mjetin me targa AA857XM për të përmbushur kriterin 3.3.10.f. Sikurse u sqarua edhe më sipër për këto mjete nuk ka paraqitur dokumentin për taksat vjetore te mjetit, por nga verifikimet e kryera zyrtarisht në Autoritetet Kontraktore ku ky subjekt ushtron aktivitet të ngjashëm me objektin e prokurimit, rezulton se:*
*Mjeti me targa AA198TI me nr.shasie VF644ACA000013207 i deklaruar si "Autofshesë" në Bashkinë Vlorë, rezulton se është deklaruar për tu përdorur si kamion 7.5 – 18 ton në Bashkinë Kavajë, dhe për tu përdorur si Autobot në Bashkinë Tiranë. Bazuar në korrespodencën e mbajtur me këto institucione rezulton se jo vetëm që ky mjet nuk mund përdoret për realizimin e kontratës në Bashkinë Vlorë, pasi është në shërbim të njëkohshëm në dy Bashki të tjera, por edhe të dhënat për llojin dhe funksionin e mjetit janë kondradiktore, pasi në tre Bashki të ndryshme i njëjti mjet me të njëjtin shasi deklarohet njëkohësisht si autofshesë, si autobot, si kamion transportues.*
*Mjeti me targa AGMT48 me nr.shasie SA92V5CXXA4068157 i deklaruar si "Autofshesë" në Bashkinë Vlorë, rezulton se është deklaruar edhe në Bashkinë Kavajë dhe në Bashkinë Tiranë. Bazuar në korrespodencën e mbajtur me këto institucione rezulton se ky mjet nuk mund përdoret për realizimin e kontratës në Bashkinë Vlorë, pasi është në shërbim të njëkohshëm në dy Bashki të tjera.*
*Mjeti me targa AA857XM me nr.shasie VF644ACA000013903 i deklaruar si "Mjet te posacem me goma qe kryen funksionin fshirje dhe larje njekohesisht" në Bashkinë Vlorë, rezulton se është deklaruar për tu përdorur si kamion 7.5 – 18 ton në Bashkinë Kavajë. Bazuar në korrespodencën*

*e mbajtur me këto institucione rezulton se jo vetëm që ky mjet nuk mund përdoret për realizimin e kontratës në Bashkinë Vlorë, pasi është në shërbim të njëkohshëm edhe në një Bashki tjetër, por edhe të dhënat për llojin dhe funksionin e mjetit janë kondradiktore, pasi në dy Bashki të ndryshme i njëjti mjet me të njëjtin shasi deklarohet njëkohësisht si mjet fshirës dhe si kamion transportues. Për sa më lart, shoqëria "ALKO-IMPEX GENERAL CONSTRUCTION" jo vetëm nuk ka plotësuar kriterin e vecantë të kualifikimit për sasinë dhe llojet e mjeteve, por edhe bazuar në nenin 46/1/b të LPP-së, nuk ka vërtetuar se "zotëron makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës", si dhe bazuar në nenin 53/3 të LPP-së, oferta e paraqitur "nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit".*

*Së pari përsa i përket pretendimit nga ana e autoritetit kontrator për pagimin e taksave vjetore është një argument i mirë trajtuar më sipër.*
*Se dyti, nga ana e autoritetit kontraktor per asnje cast nuk eshte trajtuar apo kerkuar ne DST se mjetet e paraqitura ne momentin e pjesmarrjes ne proceduren e prokurimit nuk jane te angazhuara ne kontrate te tjera. Nese i referohemi DST ne kete eshte kerkuar nga ana e AK:*
*1. Shoqeria ofertuese duh.et te disponoje dokumentacion qe per realizitnin e kesaj kontrate te kete keto mjete (ne pronesi ose qira):*
*- ..... Keto mjete duhet te jene te pajisur me dokumentacion sipas legjislacionit ne fuqi. Per mjetet qe jane me qira duhet te paraqitet edhe kontrata e qirase me nje afat vlefshmerie jo me pak se nje vit. Per mjetet qe shenohen ne regjistra publike duhet te paraqitet dokumenti qe verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), policen e sigurimit, taksat vjetore te mjetit, si dhe lejen e transportit nga bashkia per vete ose të trete.*
*- Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten re verifikoje dhe kontrolloje ne cdo kohe deri ne perfundimin e kontrates mjetet e pajisjet teknike të deklaruara.*
*- Mjetet duhet te paraqiten ne formen e nje deklarate ku te percaktohen targat, lloji, numri i shasise.*
*Ne rast se mjetet jane me kontrata qiraje, afati i tyre duhet te jete minimalisht nje vit nga dita e lidhjes se kontratës*
*Pra nga leximi i kriterit te percaktuar nga AK ne DST ne asnje rast nuk parashikohet apo te nenkupohet se mjetet ne momentin e aplikimit ne proceduren e prokurimit nuk duhet te jene te angazhuara ne kontrata te tjera.*
*Autoriteti kontraktor duhet te beje vleresimin e ofertave mbi bazen e kritereve te percaktuara ne dokumentat e tenderit, duke perjashtuar ketu vleresimin mbi dokumenta shtese te pakerkuara nga autoriteti kontraktor.*
*Ne nenin 53, pika 3 te ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet: "Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.*
*Ne asnje rast autoriteti kontraktor nuk mund te skualifikoje apo te vleresoje nje oferte tej atyre te parashikuara ne DST. Kritetert e parashikuara ne DST jane kufiri maksimal i kritereve te kerkuara*

*nga AK dhe cdo konstatim apo kerkim i AK-se tej atyre te parashikuara ne DST eshte ne kundershtim me ligjin dhe absolutisht i pavlefshern.*
*Gjithashtu, ne SPE, rezulton se OE ankimues ka paraqitur dokumentacion si me poshte:*
*- Deklarate mbi disponueshmerine e mjeteve, ku jane percaktuar mjetet qe do te jene ne dispozicion per kryerjen e ketij sherbimi;*
*- Deklarate mbi mjetet ku percaktohet se autoriteti kontraktor rezervon te drejten per verifikimin fizik.*
*- Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike.*
*Nga verifikimi i dokuemntave të tenderit , rezulton se janë përcaktuar kriteret e përgjithshme dhe kriteret e vecanta për kualifikim, nga ku evidentohet të jetë përcaktuar vetëm kriteri mbi disponimin e mjeteve të cilat duhet të shoqërohet me dokumentacion përkatës dhe në asnjë rast nuk është përcaktuar ndonjë kërkesë në lidhje me angazhimin ose jo të këtyre mjeteve në kontrata të tjera.*
*Autoriteti kontraktor duhet te beje vleresimin e ofertave mbi bazen e kritereve te percaktuara ne dokumentat e tenderit, duke perjashtuar ketu vleresimin mbi dokumenta shtese te pakerkuara nga autoriteti kontraktor,*
*Per pasoje, operatoret ekonomikë pjesemarres ne një procedure prokurimi duhet te plotesojne vetem kerkesat e vendosura ne dokumentat e tenderit e rrjedhimisht vleresimi e kualifikimi i tyre duhet te behet ne perputhje vetem me keto kerkesa.*

*Gjithashtu, nga ana tjeter, OE ankimues ka nenshkruar deklaratën e permbushjes se specifikimeve teknike, ku deklaron plotesimin e te gjitha specifikimeve teknike, duke marre persiper nen pergjegjesine e tij permbushjen e ketyre te fundit, ka nenshkruar nje sere deklaratash, ku deklaron llojin e mjetit duke e specifikuar me mjetin e kerkuar ne dokumentat e tenderit, deklarate ku i jep te drejten autoritetit per te bere verifikimin ne vend te mjetit dhe aq me teper ka dorezuar edhe foto te tyre nga ku konstatohen te dhena dhe elementet specifike te pershkruar ne to ne lidhje me mjetet. Sqarojme se autoriteti kontrator, nese ka paqartesi, bazuar edhe ne percaktimet ne ligjin dhe rregullat e prokurirnit publik, duhet te kerkoje sqarime te metejshrne, ne rastet kur kemi te bejme me elemente te paqarta, me qellim shmangien e skualifikimit me te padrejte te nje operatori ekonomik pjesemarres ne proceduren e prokurimit.*
*Sa me siper, autoriteti kontraktor, duhet te udhehiqet nga parimi i mireperdorimit te fondeve publike dhe perfitimi i nje produkti me cilesi te mire dhe me cmim me te ulet, si edhe nuk duhet te gjykoje ne menyre siperfaqesore e formale, aq me teper ne kushte kur kemi nje percaktim te qarte te kritereve dhe dokumentacionit qe duhet te paraqitet, dokumentacion ky i cili provohet me se miri se operatori ekonomik ankimues e disponon.*
*Gjithashtu, ne baze te nenit 62 "Detyrimet gjate zbatimit te kontrates" te LPP, autoriteti kontraktor ka nje rol te posacem, per vete cilesimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe pergjegjesi thelbesore per realizimin e suksesshern te kontrates. R rregullave te prokurimit publik, eshte pikerisht autoriteti kontraktor ai qe duhet te monitorojë zbatimin e kontrates, per t'u siguruar nese cilesia e mallit/sherbimit do te jete e njejte me cilesine dhe specifikimet teknike te premtuar ne oferte dhe te percaktuar ne kontrate. Ne rast te shkeljes se kushteve te kerkuara, autoriteti kontraktor zbaton penalitetet e parashikuara ne kontrate, apo detyrimet, ne rnbeshtetje te nenin 62 te LPP-se, si me siper cituar.*

*Persa i perket pretendimit te Autoritet Kontratkor se nga verifikimet e kryera disa prej mjeteve te sipercituara rezulton ndryshe nga ato te deklaruar nga kete procedure prokurimi sqarojme se:*
*Se pari, mjetet e sipercituara referuar dhe lejes se qarkullimit jane mjete APV (automjet per perdorim te vencate) te cilet kryejne disa funksione. Ne varesi te nevoja te sherbimit apo dhe kerkesave te AK-se keto mjetet kryejne funksionet e kerkuara sipas ne jave qe shoqeria ka. Autoriteti Kontraktor ne cdo rast ka mundesine e verifikimit fizik të tyre.*
*Ne asnje cast, skualfikimi i nje operatori ekonomik pjesmarres nuk mund të kryhet mbi hamendsime ap dyshime të autoritetit kontraktor.*
*Neni 53 i ligjit për prokurimin public përcakton shprehimisht se: "Autoriteti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në nenet 32 dhe 33 të këtij ligji, nuk duhet të kërkohet, ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.". Në rastin konkret, kur edhe oferta e paraqitur eshte me cmim me te ulet dhe me leverdi ekonomike, duke kursyer buxhetin e shtetit ne nje vlere te konsiderueshrne, autoriteti kontraktor nuk mund te skualifikoje OE ankimues pa marre edhe sqarimet perkatese, aq me teper ne kushtet kur, autoriteti ka dhe mundesine proceduriale te verifikimit fizik te tyre.*
*Gjithashtu , në bazë të nenit 62 "Detyrimet gjatë zbatimit të kontratës" të LPP-së autoriteti kontraktor ka nje rol te posacem, per vete cilesimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe pergjegjesi thelbesore per realizimin e suksesshem te kontrates.R rregullave te prokurimit publik, eshte pikerisht autoriteti kontraktor ai qe duhet te monitoroje zbatimin e kontrates, per t'u siguruar nese cilesia e mallit/sherbirnit do te jete e njejte me cilesine dhe specifikimet teknike te premtuar ne oferte dhe te percaktuar ne kontrate. Ne rast te shkeljes se kushteve te kerkuara, autoriteti kontraktor zbaton penalitetet e parashikuara ne kontrate, apo detyrimet, ne mbeshtetje te nenin 62 te LPP-se, si me siper cituar.*

*Lidhur me arsyen tjeterper skualifikim:*

*- Në pikën 3.3.10 të kritereve të vecanta të kualifikimit për lotin 1 është përcaktuar: "Shoqeria ofertuese duhet te disponoje dokumentacion qe per realizimin e kesaj kontrate te kete keto mjete (ne pronesi ose qira): b. Kamion me kapacitet transportues 15 - 25 ton 2 cope (ne pronesi ose me qira)" Bazuar në dokumentacionin e paraqitur në SPE prej shoqërisë "ALKO-IMPEX GENERAL CONSTRUCTION" dhe të shoqëruar me deklaratën përkatëse, ka paraqitur mjetet me targa AA081RS, AA539TI, AA631PB, AA865SD, AA871SD për të përmbushur kriterin 3.3.10.b. Sikurse u sqarua edhe më sipër për këto mjete nuk ka paraqitur dokumentin për taksat vjetore, por nga verifikimet e kryera zyrtarisht në Autoritetet Kontraktore ku ky subjekt ushtron aktivitet të ngjashëm me objektin e prokurimit rezulton se:*
*Mjeti me targa AA081RS i deklaruar në deklaratën e mjeteve të paraqitur në Bashkinë Vlorë si kamion me kapacitet transportues 15 – 25 ton, bazuar në lejen e qarkullimit të paraqitur rezulton se është me kapacitet 27 ton (40000 kg me ngarkesë – 12912 kg pa ngarkesë). Ky mjet është mbi kapacitetin transportues të kërkuar në kriterin e kualifikimit.*
*Mjeti me targa AA853NJ i deklaruar në deklaratën e mjeteve të paraqitur në Bashkinë Vlorë si kamion me kapacitet 20 ton, i marrë me qira me kontratën me nr.9778rep dhe nr.6809 kol, bazuar*

*në dokumentin për pagimin e taksave vjetore të paraqitur rezulton se është lëshuar dhe paguar në datë 13.12.2018 që me një afat vlefshmërie prej 1 vit del që ka përfunduar në datë 12.12.2019, ndërkohë që afati për hapjen e ofertave të kësaj procedure ka qenë data 06.01.2020.*

*Ne DST nga ana e AK-se eshte kerkuar:*
*Kamion me kapacitet transportues 15-25 ton 2 copë në pronësi ose me qira*
*Referuar dokumentacionit te kerkuar por dhe pretendimet te ngritur prej jush sqarojme se persa i perket taksave vendore per te mos rene ne perseritje eshte nje argument i sqaruar same siper dhe I cili nuk perben shkak per skualifikim.*
*Edhe ju vet ne argumentin qe jepni sqaroni se ne plotesim te kriterin jane paraqitur nje nurner i konsiderueshem mjetesh kunderjt atyre te kerkuara nga AK (2 cope). Persa i perket pretendimit mbi kapacitet mbajtes te mejtit sqarojme se ato ndryshime te cilat ne thelb nuk ndryshojne karakteristikat e mjetit apo kapacitetit te tyre.*
*Ne kete rast po ti referohemi ligjit Nr.9643, date 20.11.2006, ndryshuar me ligjin Nr.9800 date 10.09.2007, ligjin Nr. 9855 date 26.12.2007, ligjin nr. 10170, date 22.10.2009, dhe ligjin nr.10 309, date 22.07.2010, i cili eshte rregullatori kryesor per procedurat e prokurimit publik, ne nenin 53 thote: Shqyrtimi i ofertave "4. Autoriteti kontraktor vlereson nje oterte te vlefshme edhe nese ajo permben devijime te vogla, te argumentuara, te cilat nuk ndrvshojne thelbesisht: karakteristikat, kushtet dhe kerkeset e tjera, te percektuere ne dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, te cilat rnund te korrigjohen pa prekur permbajtjen e saj."*
*Gjithashtu , në bazë të nenit 62 "Detyrimet gjatë zbatimit të kontratës" të LPP-së autoriteti kontraktor ka nje rol te posacem, per vete cilesimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe pergjegjesi thelbesore per realizimin e suksesshem te kontrates. Rregullave te prokurimit publik, eshte pikerisht autoriteti kontraktor ai qe duhet te monitoroje zbatimin e kontrates, per t'u siguruar nese cilesia e mallit/sherbirnit do te jete e njejte me cilesine dhe specifikimet teknike te premtuar ne oferte dhe te percaktuar ne kontrate. Ne rast te shkeljes se kushteve te kerkuara, autoriteti kontraktor zbaton penalitetet e parashikuara ne kontrate, apo detyrimet, ne mbeshtetje te nenin 62 te LPP-se, si me siper cituar.*
*Akoma me tej sqarojme se persa i perket pretendimit mbi perfundimit e taksave vjetore ju bejme me dijse se:*
*Ne ligjin nr.9975, date 28.07.2008 "Per taksat kombetare", i ndryshuar, neni 4 "Niveli i taksave kombetare, eshte parashikuar:*
*"[ ... ] E ardhura nga taksa , per cdo rast, mblidhet nga strukturat e Drejtorise se Pergjithshme le Sherbimeve te Transportit Rrugor, drejtorise rajonale, para krveries se kontrollit teknik vietor te detvrueshem te mietit [ ...]."*
*Ndersa ne Udhezimin m.8/1, date 15.05.2013 "Per disa shtesa e ndryshime ne Udhezimin nr.26, date 09.04.2008 "Per taksat kombetare", i ndryshuar", thuhet: "[...] Pagesa e takses behet brenda afatit te vlefshmerise, por 2iitlmie vara krveries se kontrollit teknik vietor te detvrueshem te mietit. Pronari i mjetit, i cili nuk kryen pagesen e kesaj takse brenda 10 diteve nga mbarimi i afatit te vlefshemrise se parashikuar, detyrohet te paguaje nje gjobe prej 5% të shumës se detyrimit te papaguar per cdo muaj por jo me shume se 25% per cdo vit. [. . .]" .*
*Si rrjedhojë pretendimi juaj është i pabazuar , tendecioz dhe jo në proporcion të drejtë me dokuemntat e paraqitura nga OE tjetër pjesmarrës.*

*Nëse AK-ja do të kryente të njëjtën verifikim dhe metodologji edhe për subjektin tjetër ofertues sqarojmë se duhet të vendoste skualifikimin edhe për oferuesin tjetër.*
*Lidhur me arsyen tjetër për skualifikim:*
*• Mjeti me targa AA539TI i deklaruar në deklaratën e mjeteve të paraqitur në Bashkinë Vlorë si kamion pastrimi, rezulton se është me kapacitet 6,8 ton ton (19000 kg me ngarkesë – 12150 kg pa ngarkesë). Ky mjet është nën kapacitetin e kërkuar në kriterin e kualifikimit. Për këtë mjet edhe pse shkruhet në deklaratën e mjeteve të paraqitur më emërtimin "kamion pastrimi", pa u sqaruar nëse është mjet teknologjik apo kamion, në të dyja rastet, si do që të jetë është nën kapacitetin e kërkuar në dst.*
*• Mjeti me targa AA631PB i deklaruar në deklaratën e mjeteve të paraqitur në Bashkinë Vlorë si kamion pastrimi, rezulton se është me kapacitet 5,8 ton ton (19000 kg me ngarkesë – 13200 kg pa ngarkesë). Ky mjet është nën kapacitetin e kërkuar në kriterin e kualifikimit. Për këtë mjet edhe pse shkruhet në deklaratën e mjeteve të paraqitur më emërtimin "kamion pastrimi", pa u sqaruar nëse është mjet teknologjik apo kamion, por që sipas fotots rezulton të jetë mjet teknologjik, në të dyja rastet, si do që të jetë është nën kapacitetin e kërkuar në dst.*

*Kjo arsye per skualfikim eshte e pabazuar dhe e pambeshtetur as ne ligj e asnje ne kriteret e vecanta per kualfikim. Se pari, termi kamion pastrimi nuk ka asnje ndryshim per nga termi kamion teknologjik. Ky pretendim nuk mund te perbeje shkak ne asnje rast per skualfikim,*
*Nga ana e OE ankimues jane paraqitur nje sere deklaratash dokumenta foto etj, te cilat qartazi tregojne mbi llojin dhe karakteristikat e ketyre mjeteve. Akoma me tej sqarojme se neni 53 i ligjit per prokurimin publik, percakton shprehimisht se: "Autoriteti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kerkon ofertuesve sqarime per ofertat e tyre, per shqyrtimin, vleresimin dhe krahasimin sa me te drejte te ketyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara ne nenet 32 dhe 33 te ketij ligji, nuk duhet te kerkohet, ofrohet apo lejohet asnje ndryshim ne permbajtjen e ofertes, per/shire ndryshimet ne cmim apo ndryshime qe synojne te kthejne nje oferte te pavlefshme ne te vlefshme". Ne rastin konkret, kur edhe oferta e paraqitur eshte me cmim me te ulet dhe me leverdi ekonomike, duke kursyer buxhetin e shtetit ne nje vlere te konsiderueshme, autoriteti kontraktor nuk mund te skualifikoje OE ankimues pa marre edhe sqarimet perkatese, aq me teper ne kushtet kur, autoriteti ka dhe mundesine proceduriale te verifikimit fizik te tyre.*
*Gjithashtu , në bazë të nenit 62 "Detyrimet gjatë zbatimit të kontratës" të LPP-së autoriteti kontraktor ka nje rol te posacem, per vete cilesimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe pergjegjesi thelbesore per realizimin e suksesshem te kontrates. Rregullave te prokurimit publik, eshte pikerisht autoriteti kontraktor ai qe duhet te monitoroje zbatimin e kontrates, per t'u siguruar nese cilesia e mallit/sherbirnit do te jete e njejte me cilesine dhe specifikimet teknike te premtuar ne oferte dhe te percaktuar ne kontrate. Ne rast te shkeljes se kushteve te kerkuara, autoriteti kontraktor zbaton penalitetet e parashikuara ne kontrate, apo detyrimet, ne mbeshtetje te nenin 62 te LPP-se, si me siper cituar.*
*Akoma më tej ju bëjmë me dije këto mjete janë paraqitur për të provuar kapacitetin e OE ankimues i cili është tej atyre të parashikuara në DST thjesht që autoriteti kontraktor të krijojë një panoramë më të gjerë mbi kapacitetin e OE ankimues. Në asnjë rast nga ana e AK-së nuk argumentohet se cili numër mjetesh nuk plotësohet nga OE ankimues edhe sikur këto dokumenta apo mjete të mos ishin paraqitur fare në këtë procedurë prokurimi. Sa më sipër në kushtet kur këto mjete nuk kanë*

*patur për qëllim në vetvetenë plotësim të ndonje kriteri specific por vetëm për të treguar kapacitet teknike të ofertuesit nuk mund të perbëjë shkak për skualifikim.*

*Lidhur me arsyen tjëtër për skualifikim:*

*Mjeti me targa AA865SD i deklaruar në deklaratën e mjeteve të paraqitur në Bashkinë Vlorë, me emërtimin "kamion pastrimi", rezulton se është deklaruar për tu përdorur në Bashkinë Kavajë, rezulton se është deklaruar për tu përdorur si makinë teknologjike në Bashkinë Devoll, si dhe rezulton se është deklaruar për tu përdorur si kompatator në Bashkinë Tiranë. Bazuar në korrespodencën e mbajtur me këto institucione rezulton se jo vetëm që ky mjet nuk mund përdoret për realizimin e kontratës në Bashkinë Vlorë, pasi është në shërbim të njëkohshëm në tre Bashki të tjera, por edhe të dhënat për llojin dhe funksionin e mjetit janë kontradiktore, pasi në katër Bashki të ndryshme i njëjti mjet me të njëjtin shasi deklarohet njëkohësisht si kamion transportues, si makinë teknologjike, si kompatator.*

*Nga ana e autoritetit kontraktoir për asnjë cast nuk është trajtuar apo kërkuar në DST se mjetet e paraqitura në momentin e pjesmarrjes në procedurën e prokurimit nuk janë të anagazhuara në kontratë tjetër. Nëse i referohemi DST-ve në këto është kërkuar nga AK-ja:*
*Shoqëria oferuese duhet të disponojë dokumentacion që për realizimin e kësaj kontrate të ketë këto mjete në pronësi ose me qira:*
*Keto mjete duhet te jene te pajisur me dokumentacion sipas legjislacionit ne fuqi. Per mjetet qe jane me qira duhet te paraqitet edhe kontrata e qirase me nje afat vlefshmerie jo me pak se nje vii. Per mjetet qe shenohen ne regjistra publike duhet te paraqitet dokumenti qe verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), policen e sigurimit, taksat vjetore të mjetit, si dhe lejen e transportit nga bashkia per vete ose te trete.*
*- Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikoje dhe kontrolloje ne cdo kohe deri ne perfundimin e kontrates mjetet e pajisjet teknike te deklaruara.*
*- Mjetet duhet të paraqiten ne formen e nje deklarate ku te percaktohen targat, lloji, numri i shasise.*
*Ne rast se mjetet jane me kontrata qiraje, afati i tyre duhet te jete minimalisht nje vit nga dita e lidhjes se kontrates.*
*Pra leximi i kriterit të përcaktuar nga AK në DST në asnjë rast nuk parashikohet apo nënkuptohet se mjetet në momentin e aplikimit në procedurën e prokurimit nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera.*
*Autoriteti kontraktor duhet të bëjë vlerësimin e ofertave mbi bazën e kriterve të përcaktuara në dokumentat e tenderitduke përjashtuar këtu vlerësimin mbi dokumenta shtesë të pakërkuara nga autoriteti kontraktor. Në nenin 53 pika 3 e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin public" i ndryshuar, parashikohet: "Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitah kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe dokumentat e tenderit…"*
*Në asnjë rast autoriteti kontraktor nuk mund të skualifikojë apo të vlerësojë një ofertë tej atyre të parashikuara në DST. Kriteret e parashikuara në DST janë kufiri maksimal i kritereve të kërkuara*

nga AK dhe cdo konstatim apo kërkim i AK-së tej atyre të parashikuara në DST është në kundështim me ligjin dhe absolutisht i pavlefshëm.
Gjithashtu, ne SPE, rezulton se OE ankimues ka paraqitur dokumentacion si me poshte:
- Deklarate mbi disponueslnnerine e mjeteve, ku jane percaktuar mjetet qe do te jene ne dispozicion per kryerjen e ketij sherbimi;
- Deklarate mbi mjetet ku percaktohet se autoriteti kontraktor rezervon te drejten per verifikim fizik
- Deklarate mbi perrnbushjen e specifikimeve teknike.

Nga verifikimi i dokumentave te tenderit, rezulton se jane percaktuar kriteret e pergjithshme dhe kriteret e vecanta per kualifikim, nga ku evidentohet te jete percaktuar vetem kriteri mbi disponimin e mjeteve te cilat duhet te shoqerohet me dokumetnacion perkates dhe ne asnje rast nuk eshte percaktuar ndonje kerkese ne lidhje me angazhimin ose jo te ketyre mjeteve ne kontrata te tjera.
Autoriteti kontraktor duhet te beje vleresimin e ofertave mbi bazen e kritereve te percaktuara ne dokumentat e tenderit, duke perjashtuar ketu vleresimin mbi dokumenta shtese te pakerkuara nga autoriteti kontraktor,
Per pasoje, operatoret ekonomikë pjesemarres ne nje procedure prokurimi duhet te plotesojne vetem kerkesat e vendosura ne dokumentat e tenderit e, rrjedhimisht, vleresimi e kualifikimi i tyre duhet te behet ne perputhje vetem me keto kerkesa.
Gjithashtu , në bazë të nenit 62 “Detyrimet gjatë zbatimit të kontratës” të LPP-së autoriteti kontraktor ka nje rol te posacem, per vete cilesimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe pergjegjesi thelbesore per realizimin e suksesshem te kontrates. Rregullave te prokurimit publik, eshte pikerisht autoriteti kontraktor ai qe duhet te monitoroje zbatimin e kontrates, per t'u siguruar nese cilesia e mallit/sherbirnit do te jete e njejte me cilesine dhe specifikimet teknike te premtuar ne oferte dhe te percaktuar ne kontrate. Ne rast te shkeljes se kushteve te kerkuara, autoriteti kontraktor zbaton penalitetet e parashikuara ne kontrate, apo detyrimet, ne mbeshtetje te nenin 62 te LPP-se, si me siper cituar.
Sa më sipër autoriteti kontraktor duhet të udhëhiqet nga parimi i mirëpërdorimit të fondeve publike dhe përfitimi i një produkti me cilësi të mirë dhe me cmim të ulët, si dhe nuk duhet të gjykojë në mënyrë sipërfaqësore e formale aq më tepër në kudshtet kur kemi një përcaktim të qartë të kritereve dhe dokumentacionit që duhet të paraqitet, dokuemntacion ky i cili provohet më së miri se operatori ekonomik ankimues e disponon.
Gjithashtu , në bazë të nenit 62 “Detyrimet gjatë zbatimit të kontratës” të LPP-së autoriteti kontraktor ka nje rol te posacem, per vete cilesimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe pergjegjesi thelbesore per realizimin e suksesshem te kontrates. Rregullave te prokurimit publik, eshte pikerisht autoriteti kontraktor ai qe duhet te monitoroje zbatimin e kontrates, per t'u siguruar nese cilesia e mallit/sherbirnit do te jete e njejte me cilesine dhe specifikimet teknike te premtuar ne oferte dhe te percaktuar ne kontrate. Ne rast te shkeljes se kushteve te kerkuara, autoriteti kontraktor zbaton penalitetet e parashikuara ne kontrate, apo detyrimet, ne mbeshtetje te nenin 62 te LPP-se, si me siper cituar.
Persa i perket pretendimit te Autoritet Kontratkor se nga verifikimet e kryera disa prej mjeteve te sipercituara rezulton ndryshe nga ato te deklaruar nga kete procedure prokurirni sqarojme se:

*termi kamion pastrimi nuk ka asnje ndryshim per nga termi kamion teknologjik apo kompatator. Ky pretendim nuk mund te perbeje shkak ne asnje rast per skualfikim.*

*Nga ana e OE ankimues jane paraqitur nje sere deklaratash, dokumenta foto etj, te cilat qartazi tregojne mbi llojin dhe karakteristikat e ketyre mjeteve. Akoma me tej sqarojme se neni 53 i ligjit per prokurimin publik, percakton shprehimisht se: "Autoriteti kontraktor, kur e shikon te arsyeshme, u kerkon ofertuesve sqarime per ofertat e tyre, per shqyrtimin, vleresimin dhe krahasimin sa me te drejte të ketyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara ne nenet 32 dhe 33 te ketij ligji, nuk duhet te kerkohet, ofrohet apo lejohet asnje ndryshim ne permbajtjen e ofertes, perfshire ndryshimet ne cmim apo ndryshime qe synojne të kthejne nje oferte të pavlefshme ne te vlefshme". Ne rastin konkret, kur edhe oferta e paraqitur eshte me cmim me te ulet dhe me leverdi ekonomike, duke kursyer buxhetin e shtetit ne nje vlere te konsiderueshme, autoriteti kontraktor nuk mund te skualifikoje OE ankimues pa marre edhe sqarimet perkatese, aq me teper ne kushtet kur, autoriteti ka dhe mundesine proceduriale te verifikimit fizik te tyre.*

*Lidhur me arsyen tjëtër për skualifikim:*

*Mjeti me targa AA871SD i deklaruar në deklaratën e mjeteve të paraqitur në Bashkinë Vlorë, me emërtimin "kamion pastrimi", rezulton se është deklaruar për tu përdorur në Bashkinë Kavajë, rezulton se është deklaruar për tu përdorur si makinë teknologjike në Bashkinë Devoll, si dhe rezulton se është deklaruar për tu përdorur si kompatator në Bashkinë Tiranë. Bazuar në korrespodencën e mbajtur me këto institucione rezulton se jo vetëm që ky mjet nuk mund përdoret për realizimin e kontratës në Bashkinë Vlorë, pasi është në shërbim të njëkohshëm në tre Bashki të tjera, por edhe të dhënat për llojin dhe funksionin e mjetit janë kontradiktore, pasi në katër Bashki të ndryshme i njëjti mjet me të njëjtin shasi deklarohet njëkohësisht si kamion transportues, si makinë teknologjike, si kompatator.*

*Për sa më lart, shoqëria "ALKO-IMPEX GENERAL CONSTRUCTION" jo vetëm nuk ka plotësuar kriterin e vecantë të kualifikimit për sasinë dhe llojet e mjeteve, por edhe bazuar në nenin 46/1/b të LPP-së, nuk ka vërtetuar se "zotëron makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës", si dhe bazuar në nenin 53/3 të LPP-së, oferta e paraqitur "nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit".*

*nga ana e autoritetit kontraktor per asnje cast nuk eshte trajtuar apo kerkuar ne DST se mjetet e paraqitura ne momentin e pjesmarrjes ne proceduren e prokurimit nuk jane te angazhuara ne kontrate te tjera. Nese i referohemi DST ne kete eshte kerkuar nga ana e AK:*

3. *Shoqeria ofertuese duhet të disponoje dokumentacion që për realizimin e kesaj kontrate te kete keto mjete (ne pronesi ose qira):*

*- ..... Keto mjete duhet te jene te pajisur me dokumentacion sipas legjislacionit ne fuqi. Per mjetet qe jane me qira duhet të paraqitet edhe kontrata e qirase me nje afat vlefshmerie jo me pak se 1*

*(një vit). Per mjetet qe shenohen ne regjistra publike duhet te paraqitet dokumenti qe vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), policen e sigurimit, taksat vjetore te mjetit, si dhe lejen e transportit nga bashkia per vete ose te trete.*
*- Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikoje dhe kontrolloje ne cdo kohe deri ne perfundimin e kontrates mjetet e pajisjet teknike te deklaruara.*
*- Mjetet duhet te paraqiten ne formen e nje deklarate ku te percaktohen targat, lloji, numri i shasise.*
*Ne rast se mjetet jane me kontrata qiraje, afati i tyre duhet te jete minimalisht nje vit nga dita e lidhjes se kontrates.*
*Pra nga leximi i kriterit te percaktuar nga AK ne DST ne asnje rast nuk parashikohet apo te nenkupohet se mjetet ne momentin e aplikimit ne proceduren e prokurimit nuk duhet te jene te angazhuara ne kontrata te tjera.*
*Autoriteti kontraktor duhet te beje vleresimin e ofertave mbi bazen e kritereve te percaktuara ne dokumentat e tenderit, duke perjashtuar ketu vleresimin mbi dokumenta shtese te pakerkuara nga autoriteti kontraktor.*
*Ne nenin 53, pika 3 te ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet: "Autoriteti kontraktor, ne zbatim te pikes 4 te ketij neni, vlereson nje oferte te vlefshme, vetem nese ajo eshte ne perputhje me te gjitha kerkesat dhe specifikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentat e tenderit ... ".*
*Ne asnje rast autoriteti kontraktor nuk mund te skualifikoje apo te vleresoje nje oferte tej atyre te parashikuara ne DST. Kritetert e parashikuara ne DST jane kufiri maksimal i kritereve te kerkuara nga AK dhe cdo konstatim apo kerkim i AK-se tej atyre te parashikuara ne DST eshte ne kundershtirn me ligjin dhe absolutisht i pavlefshëm.*
*Gjithashtu në SPE, rezulton se OE ankimues ka paraqitur dokuemntacion si më sposhtë:*
*- Deklarate mbi disponueshmerine e mjeteve, ku jane percaktuar mjetet qe do te jene ne dispozicion per kryerjen e ketij sherbimi;*
*- Deklarate mbi mjetet ku percaktohet se autoriteti kontraktor rezervon te drejten per verifikimin fizik.*
*- Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike.*
*Nga verifikimi i dokumentave te tenderit, rezulton se jane percaktuar kriteret e pergjithshme dhe kriteret e vecanta per kualifikim, nga ku evidentohet te jete percaktuar vetem kriteri mbi disponimin e mjeteve te cilat duhet te shoqerohet me dokumetnacion perkates dhe ne asnje rast nuk eshte percaktuar ndonje kerkese ne lidhje me angazhimin ose jo te ketyre mjeteve ne kontrata te tjera.*
*Autoriteti kontraktor duhet te beje vleresimin e ofertave mbi bazen e kritereve te percaktuara ne dokumentat e tenderit, duke perjashtuar ketu vleresimin mbi dokumenta shtese te pakerkuara nga autoriteti kontraktor,*
*Për pasojë, operatoret ekonomikë pjesemarres ne nje procedure prokurimi duhet te plotesojne vetem kerkesat e vendosura ne dokurnentat e tenderit e, rrjedhimisht, vleresimi e kualifikimi i tyre duhet te behet ne perputhje vetem me keto kerkesa.*
*Gjithashtu, nga ana tjeter, OE ankimues ka nenshkruar deklaraten e permbushjes se specifikimeve teknike, ku deklaron plotësimin e te gjitha specifikimeve teknike, duke marre persiper nen pergjegjesine e tij perrnbushjen e ketyre te fundit, ka nenshkruar nje sere deklaratash, ku deklaron*

*llojin e mjetit duke e specifikuar me mjetin e kerkuar ne dokumentat e tenderit, deklarate ku i jep te drejten autoritetit per te bere verifikimin ne vend te mjetit dhe aq me teper ka dorezuar edhe foto te tyre nga ku konstatohen te dhena dhe elementet specifike te pershkruar ne to ne lidhje me mjetet. Sqarojme se autoriteti kontrator, nese ka paqartesi, bazuar edhe ne percaktimet ne ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, duhet te kerkoje sqarime te metejshme, ne rastet kur kemi te bejme me elemente te paqarta, me qellim shmangien e skualifikimit mete padrejte te nje operatori ekonomik pjesemarres ne proceduren e prokurimit.*

*Sa me siper, autoriteti kontraktor, duhet te udhehiqet nga parimi i mireperdorimit te fondeve publike dhe perfitimi i nje produkti me cilesi te mire dhe me cmim me te ulet, si edhe nuk duhet te gjykoje ne menyre siperfaqesore e formale, aq me teper ne kushte kur kemi nje percaktim te qarte te kritereve dhe dokumentacionit qe duhet te paraqitet, dokumentacion ky i cili provohet me se miri se operatori ekonomik ankimues e disponon.*

*Gjithashtu , në bazë të nenit 62 "Detyrimet gjatë zbatimit të kontratës" të LPP-së autoriteti kontraktor ka nje rol te posacem, per vete cilesimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe pergjegjesi thelbesore per realizimin e suksesshem te kontrates. Rregullave te prokurimit publik, eshte pikerisht autoriteti kontraktor ai qe duhet te monitoroje zbatimin e kontrates, per t'u siguruar nese cilesia e mallit/sherbirnit do te jete e njejte me cilesine dhe specifikimet teknike te premtuar ne oferte dhe te percaktuar ne kontrate. Ne rast te shkeljes se kushteve te kerkuara, autoriteti kontraktor zbaton penalitetet e parashikuara ne kontrate, apo detyrimet, ne mbeshtetje te nenin 62 te LPP-se, si me siper cituar.*

*Persa i perket pretendimit te Autoritetit Kontratkor se nga verifikimet e kryera disa prej mjeteve te sipercituara rezulton ndryshe nga ato te deklaruar nga kete procedure prokurimi sqarojme se: termi kamion pastrimi nuk ka asnje ndryshim per nga termi kamion teknologjik apo kompatator. Ky pretendim nuk muncl te perbeje shkak ne asnje rast per skualifikim.*

*Nga ana e OE ankimues jane paraqitur nje sere deklaratash, dokumenta foto etj, te cilat qartazi tregojne mbi llojin dhe karakteristikat e ketyre mjeteve. Akoma me tej sqarojme se neni 53 i ligjit per prokurimin publik, percakton shprehimisht se: "Autoriteti kontraktor, kur e shikon te arsyeshme, u kerkon ofertuesve sqarime per ofertat e tyre, per shqyrtimin, vleresimin dhe krahasimin sa me le drejte le ketyre ofertave. Pa cenuat dispozitat e parashikuara ne nenet 32 dhe 33 le ketij ligji, nuk duhet le kerkohet, ofrohet apo lejohet asnje ndryshim ne permbajtjen e ofertes, perfshire ndryshimet ne cmim apo ndryshime qe synojne le kthejne nje oferte le pavlefshme ne te vlefshme". Ne rastin konkret, kur edhe oferta e paraqitur eshte me cmim mete ulet dhe me leverdi ekonornike, duke kursyer buxhetin e shtetit ne nje vlere te konsiderueshme, autoriteti kontraktor nuk mund te skualifikoje OE ankimues pa marre edhe sqarimet perkatese, aq me teper ne kushtet kur, autoriteti ka dhe mundesine proceduriale te verifikimit fizik te tyre.*

*Sa me siper autoriteti kontraktori duhet te udhehiqet gjithashtu dhe nga parimi i mirëpërdorimit te fondeve publike dhe perfitimi i nje produkti me cilesi te mire dhe me cmim me te ulet, si edhe nuk duhet te gjykoje ne menyre siperfaqesore e formale, aq me teper ne kushte kur kemi nje percaktim te qarte te kritereve dhe dokumentacionit qe duhet te paraqitet, dokumentacion ky i cili provohet me se miri se paditesi e disponon.*

*Përfundimisht kërkojmë:*

*- Shfuqizimin e vendimit të KVO për skualifikimin e ofertës së paraqitur prej nesh dhe Kualifikimin e ofertës tonë në këtë procedurë prokurimi.[…]*

II.5. Në datën 19.02.2020, me shkresën nr. 1560/2 prot., autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues duke mos e pranuar ankesën e paraqitur prej tij pranë këtij të fundit. Operatori ekonomik ankimues sqaron se është vënë në dijeni për kthimin e përgjigjes së autoritetit kontraktor në datën 22.02.2020, duke e dokumentuar me dokumentin postar këtë fakt.
Në kthimin e përgjigjes së ankesës së paraqitur, autoriteti kontraktor argumenton si më poshtë:

*[...] Bashkia Vlore ka zhvilluar proceduren e prokurimit "Sherbimi i pastrimit ne Qytetin Vlore" ne dt.06.01.2020 ora 10.00, me REF-41658-10-30-2019, me fond limit 584,587,476 (peseqind e tetedhjete e kater milione e peseqind e tetedhjete e shtate mije e katerqind e shtatedhjete e gjashte) leke pa tvsh, ku kane paraqitur oferte 3 operatore ekonomikë.*
*Shoqeria "ALKO-IMPEX GENERAL CONSTRUCTION" me oferte 543,573,407 leke pa tvsh*
*2. Shoqeria "DUKA" shpk me oferte 581,685,822 leke pa tvsh*
*3. Shoqeria "Ante - Group" shpk nuk ka paraqitur dokumentacion dhe oferte*
*Ne date 10.02.2020 eshte kryer vleresimi prej KYO, ku jane njoftuar elektronikisht operatoret ekonornike pjesmarrës.*
*Ne date 13.02.2020 eshte paraqitur ankese nga shoqeria "Alko - lmpex General Construction" shpk, qe konsiston ne paraqitjen e argumentave per kundershtirnin e skualifikimit te ketij operatori ekonomik.*
*Me paraqitjen e ankeses se mesiperme, Kryetari i Bashkise Vlore ka nxjerre urdhrin "Mbi pezullimin e procedures se prokurimit" si dhe ka caktuar personat qe do te shqyrtojne dokumentacionin dhe pretendimet e ngritura nga subjekti ankimues, (ketu e ne vijim Komisioni i Shqyrtimit te Ankeses KSHA).*
*Ne zbatim te detyrave te percaktuara ne piken 2, te urdhrit te mesiperrn, pasi eshte shqyrtuar formulari i ankeses, si dhe dokumentacioni perkates i paraqitur ne tender, po paraqesim konstatimet e komisionit te shqyrtimit te ankesave.*
*Ne lidhje me ankesen e paraqitur nga shoqerisa "Alko - Impex General Construction" shpk, komisioni i shqyrtimit te ankeses ka shqyrtuar ne mënyrë te detajuar pretendimet e ngritura dhe dokumentacionin perkates, nga ku rezulton si me poshte:*
*1. Ne ankese ne faqen 6 jane paraqitur argumentat ne lidhje me piken e pare te skualifikimit, ku krahas te tjerave ne faqen 7, eshte ngritur pretendimi se Referuar ligjit nr. 10448 date 14.07.2011 "Për lejet e mjedisit"të ndryshuar por edhe ligjit nr.60/2014 "Per nje ndryshim ne ligjin nr.10448 date 14.07.2011 , rezulton se nje leje mjedisi me kete emertim nuk ekziston. Me pas vijohet me referencat e nenit 23 te ligjit nr.9643/2006 "Per Prokurimin Publik", nenin 30 te VKM nr.914 date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik". Ne faqen 9 te ankeses vijohet me vleresimin se kriteri i vecante i kualifikimit qe ka te beje me licencen e kerkuar me KOD III.1.A. me emertimin e kerkuar, bie ndesh me dispozitat urdheruese te ligjit nr.9643/2006 "Per Prokurimin Publik", i ndryshuar, per shkak se ky kriter nuk argumentohet dhe nevojitet ne proceduren e prokurimit objekt gjykimi e akoma me tej nuk rezulton qe nje leje/licence e tille te leshohet nga Qendra Kombetare e Licencimit sot Qendra Kombetare e Biznesit. Si i tille ky kriter eshte absolutisht i pavlefshem dhe kjo sipas pikes i) te germes a) te nenit 108 te K.Pr.Administrativ e nuk mund te perbeje shkak per skualifikimin e OE ankimues.*

*Nga shqyrtimi i ketij pretendimi, KSHA eshte njohur me kopje te dokumentave standarte te tenderit, si dhe dokumentacionin e paraqitur nga shoqeria ankimuese. Ne piken 3.3.4 të kritereve te vecanta te kualifikimit per lotin 1 eshte percaktuar:*
*"Subjekti te jete i pajisur me licence nga QKB per kategorine III. 1.A Leje e thjeshte mjedisore per Sherbimi ; pastrimit dhe i largimit te mbeturinave urbane, Stacion transferimi per mbetje Jo te rrezikshme",*
*Pretendimet e ngritura ne pjesen e dyte te faqes 7, ne faqen 8, si dhe ne faqen 9 te ankeses, kane te bejne me dokumentet e tenderit, pasi nga shoqeria ankimuese kundershtohet ky kriter si i vene ne kundershtirn me dispozitat ligjore e nenligjore, si dhe ngrihet pretendimi se kjo leje mjedisi me kete ernertim nuk ekziston. Keto pretendime nuk mund te merren ne shqyrtim prej KSHA, pasi bazuar ne nenin 63 pikat I, 1.1, 2, te ligjit nr.9643/2006 "Per Prokurimin Publik", percaktohet qartesisht se ne rastin e ankesave per dokumentet e tenderit, operatoret ekonornike mund te ankohen prane autoritetit kontraktor brenda 7 diteve nga data e publikimit te njoftimit te kontrates ne faqen ne internet te Agjencise se Prokurimit Publik. Ne kete procedure prokurimi, nuk ka patur asnje ankese per dokumentat e tenderit, nga shoqeria ankimuese, apo operatore te tjere ekonomikë.*
*Ne kushtet kur pretendimet per dokumentat e tenderit, kriteret e kualifikimit, apo specifikimet teknike, nuk jane ngritur nga shoqerite sipas percaktirneve te mesiperrne, keto pretendime nuk mund te ngrihen pas kalimit te afatit 7 ditor nga data e publikimit te njoftimit te kontrates, apo pas kryerjes se vleresimit te ofertave.*
*Ne lidhje me pretendimin se kerkesa e kesaj licence me kete ernertim nuk argumentohet dhe nevojitet ne proceduren e prokurimit objekt gjykimi, gjykojme se ka te beje me kundershtimin e kritereve te kualifikimit, dhe nuk mund te shqyrtohet ne kete faze, por qe gjithsesi ne nje procedure prokurimi me objekt "Sherbimi i pastrimit" te kerkohet qe subjekti ofertues te disponoje licence me ernertimin "Sherbimi i pastrimit dhe ; largimit te mbeturinave urbane", nuk mund te ngrihet pretendimi se "nuk argumentohet dhe nuk nevojitet per proceduren e prokurimit". Nese nje licence me nje emertim te tille nuk nuk argumentohet dhe nuk nevojitet ne kete procedure prokurimi, atehere ne cfare procedure tjeter mund te kerkohet?*
*Sidoqofte, per efekt te transparences dhe qe per te dhene nje vendim ne perputhje me legjislacionin ne fuqi prej KSHA, jane marre ne shqyrtim pretendimet e ngritura, duke kryer edhe verifikimet perkatese.*
*KSHA ka verifikuar ne faqen e Agjencise se Prokurimeve Publike, operatoret ekonomikë qe kryejne veprimtari me objekt sherbimin e pastrimit ne disa prej qyteteve kryesore dhe me pas kete informacion e ka ballafaquar mete dhenat qe gjenden ne faqen e ëeb-it qkb.gov.al. Konkretisht nga nje kerkirn i thjeshte ne kete faqe jane gjendur disa leje/licenca te thjeshta mjedisore me kodin II.1.A. me eemërtimin "Shërbimi i Pastrimit dhe largimit të mbeturinave urbane" që u korrespodojnë "KORSEL", "Victoria Invest", "Fusha", "Sori Al" , "Ecoacqua S.R.L." "Ecologica Albania", "Iridiani", "Pastrime Silvio" etj.*
*Keto leje te thjeshta mjedisore me kete emertim, hedhin vetvetiu poshte pretendimet e ngritura ne ankese se kjo licence me kete emertim nuk ekziston. Nese keto leje te thjeshta mjedisore jane leshuar ne kundershtim me ligjin, apo mbi bazen e dispozitave qe nuk ekzistojne eshte detyre e strukturave pergjegjese te Qendres Kornbetare te Biznesit te marrin masat perkatese.*

*Ne lidhje me kete shkak skualifikimi, konstatojme se vendimi i KVO eshte i drejte, pasi operatori ekonomik i ka patur te gjitha mundesite ligjore per te kundershtuar dokumentet e tenderit, ose ne te kundert duhet te plotesonte dokumentacionin ne perputhje me kriteret e vecanta te kualifikimit.*
*2. Ne ankese ne faqen 10 - 13 jane paraqitur argumentat ne lidhje me piken e dyte te skualifikimit, ku krahas te tjerave jane ngritur pretendimet:*
*Se pari KVO nuk ka tagrat e duhur per te vleresuar apo zhvleftesuar ligjshmerine e dokumentit .*
*Se dyti, tarifimi i shoqerise ne lidhje me ujin eshte nje problematike qe nuk hyn ne juridisksionin apo kompetencen tuaj. Per autoritetin kontraktor eshte e vlefshme qe OE pjesemarres te provoje se zoteron kapacitetet e duhura per realizimin me sukses te kontrates.*
*Se treti, ne asnje jjale ne autorizimin, ndryshe nga sa KVO ne menyre abuzive citon, nuk permendet fakti se ky autorizim eshte i vlefshem vetem per qytetin e Devollit.*
*Se katerti, tarifa dhe kosto e perballimit te mbushjes se Ujit ne Devoll dhe larja e qytetit ne Vlore eshte nje risk i subjektit pjesemarres dhe mbetet ne diskrecionin e tij vleresimi i mundshem i ketyre mundesive.*
*Se pesti, ne kerkesen e autoritetit kontraktor ne dst nuk specifikohet organi apo cili tip leje do te konsiderohet i vlefshem apo jo per permbushjen e kriterit te sipercituar.*
*Se gjashti, Agjencia e Menaxhimit te Burimeve Ujore, eshte organi me i larte ne fushen e menaxhimit te burimit te ujore. Nepermjet shkreses se saj nr.15 05/ 1 prot date 11.12.2019 ka theksuar se subjektet qe do te pajisen me leje apo autorizim per perdorimin e burimit ujor duhet te ushtrojne veprimtarine pas miratimit te tij.*
*Nga shqyrtimi i ketij pretendimi, KSHA eshte njohur me kopje te dokumentave standarte te tenderit, si dhe dokumentacionin e paraqitur nga shoqeria ankimuese. Ne piken 3.3.10 te kritereve te vecanta te kualifikimit per lotin 1 eshte percaktuar:*
*"Subjekti ofertues duhet te jete i pajisur me autorizim ose leje per perdorimin e burimeve ujore, per efekt te perdorimit te ujit me te cilin do te kryhen sherbimet objekt i ketij prokurimi".*
*Per te plotesuar kete kriter, prej shoqerise "Aiko - Impex General Construction" eshte paraqitur:*
*a. Autorizim nr.239 prot date 11.11.2019 i leshuar prej "Ujesjelles Kanalizime Devoll" sh.a ku percaktohet se autorizon shoqerine "Aiko - Impex General Construction" per perdorimin e burimeve ujore nen administrimin e kesaj shoqerie,*
*b. Shkrese Kthim pergjigje nr.1505/1 prot date 11.12.2019 e leshuar prej Agjencise se Menaxhimit te Burimeve Ujore.*
*Pretendimet e ngritura ne ankese, nuk qendrojne dhe jane te pabazuara ne dokumentacionin e paraqitur dhe legjislacionin ne fuqi.*
*Ne lidhje me pretendimet e ngritura ne pikat 1-4 (per shkakun e dyte te skualifikimit) vlen per tu sqaruar, se KVO nuk ka zhvleftesuar ligjshmërinë e ketyre dokumenteve, por ka gjykuar mbi përmbajtjen e tyre. Përdorimi i ujit per sherbimet komunale duhet te kryhet nga burimet ujore sipas VKM nr.662 date 21.09.2016 "Per miratimin e tarifave te perdorimit te ujit dhe te shkarkimeve te Iengeta", kurse lejimi/autorizimi per perdorimin e ketyre burimeve miratohet ne baze te ligjin nr. 111/2012 "Per menaxhimin e integruar te burimeve ujore" dhe akteve nenligjore te nxjerra ne zbatim te tij. Ndernarrjet e Ujesjelles Kanalizimeve per perdorirnin e burimeve ujore, pajisen per veten e tyre me leje dhe licence nga autoritetet perkatese, por nuk kane asnje tager te pajisin te trete per perdorimin e burimeve ujore per kryerjen e sherbimeve kornunale, pasi kjo eshte kornpetence e Zyres se Administrimit te Basenit Ujor perkates. Konkretisht nga*

*verifikimet e kryera ne faqen [http://ëëë.erru.al/doc/Vendiim _51_2017](http://ëëë.erru.al/doc/Vendiim_51_2017) UK Devoll.pdf eshte e publikuar licenca e kesaj shoqerie [...]*
*Ne perrnbajtjen e kesaj licence percaktohet qartazi se Operatori Sh.a Ujesjelles Kanalizime Devoll autorizohet te kryeje veprimtarinë perkatese te kualifikuar ne kategorine: Kategoria A, per grumbullimin dhe shperndarjen e ujit per konsum publik; Kategoria C, per largimin e ujerave te ndotura. Ky argumentim tregon qarte se Sh.a Ujesjelles Kanalizime Devoll nuk mund te autorizoje persona te trete per perdorirnin e burimeve ujore, kur nuk e ka vete kete kompetence dhe nuk eshte e licencuar per te kryer veprime te tilla.*

*Ne rastin konkret ngritja e pretendimeve te natyres qe "botet do furnizohen me uje ne Devoll dhe do vijne te kryejne sherbim ne Vlore", ne kushtet kur sherbimet e larjes dhe lagies ne periudha te caktuara, jane parashikuar per tu kryer perdite ose dy here ne dite, apo pretendimi se "rritja e kostos eshte risk; subjektit pjesemarres", jane pretendime qe bazuar ne nenin 46/1/b te LPP-se, ulin besimin e Autoritetit Kontraktor mbi reputacionin dhe besueshmerine, per te zbatuar kontraten, siç eshte pershkruar nga autoriteti kontraktor ne njoftimin e objektit te kontrates", pasi jane pretendime krejt te pabazuara ne jo vetem persa eshte argumentuar me siper, por edhe per shkak te realizimit te detyrimeve nga pikepamja faktike. Ne lidhje me pretendimet e ngritura ne piken e peste (per shkakun e dyte te skualifikimit) vlen per te sqaruar operatorin ekonomik ankimues se nga shqyrtimi kritereve te kualifikirnit per lotin e pare, nuk rezulton te jene percaktuar institucionet qe leshojne dokumentet, por ne baze te legjislacionit ne fuqi, operatoret ekonomikë, plotesojne dokumentacionin e kerkuar, Konkretisht ne piken 3.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar, percaktohet se operatori duhet te paraqese*
*a. Kopje te vertetuar te bilancit, te viteve 2017 - 2018 te konfirmuar prane autoriteteve perkatese.*
*b. Kopje te deklarimit te xhiros vjetore per vitet 2017 - 2018.*
*Ne pikat a) dhe b) te ketij kriteri kualifikimit, nuk percaktohet autoriteti qe miraton apo konfirmon bi lancet, apo qe leshon deklarimet e xhiros, por eshte evidente se ne baze te legjislacionit ne fuqi, qe presupozohet se njihet edhe prej operatori ekonomik, keto dokumente leshohen prej Degeve Rajonale te Tatimeve, ashtu sikurse eshte paraqitur i plote edhe i rregullt nga shoqeria ankimuese. I njejti arsyetim vlen edhe per piken c) ku nuk eshte percaktuar termi "ne cdo vend te ushtrimit te aktivitetit", pasi ne vaze te legjislacionit ne fuqi, pagimi i taksave vendore nuk nenkupton pagesen pjeserisht te tyre, por pagesen e plote ne cdo vend te ushtrimit te aktivitetit, sikurse eshte vepruar edhe prej operatorit ekonomik ne rastin konkret dhe eshte konsideruar i plote prej KVO.*
*Ndodhur ne keto kushte edhe per kriterin e kualifikimit te percaktuar ne piken 3.3.10 te kritereve te vecanta te kualifikimit per lotin 1, percaktohet qartesisht dokumentacioni qe kerkohet per permbushjen e kriterit, por eshte legjislacioni qe e percakton se kush jane autoritetet qe leshojne keto dokumenta. Per me teper ne shkresen nr. nr.1505/1 prot date 11.12.2019 e leshuar prej Agjencise se Menaxhimit te Burimeve Ujore, eshte sqaruar qartesisht se kush jane autoritetet e autorizuara me akte ligjore e nenligjore per leshirnin e ketij dokumentacioni. Pervec kesaj, operatori ekonomik i ka patur te gjitha mundesite dhe kohen e nevojshme per te kerkuar sqarime prane Autoritetit Kontraktor per kete kerkese apo te tjera, sikurse percaktohet ne nenin 42 te ligjit nr.9643/2006 "Per Prokurimin Publik".*
*Ne ligjin nr. 111/2012 "Per menaxhimin e integruar te burimeve ujore", i ndryshuar, neni 50 pika5 percakton se :*

*5. Autorizimet, lejet dhe koncesionet per perdorimin e ujerave:*
*a) jane personale dhe i takojne titullarit te licences, autorizimit, lejes, koncesionit perkates;*
*b) nuk mund te transferohenpa miratimine organevete administrimidt he menaxhimitte burimeve*
*c) Jane te vlefshme per nje afat te caktuar dhe rinovohen sipas rye procedure te percaktuar;*
*c) mund te ndryshohen, te refuzohen, te pezullohen ose te shfuqizohen ne haze te ketij ligji dhe akteve nenligjore ne zbatim te tij;*
*d) leshohen pas pagimit te nje tarife per shpenzimet administrative;*
*dh) regjistrohen ne Regjistrin Kombetar te LeJeve dhe Autorizimeve, sipas parashikimeve ligjore e nenligjore perkatese;*
*e) nuk mund te refuzohenpa nje vendim te arsyetuarte organlt administrativ qe shqyrton kerkesen per autorizim ose leje.*
*Ne VKM nr. 416, date 13.5.2015 percaktohen kushteve te pergjithshrne e te posacme, dokumenteve shoqeruese, afatit te vlefshmerise, formulareve te aplikimit per autorizim dhe leje, procedurave te shqyrtirnit e vendimmarrjes dhe formateve te autorizimit e lejes per perdorim te burimeve ujore. Keto dispozita ligjore e nenligjore detyrojne cdo subjekt qe te mos perdore ujin e pijshem per qellime publike, si lagie e larje te rrugeve, shesheve e trotuareve, por te perdore burimet e tjera ujore.*
*Keto argumenta rrezojne lehtesisht pretendimin e ngritur ne piken e peste (per shkakun e dyte te skualifikimit) ne ankese se ne kerkesen e autoritetit kontraktor ne dst nuk specifikohet organi apo cili tip leje do te konsiderohet i vlefshem apo jo per permbushjen e kriterit te sipercituar.*
*Ne lidhje me pretendimet e ngritura ne piken e gjashte (per shkakun e dyte te skualifikimit) vlen per tu sqaruar se ne shkresen kthim pergjigje nr.1505/1 prot date 11.12.2019 e leshuar prej Agjencise se Menaxhirnit te Burimeve Ujore, sqarohet qartesisht shoqeria "Aiko - Impex General Construction" se "pas plotesimit te dokumentacionit tekniko-ligjor te percaktuar ne VKM nr. 416 date 13.05.2015 duhet te aplikoje prane Zyres se Administrimit te Basenit Ujor perkates dhe me tej miratohen prane Keshillit te Basenit Ujor. Lejet apo autorizimet leshohen per nje afat te caktuar kohor, sipas parashikimeve te pikes 5 te VKM nr.416 date 13.05.2015".*
*Ne fund te shkreses shkruhet nje fjali se "Subjektet qe pajisen me autorizim per perdorimin e burimit ujor duhet te ushtrojne veprimtarine, pas miratimit te saj". Kjo fjali rrezon krejtesisht vertetimin e leshuar prej Nderrnarrjes se Ujesjelles Kanalizimeve Devoll ku lejon nje subjekt privat (shoqerine "Aiko - Impex General Construction") per perdorirnin e burimeve ujore, nderkohe qe ky subjekt duhet ta ushtroje veprirntarine per perdorirnin e ketyre burimeve pas pajisjes me autorizim nga Zyra se Administrimit te Basenit Ujor perkates.*
*Shkresa kthim pergjigje nr.1505/1 prot date 11.12.2019 e leshuar prej Agjencise se Menaxhimit te Burimeve Ujore, nuk eshte nje akt administrativ qe sjell pasoja juridike, por eshte nje kthim pergjigje i zakonshem, gjate ushtrimit te veprirntarise se perditshme te administrates publike, i nje kerkese qe nuk kemi dijeni se cfare i eshte kerkuar. Sidoqofte ne rast se shoqeria ankimuese ka pretendime ne lidhje me ligjshmerine e ketij kriteri, i ka patur te gjitha mundesite dhe afatet e nevojshme per te bere kundershtirnin e tij, ne rast te kundert ka gene i detyruar ta plotesoje ate sikurse percaktohet ne kriteret e kualifikimit. Pretendimet e ngritura ne fillim te faqes 13 te ankeses, nuk mund te ngrihen ne kete faze te procedures se prokurimit. Ne permbledhje per sa eshte sqaruar me lart, ne kriterin e kualifikimit eshte e percaktuar qarte se subjekti duhet të disponoje autorizim ose leje per perdorirnin e burimeve ujore, per te realizuar sherbimet objekt*

*te kesaj kontrate. Prej operatorit ofertues nuk eshte bere asnje perpjekje per sigurimin e ketij dokumentacioni, edhe pse i ka patur mundesite dhe kohen e mjaftueshme per ta siguruar kete dokument. Ne baze te pikes 4/b te VKM nr.416 date 13.05.2015 ku percaktohet shprehimisht se "Lejet dhe autorizimet per perdorimin e ujit shqyrtohen nga Keshilli i Basenit Ujor (KBU), referuar nenit 50, te ligjit nr. 111/2012, i cili merr vendim jo me vone se 2 (dy) muaj, nga data e paraqitjes se kerkeses". Kjo procedure prokurimi ka qene e publikuar ne SPE ne date 30.10.2019 dhe ofertat jane hapur ne date 06.01.2020, cka provon qarte se subjekti ofertues e ka patur kohen e nevojshme per të aplikuar per te permbushur kriterin e kualifikimit. Ne lidhje me aludimet e ngritura ne ankese se ky kriter eshte vendosur per favorizimin e shoqerise "DUKA", sqarojme se kjo shoqeri eshte pajisur me kete dokumentacion pas publikimit te njoftimit te kontrates, ashtu sikurse mund te pajisjej edhe cdo subjekt tjeter qe do te ishte seriozisht i interesuar per plotesimin e ketij dokumentacioni dhe jo te ngreje pretendime qe nuk tregojne aspak seriozisht per kryerjen e sherbimit. Ritheksojme se lejet dhe autorizimet per perdorimin e ujit shqyrtohen nga Keshilli i Basenit Ujor (KBU), i cili merr vendim jo me vone se 2 (dy) muaj, nga data e paraqitjes se kerkeses.*

*Ne lidhje me kete shkak skualifikimi, konstatojme se vendimi i KVO eshte i drejte, pasi operatori ekonomik i ka patur te gjitha mundesite ligjore per te kundershtuar dokumentet e tenderit, ose te kerkonte sqarime prane Autoritetit Kontraktor. Operatori ekonomik nuk ka plotesuar dokumentacionin ne perputhje me kriteret e vecanta te kualifikimit.*

*3. Ne ankese ne faqen 13 - 25 jane paraqitur argumentat ne lidhje me piken e trete te skualifikimit. Per shkak se pretendirnet jane voluminoze, prej KSHA jane marre ne shqyrtim vecmas dhe per pasoje edhe analizen e tyre po e kryen vecmas per cdo pretendim te ngritur.*

*Ne lidhje me pretendimet e ngritura ne faqen 13 dhe ne fillim te faqes 14 te ankeses, po argurnentojme si me poshte*

*Ne piken 3.3.11 te kritereve te vecanta te kualifikimit per lotin 1 eshte percaktuar:*

*"Shoqeria ofertuese duhet te disponoje dokumentacion qe per realizimin e kesaj kontrate te kete keto mjete (ne pronesi ose qira).*

*Keto mjete duhet te jene te pajisur me dokumentacion sipas legjislacionit ne fuqi. Per mjetet qe jane me qira duhet te paraqitet edhe kontrata e qirase me nje afat vlefshmerie jo me pak se nje vit. Per mjetet qe shenohen ne regjistra publike duhet te paraqitet dokumenti qe verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), policen e sigurimit, taksat vjetore te mjetit, si dhe lejen e transportit nga bashkia per vete ose te trete.*

*Mjetet duhet te paraqiten ne formen e nje deklarate ku te percaktohen targat, lloji, numri i shasise,"*

*Ne faqen 13 te ankeses eshte ngritur pretendimi se ne Iigjin nr.9975, date 28.07.2008 "Per taksat kornbetare", i ndryshuar, neni 4 "Niveli i taksave kombetare, eshte parashikuar:*

*"[ . .] E ardhura nga taksa, per cdo rast, mblidhet nga strukturat e Drejtorise se Pergjithshme te Sherbimeve te Transportit Rrugor, drejtorise rajonale, para kryerjes se kontrollit teknik vjetor te Detyrueshem te mjetit [ . .]."*

*Ndersa ne Udhezimin nr.8/1, date 15.05.2013 "Per disa shtesa e ndryshime ne Udhezimin nr.26, Date 09.04.2008 "Per taksat kornbetare", i ndryshuar", thuhet:*

*"[...] Pagesa e takses behet brenda afatit te vlefshmerise, por gjithnje para kryerjes se kontrollit teknik vJetor te detyrueshem te mjetit. Pronari i mjetit, i cili nuk kryen pagesen e kesaj takse brenda*

*10 diteve nga mbarimi i afatit te vlefshemrise se parashikuar, detyrohet te paguaje nje gjobe prej 5% te shumes se detyrimit te papaguar per cdo muaj por Jo me shume se 25% per cdo vit.[...]"*
*Bazuar ne sa rnesiper gjykojme se, OE ankimues me dokumentacionin e paraqitur, ploteson kriterin e sipercituar, pasi perpara se automjeti te kaloje procesin e kontrollit, duhet të jenë paguar taksat vjetore të automjetit.*
*Ne shqyrtim te ketyre pretendimeve te ngritur ne faqen 13 te ankeses, prej KSHA konstatohet se keto pretendime koincidojne ne fakt edhe me nje vendim te vitit 2014 te Komisionit te Prokurimit Publik, por qe prej atij viti, ne dispozitat ligjore te siperpermendura, ne vitin 2016 jane kryer shtesa thelbesore ne ligj, ku eshte shtuar fjalia "Kontrolli tenik i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove te tyre kryhet brenda periudhes se vlefshmerise 365-ditore te takses vjetore te mjeteve te perdorura. ". Mungesa e kesaj fjalie, ne ngritjen e pretendimeve prej ankimuesit, qe aktualisht eshte ne fuqi prej vitit 2016 ne nenin 4 te ligjit nr.9975, date 28.07.2008 "Per taksat kombetare", eshte element i rendesishem qe tashrne rrezon ngritjen e pretendimeve te mesiperme, si dhe nxjerr jashte aktualitetit vendimin e KPP-se te vitit 2014.*
*Pergjigjen e ketij pretendimi e jep vete dokumentacioni i paraqitur nga shoqeria ankimuese ne kete procedure prokurimi. Konkretisht shoqeria "Alko - Impex General Construction", midis te tjerave, ka paraqitur mjetin me targa AA853NJ i deklaruar ne deklaraten e mjeteve te paraqitur ne Bashkine Vlore si kamion me kapacitet 20 ton, i marre me qira me kontraten me nr.9778 rep dhe nr.6809 kol. Bazuar ne dokumentacionin e dorezuar ne SPE per kete mjet, rezulton se eshte i vetmi qe ka paraqitur dokumentin e pageses se takses vjetore e cila eshte paguar ne date 13.12.2018 qe ne daten e hapjes se ofertave 06.01.2020 ka gene jashte afatit. Kontrolli teknik i ketij mjeti eshte kryer, pasi eshte paguar taksa vjetore brenda afatit 365 di tor dhe konkretisht ne date 23 Janar 20 I 9, pasi bazuar ne kete dokument, certifikata e kontrollit teknik perfundon ne date 22.0 I .2020.*
*Nga ky dokumentacion i paraqitur nga vete operatori eknomik ankimues, provohet qarte qe edhe pse certifikata e kontrollit teknik te mjeteve eshte ne afat ne diten e hapjes se ofertave dhe eshte kryer perpara pageses se takses vjetore te mjetit, brenda afatit 365 dite, dokumenti I pageses se takses vjetore te mjetit eshte jashte afatit. Aktualisht duhet te ishte paraqitur pagesa e takses vjetore te mjetit per periudhen 13.12.2019-12.12.2020. Ky shembull mund te sherbeje edhe per mjetet e tjera, per te cilat nuk eshte paraqitur dokumenti i kerkuar ne kriteret e vecanta te kualifikimit.*
*Ne kriterin e kualifikimit kerkohet shprehimisht se edhe ne rastet kur mjetet jane ne pronesi edhe me qera, duhet te paraqiten dokumentacioni qe verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), policen e sigurimit, taksat vjetore te mjetit, si dhe lejen e transportit nga bashkia per vete ose te trete. Pra autoriteteti kontraktor ka kerkuar nje mjet te rregjistruar ne regjistrat publike per te cilin te dorezohet i gjithe dokumentacioni shoqerues. KSHA gjykon se eshte detyre e operatoreve ekonornike te dorezojne oferten ne perputhje me dokumentet e tenderit dhe kerkesat e autoritetit kontraktor. Ne rastin konkeret operatori ekonomik ankimues nuk ka dorezuar dokumentacionin e nevojshem ne perputhje me kriterin e kualifikimit taksat e paguara te mjetit.*
*Ne lidhje me pretendimet e ngritura ne faqen 14 te ankeses, po argumentojmë si me poshte*
*Ne piken 3.3.10 te kritereve te vecanta te kualifikimit per lotin 1 eshte percaktuar:*
*"Shoqeria ofertuese duhet te disponoje dokumentacion qe per realizimin e kesaj kontrate te kete keto mjete (ne pronesi ose qira):*

*e. Autofshesa 3 cope (ne pronesi ose me qira)*
*f. Mjet të posaçëm me goma që kryen funksionin fshirje dhe larje njëkohësisht 1 copë (në pronësi ose me qira).*

*Bazuar ne dokumentacionin e paraqitur ne SPE prej shoqerise "Aiko - lmpex General Construction" dhe te shoqeruar me deklaraten perkatese, ka paraqitur mjetet me targa AA 198TI, AGMT47, AGMT48 per te perrnbushur kriterin 3.3.1 O.e, si dhe ka paraqitur mjetin me targa AA857XM per te perrnbushur kriterin 3.3.1 O.f.*

*Sikurse u sqarua edhe me siper per keto mjete nuk ka paraqitur dokumentin per taksat vjetore te mjetit, por nga verifikimet e kryera zyrtarisht ne Autoritetet Kontraktore ku ky subjekt ushtron aktivitet te ngjashem me objektin e prokurimit, rezulton se:*

*• Mjeti me targa AA 198Tl me nr.shasie VF644ACA000013207 i deklaruar si "Autofshese" ne Bashkine VI ore, rezulton se eshte deklaruar per tu perdorur si kamion 7.5 - 18 ton ne Bashkine Kavaje, dhe per tu perdorur si Autobot ne Bashkine Tirane. Bazuar ne korrespodencen e mbajtur me keto institucione rezulton se jo vetem qe ky mjet nuk mund perdoret per realizimin e kontrates ne Bashkine Vlore, pasi eshte ne sherbirn te njekohshem ne dy Bashki te tjera, por edhe te dhenat per llojin dhe funksionin e mjetit jane kondradiktore, pasi ne tre Bashki te ndryshme i njejti mjet me te njejtin shasi deklarohet njekohesisht si autofshese, si autobot, si kamion transportues.*

*• Mjeti me targa AGMT48 me nr.shasie SA92V5CXXA4068157 i deklaruar si "Autofshese" ne Bashkine Vlore, rezulton se eshte deklaruar edhe ne Bashkine Kavaje dhe ne Bashkine Tirane. Bazuar ne korrespodencen e mbajtur me keto institucione rezulton se ky mjet nuk mund perdoret per realizimin e kontrates ne Bashkine Vlore, pasi eshte ne sherbirn te njekohshem ne dy Bashki te tjera.*

*• Mjeti me targa AA857XM me nr.shasie VF644ACAOOOO 13903 i deklaruar si "Mjet te posacem me goma qe kryen funksionin fshirje dhe larje njekohesisht" ne Bashkine Vlore, rezulton se eshte deklaruar per tu perdorur si kamion 7.5 - 18 ton ne Bashkine Kavaje. Bazuar ne korrespodencen e mbajtur me keto institucione rezulton se jo vetem qe ky mjet nuk mund perdoret per realizimin e kontrates ne Bashkine Vlore, pasi eshte ne sherbirn te njekohshern edhe ne nje Bashki tjeter, por edhe te dhenat per llojin dhe funksionin e rnjetit jane kondradiktore, pasi ne dy Bashki te ndryshme i njejti mjet me te njejtin shasi deklarohet njekohesisht si mjet fshires dhe si kamion transportues.*

*Per sa me lart, shoqeria "Aiko - Impex General Construction" jo vetem nuk ka plotesuar kriterin e vecante te kualifikimit per sasine dhe llojet e mjeteve, por edhe bazuar ne nenin 46/1/b te LPP-se, nuk ka vertetuar se "zoteron makinerite, pajisjet e asete te tjera fizike, reputacionin dhe besueshmerine, per te zbatuar kontraten, sir; eshte pershkruar nga autoriteti kontraktor ne njoftimin e objektit te kontrates", si dhe bazuar ne nenin 53/3 te LPP-se, oferta e paraqitur "nuk eshte ne perputhje me te gjitha kerkesat dhe specifikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentet e tenderit".*

*Ne lidhje me pretendimet e ngritura ne faqet 14 - 17 te ankeses, po argumentojme si me poshte*

*Ne ankese ngrihet pretendimi se nga ana e Autoritetit Kontraktor per asnje cast nuk eshte trajtuar apo kerkuar ne dst se mjetet e paraqitura ne momentin e pjesemarrjes ne proceduren e prokurimit nuk jane te angazhuara ne kontrata te tjera. Autoriteti Kontraktor duhet te beje vleresimin e ofertave mbi bazen e kritereve te percaktuara ne dokumentat e tenderit, duke perjashtuar ketu vleresimin mbi dokumenta shtese te pakerkuara.*

*Ne faqen 16 te ankeses, ne lidhje me verifikimet e Autoritetit Kontraktor, mjetet e kane te percaktuar ne lejen e qarkullimit qe jane APV te cilet kryejne disa funksione. Autoriteti Kontraktor ne cdo rast ka mundesine e verifikimit fizik të tyre.*

*Nga shqyrtimi i shkaqeve te skualifikimit te operatorit ekonomik ankimues dhe pretendimeve te ngritura ne ankesen e paraqitur, prej KSHA konstatohet se ne argumentimin e skualifikimit prej KVO, ne asnje moment nuk perdoret fjala "angazhim i mjeteve ne kontrata te tjera". Ne skualifikimin e kesaj oferte per kete shkak, Autoriteti Kontraktor eshte nisur nga gjendja e faktit per te dale ne konkluzion. Autoriteti Kontraktor ka konstatuar si shkak skualifikimi faktin se nje pjese e mjeteve te deklaruara per tu perdorur ne Bashkine Vlore, ne fakt jane deklaruar per tu perdorur edhe ne Bashki te tjera, ku operatori ekonomik ka nenshkruar kontrata me objekt realizimin e sherbimit te pastrimit. Natyrshem lind pyetja se si mund te perdoren keto mjete njekohesisht ne kater Bashki te vendit per te realizuar sherbimin e pastrimit.*

*Ne piken 3.3.10 te kritereve te vecanta te kualifikimit per lotin I eshte percaktuar qartesisht se "Shoqeria ofertuese duhet te disponoje dokumentacion qe per realizimin e kesai kontrate te kete keto mjete (ne pronesi ose qira) ". Bazuar ne kete kriter, Autoriteti Kontraktor ka kerkuar qe OE ofertues te disponoje dokumentacion per 23 mjete per realizimin e kontrates objekt prokurimi. Gjate vleresimit te ofertave, Autoriteti Kontraktor ka kryer verifikimet qe i ka gjykuar te nevojshme, ku per te verifikuar mjetet e operatorit ekonomik ankimues, ka derguar shkresat per informacion ne Bashkite Kavaje, Devoll, Librazhd, Tirane. Ne pergjigje te shkresave, pervec Bashkise Librazhd qe nuk i ka kthyer pergjigje te korrespodences zyrtare, tre Bashkite e tjera kane derguar informacionin e kerkuar. Ne kushtet kur bazuar ne korrespodencen zyrtare, mjetet e deklaruara per te kryer sherbimin ne Bashkine Vlore, rezultojne qe jane deklaruar njekohesisht per te qene pjese e realizimit te sherbimit ne keto tre bashki, si dhe eshte konstatuar se jane deklaruar me tjeter funksionalitet, nuk eshte me e nevojshme te kryhet asnje asnje verifikim tjeter. Bashkelidhur shkresave te derguara nga keto tre Bashki jane derguar edhe deklarimet e nenshkruara nga vete administrator i shoqerise "Aiko - Impex General Construction".*

*Ne shqyrtirn te ketyre deklaratave te dorezuara ne keto tre Bashki prej shoqerise "Aiko - Impex General Construction", te nenshkruara prej te njejtit person, ku del qartazi qe mjetet deklarohen me funksionalitet te ndryshem, por nga ana tjeter prej te njejtit person nenshkruhet nje ankese ku ngrihen pretendimet se ka nenshkruar deklaraten e perrnbushjes se specifikimeve teknike, duke marre persiper pergjegjesine e tij per perrnbushjen e tyre. Perpara ketyre pretendimeve, vjen natyrshern pyetja se cfarë dyshimesh duhet te kete me shume autoriteti kontraktor, se ato qe kane ne perrnbajtjen e tyre tre shkresat zyrtare. Nga njera ane ne ankese deklarohet se merren persiper pergjegjesite per perrnbushjen e specifikimeve teknike, duke nenshkruar nje sere deklaratash e shtojcash, por nga ana tjeter rezulton qartzazi se te dhenat e plotesuara ne keto deklarata nuk jane reale. Sikurse percaktohet edhe ne nenin 53 te ligjit "Per prokurimin publik", "autoriteti kontraktor i kerkon sqarime ofertuesit kur ka dyshime", por ne rastin konkret, korrespodenca zyrtare e mbajtur i ka hequr te gjitha dyshimet, pasi sipas kesaj korrespodence i njejti mjet ne kater Bashki te ndryshme deklarohet per tu perdorur edhe si autofshese, edhe si kamion, edhe si autobot. Bazuar ne nenin 46/1/b te LPP-se, keto veprime ulin besimin e Autoritetit Kontraktor mbi reputacionin dhe besueshmerine, per te zbatuar kontraten, sic eshte pershkruar nga autoriteti kontraktor ne njoftimin e objektit te kontrates",*

*Sikurse eshte sqaruar edhe me siper, nga verifikimet e kryera rezulton se disa prej mjeteve te deklaruara prej operatorit ekonomik ankimues per tu perdorur ne Bashkine Vlore per te kryer sherbimin e pastrimit, jane deklaruar njekohesisht edhe ne Bashki te tjera te vendit dhe jane duke kryer sherbimin ne keto Bashki. Po te nisesh edhe nga fakti se keto Bashki deklarojne se keto mjete perdoren per te kryer sherbimin ne territorin e tyre, eshte absurditet te mendosh dhe per me teper te gjykosh apo te kerkosh te kryhesh verifikimin fizik te ketyre mjeteve, kur i njejti mjet deklarohet prej te njejtit subjekt se kryen dhe realizon njekohesisht sherbirnin e pastrimit ne tre Bashki te ndryshme.*

*Ne fund te faqes 16 te ankeses, eshte ngritur pretendimi se mjetet e kane te percaktuar ne lejen e qarkullimit qe jane APV (automjet per perdorim te vecante) te cilet kryejne disa funksione, si dhe se Autoriteti Kontraktor ne cdo rast ka mundësinë e verifikimit fizik te tyre. Bazuar ne nenin 54 pika g) te Kodit Rrugor percaktohet se automjetet per perdorim te verçante janë mjete të pajisura ne menyre te perhershme me mekanizma te veçante dhe te destinuar përgjithësisht per transportin e ketyre makanizmave; mbi keto automjete lejohet transporti i personelit dhe materialeve qe kane lidhje me ciklin operativ te ketyre mekanizmave, si dhe transporti i njerezve dhe mallrave qe kane lidhje me destinacionin e perdorimit te ketyre mekanizmave. Ne perkufizim e percakton taksativisht se jane mjete te pajisura ne menyre te perhershme me mekanizma te vecante. Nese do te marrim per analize rastin e mjetit me targa AA857XM me nr.shasie VF644ACAOOOO 13903 i deklaruar si "Mjet te posacem me goma qe kryen funksionin fshirje dhe larje njekohesisht" ne Bashkine Vlore, rezulton se eshte deklaruar per tu perdorur si kamion 7.5 - 18 ton ne Bashkine Kavaje. Referuar perkufizimit per mjetet APV, nese ky mjet per perdorim te vecante eshte i pajisur ne menyre te perhershme me mekanizma te vecante per fshirjen e rrugeve apo si mjet teknologjik kompatator per transportin e mbetjeve urbane, nuk mund te jete njekohesisht i pajisur ne menyre te perhershme me mekanizma te vecante per transport materialesh. dherash inertesh, sikur eshte kamioni transportues qe ky mjet eshte deklaruar si i tille ne Bashkine Kavaje. Pervec kesaj ne nenin 54 te Kodit Rrugor percaktohet qarte edhe perkufizimi i mjetit kamion, i cili ka kuptim te ndryshem nga mjetet APV. Pra mjeti me targa AA857XM ose eshte APV sikurse deklarohet ne Bashkine Vlore, ose eshte Kamion sikurse deklarohet ne Bashkine Kavaje. Cfare vlere kane deklaratat e paraqitura ne Bashkine VI ore, kur ato jane katerciperisht te vertetuara se perrnbajne te dhenajo reale?*

*Nga sa me lart, ne lidhje me keto pretendime ne ankese, prej KSHA eshte dhene nje pasyqrim i gjithanshem duke argumentuar se ankuesi jo vetem eshte ne kushtet qe ka paraqitur te dhena kontradiktore per mjetet duke cenuar besueshrnerine ndaj autoritetit kontraktor, por edhe nuk mund te kryhet i njejti sherbirn mete njejtat mjete njekohesiht ne kater Bashki te vend it. Edhe pse ankuesi ne ankesen e tij eshte munduar, qe te rrezoje shkaqet ngritura ne skualifikim sa i perket mjeteve, me arsyetimin se ne dst "nuk eshte kerkuar qe rnjetet te Jene te angazhuara", argumentat e dhena prej vete ankuesit, provojne katerciperisht se keto mjete jane te angazhuara ne bashki te vend it. Ne fakt ne shkaqet e skualifikimit ne asnje fjali nuk eshte argumentuar se mjetet jane te angazhuara ne kontrata te tjera, por eshte argumentuar se keto mjete jane deklaruar njekohesisht ne disa bashki te vendit per tu perdorur per kryerjen e sherbirnit te pastrimit, dhe per me teper jane deklaruar me funksionalitete te ndryshme per ti krijuar bindjen AK se OE i ploteson kriteret e kualifikimit.*

*Ne perfundim te analizes se mesiperrne, prej KSHA eshte nxjerre perfundimin se argumentat e dhena ne ne faqet 14 - 17 te ankeses nuk qendrojne.*
*Ky argumentim vjen i bazuar edhe ne nje praktike tashme te konsoliduar te Komisionit te Prokurimit Publik me vendimin nr.871/2018 date 26.12.2018, ku ne faqen 17 citon :*
*"Ne rastin konkret, KPP gjykon se fakti qe operatori ekonomik pjesemarres disponon ne pronesi pjese e aseteve te tij mjete dhe paisje ne numrin e kerkuar nuk eshte kusht i vetem qe keto tefundit i vi hen ne dispozicion ose mund ti vi hen ne dispozicion per realizimin e kontrates objektprokurimi, par parakushti thelbesor sine qua non lidhet me disponueshmerine e tyre deklaruar Igo edhe ne deklaraten mbi disponueshmerine e mjeteve. KPP gjykon se nje nder parimet kryesore te se drejtes eshte ai se pre)faktit rrjedh e drejta exfacto -oritur jus, pra ne rastin konla-et mietet dhe paisiet e mesiperme iane te deklaruara dhe te angazhuara ne nie kontrate tieter publike kontrate e cila rezulton e sapo lidhur dhe keto te fundit prima facia nuk mund te iene te disponueshme ne kontraten obiekt ankimi. Per sa kohe qe mjetet e mesiperme dote angazhohen ne nje kontrate tjeter me po te njejtin autoritet kontraktor keto te fundit nuk mund te vi hen ne dispozicion per shkak se tashme ato jane pjese ne teresi e angazhimit kontraktual te lidhur me pare mes te njejtit operator ekonomik dhe te njejtit autoritetit kontraktor."*

*Ne kete paragraf, KPP e percakton qarte, qe ne rastin kur nje operator ekonomik i deklaron mjetet per realizimin e nje kontrate dhe ka lidhur kontraten me Autoritetin Kontraktor, realizimi i te ciles kerkon disponueshrnerine e ketyre mjeteve, i njejti operator ekonomik nuk mund ti deklaroje serish tenjejtat mjete dhe te lidhe nje kontrate tjeter, realizimi te ciles kerkon gjithashtu disponueshrnerine e te njejtave mjeteve.*
*Ne lidhje me pretendimet e ngritura ne faqet 17 - 18 te ankeses, po argumentojme si me poshte*
*Pretendimet e pageses se taksave vjetore te mjetit, jane ezauruar ne pjesen e mesiperme te ankeses, ku eshte argumentuar qartesisht se OE eshte i detyruar te plotesoje dokumentacionin e kerkuar nga Autoriteti Kontraktor ne kriteret e vecanta te percaktuara ne dst.*
*Ne piken 3.3.10 te kritereve te vecanta te kualifikimit per lotin 1 eshte percaktuar:*
*"Shoqeria ofertuese duhet te disponoje dokumentacion qe per realizimin e kesaj kontrate te kete keto mjete (ne pronesi ose qira):*
*b. Kamion me kapacitet transportues 15 - 25 ton 2 cope (ne pronesi ose me qira)"*
*Ne baze te Kodit Rrugor ne nenin 54 pika 1/d percaktohet se kamioni eshte mjet i destinuar per transportin e mallrave dhe te njerezve te caktuar me perpunimin ose transportin e ketyre mallrave.*
*Per plotesirnin e ketij kriteri, prej operatorit ekonomik ofertues eshte paraqitur dokumentacion per 6 mjete me targa AA081RS, AA853NJ, AA539TI, AA631 PB, AA865SD, AA871SD. Nga verifikimet e dokumentacionit te paraqitur te kryera prej KVO, por edhe prej verifikimeve te kryera prej KSHA rezulton se 3 prej mjeteve nuk plotesojne kapacitetin e kerkuar ne dst, fakt ky i pranuar edhe ne ankese si devijim i vogel, nje mjet e ka te provuar katerciperisht se i ka perfunduar afati i pageses se takses te mjetit, kurse dy mjetet e tjera nuk jane kamione por, mjete teknologjike.*
*Konkretisht nga verifikimi i dokumentacionit per keto mjete ka rezultuar se*
*• Mjeti me targa AA081RS i deklaruar ne deklaraten e mjeteve te paraqitur ne Bashkine Vlore si kamion me kapacitet transportues 15 - 25 ton, bazuar ne lejen e qarkullimit te paraqitur rezulton se eshte me kapacitet 27 ton (40000 kg me ngarkese - 12912 kg pa ngarkese). Ky mjet eshte mbi kapacitetin transportues te kerkuar ne kriterin e kualifikimit.*

• *Mjeti me targa AA853NJ i deklaruar ne deklaraten e mjeteve te paraqitur ne Bashkine Vlore si kamion me kapacitet 20 ton, i marre me qira me kontraten me nr.9778rep dhe nr.6809 kol, bazuar ne dokumentin per pagimin e taksave vjetore te paraqitur rezulton se eshte leshuar dhe paguar ne date 13.12.2018 qe me nje afat vlefshrnerie prej 1 (një) viti del që ka përfunduar në datën 12.12.2019, nderkohe qe afati per hapjen e ofertave te kesaj procedure ka qene data 06.01.2020.*

• *Mjeti me targa AA539TI i deklaruar ne deklaraten e mjeteve te paraqitur ne Bashkine Vlore si kamion pastrimi, rezulton se eshte me kapacitet 6,8 ton ton (19000 kg me ngarkese - 12150 kg pa ngarkese). Ky mjet eshte nen kapacitetin e kerkuar ne kriterin e kualifikimit. Per kete mjet edhe pse shkruhet ne deklaraten e mjeteve te paraqitur me emertimin "kamion pastrimi", pa u sqaruar nese eshte mjet teknologjik apo kamion, ne te dyja rastet, si do qe te jete eshte nen kapacitetin e kerkuar ne dst. Ne kuptim te perkufizimit te Kodit Rrugor, te cituar me siper, por edhe bazuar ne lejen e qarkullimit ky mjet eshte APV dhe jo kamion dhe per pasoje nuk e ploteson kriterin e kualifikimit 3.3.10.b.*

• *Mjeti me targa AA631 PB i deklaruar ne deklaraten e mjeteve te paraqitur ne Bashkine Vlore si kamion pastrimi, rezulton se eshte me kapacitet 5,8 ton ton (19000 kg me ngarkese- 13200 kg pa ngarkese). Ky mjet eshte nen kapacitetin e kerkuar ne kriterin e kualifikimit. Per kete mjet edhe pse shkruhet ne deklaraten e mjeteve te paraqitur me emertimin "kamion pastrimi", pa u sqaruar nese eshte mjet teknologjik apo kamion, por qe sipas fotos rezulton te jete mjet teknologjik, ne te dyja rastet, si do qe te jete eshte nen kapacitetin e kerkuar ne dst. Ky mjet nuk eshte kamion transportues, por eshte mjet teknologjik kompatator per transportin e mbetjeve urbane. Ne kuptim te perkufizirnit te Kodit Rrugor, te cituar me siper, por edhe bazuar ne lejen e qarkullimit ky mjet eshte APV dhe jo kamion dhe per pasoje nuke ploteson kriterin e kualifikimit 3.3.10.b.*

• *Mjeti me targa AA865SD i deklaruar ne deklaraten e mjeteve te paraqitur ne Bashkine Vlore, me emërtimin "kamion pastrimi", rezulton se eshte deklaruar per tu perdorur ne Bashkine Kavaje, rezulton se eshte deklaruar per tu perdorur si makine teknologjike ne Bashkine Devoll, si dhe rezulton se eshte deklaruar per tu perdorur si kompatator ne Bashkine Tirane. Bazuar ne korrespodencen e mbajtur me keto institucione rezulton se jo vetem qe ky mjet nuk mund perdoret per realizimin e kontrates ne Bashkine Vlore, pasi eshte ne sherbim te njekohshem ne tre Bashki te tjera, por edhe te dhenat per llojin dhe funksionin e mjetit jane kontradiktore, pasi ne kater Bashki te ndryshme i njejti mjet me te njejtin shasi deklarohet njekohesisht si kamion transportues, si makine teknologjike, si kompatator. Bazuar ne foton e paraqitur, ky mjet eshte teknologjik dhe jo kamion transporti sikurse eshte kerkuar ne piken e mesiperme te kualifikimit. Ne kuptim te perkufizimit te Kodit Rrugor, te cituar me siper, por edhe bazuar ne lejen e qarkullimit ky mjet eshte APV dhe jo kamion dhe per pasoje nuk e ploteson kriterin e kualifikimit 3.3.10.b.*
• *Mjeti me targa AA871 SD i deklaruar ne deklaraten e mjeteve te paraqitur ne Bashkine Vlore, me emertimin "kamion pastrimi", rezulton se eshte deklaruar per tu perdorur ne Bashkine Kavaje, rezulton se eshte deklaruar per tu perdorur si makine teknologjike ne Bashkine Devoll, si dhe rezulton se eshte deklaruar per tu perdorur si kompatator ne Bashkine Tirane. Bazuar ne korrespodencen e mbajtur me keto institucione rezulton se jo vetern qe ky mjet nuk mund perdoret*

*per realizimin e kontrates ne Bashkine Vlore, pasi eshte ne sherbirn te njekohshern ne tre Bashki te tjera, por edhe te dhenat per llojin dhc funksionin e mjetit jane kontradiktore, pasi ne kater Bashki te ndryshme i njejti mjet mete njejtin shasi deklarohet njekohesisht si kamion transportues, si makine teknologjike, si kompatator. Bazuar ne foton e paraqitur, ky mjet eshte teknologjik dhe jo kamion transporti sikurse eshte kerkuar ne piken e mesiperme te kualifikimit. Ne kuptim te perkufizimit te Kodit Rrugor, te cituar me siper, par edhe bazuar ne lejen e qarkullimit ky mjet eshte APV dhe jo kamion dhe per pasoje nuk e ploteson kriterin e kualifikimit 3.3.10.b.*

*Edhe ne kete rast sjellim ne vëmendje, te njejtin argumentim, si me siper te bazuar ne vendimin nr.871/2018 date 26.12.2018 te Komisionit te Prokurimit Publik.*

*Bazuar ne dokumentacionin e paraqitur, shoqeria "Aiko - Impex General Construction" nuk ka mundur te paraqese dokumentacion se disponon 2 kamiona me kapacitet transportues 15 - 25 ton, duke mos plotesuar kriterin e vecante te kualifikimit per sasine dhe llojet e mjeteve. Njekohesisht bazuar ne nenin 46/1/b te LPP-se, nuk ka vertetuar se "zoteron makinerite, pajisjet e asete te tjera fizike, reputacionin dhe besueshmerine, per te zbatuar kontraten, sic eshte pershkruar nga autoriteti kontraktor ne njoftimin e objektit te kontrates", si dhe bazuar ne nenin 53/3 te LPP-se, oferta e paraqitur "nuk eshte ne perputhje me te gjitha kerkesat dhe specifikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentet e tenderit".*

*Ne lidhje me pretendimet e ngritura ne faqen 19 - 22 te ankeses, eshte me shumë e nevojshme dhenia e sqarimeve per operatorin ekonomik ankimues.*

*Nga OE ankimues eshte ngritur pretendimi se midis termit "kamion pastrimi" dhe termit "kamion teknologjik" nuk ka asnje ndryshim.*

*Nga verifikimet e kryera dhe nga informacionet e marra prej anetareve te KVO ne lidhje me kete shkak skualifikimi, vlen te sqarohet se duke qene se ne deklaraten e mjeteve te paraqitur, ne faqen e pare per mjetet e deklaruara me targa AA630PB deri AA526TI, perdoret termi mjet teknologjik, kurse ne vijim per mjetet me targa AA539TI, AA631PB, AA856SD, perdoret termi mjet pastrimi, si dhe duke u nisur nga fakti qe shoqeria ankimuese ne Bashki te ndryshme i ka paraqitur mjetet me funksionalitet te ndryshern, prej KVO eshte verifikuar edhe mundesia se mos OE i ka paraqitur keto tre mjete per te provuar se disponon kapacitetet teknike te pikes 3.3.10.b. Ne kushtet kur nga verifikimet e kryera rezultoi se keto tre mjete nuk ishin kamionë transportues, por mjete teknologjike, nen kapacitetin e kerkuar, eshte marre vendimi se keto mjete nuk e permbushin kriterin e kualifikimit 3.3.10.a. ne dst per lotin e pare.*

*Nga verifikime te ndryshme te kryera prej KSHA, pervec sa eshte sqaruar e argumentuar me lart, gjate shqyrtimit te pretendimeve te ngritura ne ankese, ka rezultuar se shoqeria "Aiko - Impex General Construction" per te plotesuar kriterin e percaktuar ne piken 3.3.10.a. te kualifikimit per lotin e pare, ka paraqitur dhjete mjete teknologjike me targa AA630PB, AA632PB, AA633PB, AA634PB, AA864SD, AA526Tl, AA865SD, AA871SD, AA631PB, AA539TI ne pronesi, si dhe 4 mjete teknologjike me targa AA 786YT, AA319ZI, AA875XI, AA392ZI.*

*Nga mjetet e mesiperrne teknologjike te deklaruara rezulton se 5 prej tyre jane nen kapacitetin e kerkuar ne pi ken 3.3.10.a. te kualifikimit per lotin e pare, pasi konkretisht mjetet me targa AA865SD dhe AA871SD kane kapacitet 7,8 ton, mjeti me targa AA631PB ka kapacitet 5,8 ton, mjeti me targa AA539TI ka kapacitet 6,8 ton, mjeti me targa AA392ZI ka kapacitet 7,57 ton.*

*Pervec kesaj nga verifikimet e kryera, ka rezultuar se bazuar ne percaktimet e Vendimit nr.708/2018 te KPP-se, shoqeria ankimuese i ka shitur me kontraten shitje mjetesh me kusht*

*nr.1367 rep., nr.993 kol., date 12.07.2018, mjetet me targa AA633PB, AA634PB, AA631PB, AA539TI, AA344UB, AA538TI, AA589MS, AA618GM, AA675PI, AA4490E, kamion veteshkarkues; - AA537TI, kamion veteshkarkues; AGMT 47, fshesa mekanike; AA593MS, AA588MS, APV, bot uji.*
*Ne keto kushte nga 15 mjete teknologjike te deklaruara se do te kryeje sherbimin e pastrimit ne Bashkine Vlore rezulton si me poshte ne menyre tabelare:*
*Mjeti me targa AA630PB,*
*Mjeti me targa AA632PB,*
*Mjeti me targa AA633PB, shitur me kontraten e sipercituar*
*Mjeti me targa AA634PB, shitur me kontraten e sipercituar*
*Mjeti me targa AA864SD,*
*Mjeti me targa AA526Tl,*
*Mjeti me targa AA865SD, nen kapacitetin e kerkuar*
*Mjeti me targa AA871SD, nen kapacitetin e kerkuar*
*Mjeti me targa AA631PB, shitur me kontraten e sipercituar, si dhe nen kapacitetin e kerkuar*
*Mjeti me targa AA539TI shitur me kontraten e sipercituar, si dhe nen kapacitetin e kerkuar*
*Mjeti me targa AA786YT,*
*Mjeti me targa AA319ZI,*
*Mjeti me targa AA875Xl,*
*Mjeti me targa AA392ZI nen kapacitetin e kerkuar*
*Sikurse u sqarua edhe ne menyre te detajuar nga 14 mjete teknologjike, 7 prej tyre jane shitur dhe nuk ka te drejten e disponimit, ose jane nen kapacitetin e kerkuar.*
*Objekt i kontrates shitje mjetesh me kusht nr.1367 rep., nr.993 kol, date 12.07.2018 eshte edhe autofshesa me targa AGMT 47, cka riprovon qartesisht argumentimet e dhena per mosplotesimin e kriterit te percaktuar ne pi ken 3.3.10.e.*
*Ne rastin konkret, bazuar ne praktiken e KPP ekzistojne dy vendime (sikurse jane sipercituar) qe ijapin te drejte vendimarrjes se Autoritetit Kontraktor dhe rrezojne teresisht pretendimet e ngritura ne ankim.*
*Si përfundim, ne shqyrtim te ankeses se paraqitur prej shoqerise "Alko - Impex General Construction" dhe gjithe dokumentacionit te verifikuar nga ana jone, kjo ankese nuk pranohet dhe rrezohet, pasi shkaqet e skualifikimit jane te drejta, te bazuara ne legjislacionin ne fuqi, dokumentacionin e paraqitur ne tender, si dhe në dokumentat standarte.[…]*

II.6. Në datën 02.03.2020, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke kundërshtuar skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit objekt shqyrtimi.
Konkretisht në ankesën e paraqitur pranë KPP-së operatori ekonomik ankimues pretendon:
*[...]*
*Shoqeria ALKO IMPEX GENERAL CONSTRUCTION dshh, (ketu e ne vijim OE ankimues), ka marre pjese ne proceduren e prokurimit me objekt "Sherbim i Pastrimit ne Qytetin Vlorë", me autoritet kontraktor Bashkia Vlore (ketu e ne vijim AK), procedure e zhvilluar ne sistemin e prokurimit elektronik (ketu e ne vijim SPE) me dt. 06.01.2020. Me dt. 10.02.2020, me ane te*

*sistemit te prokurimit elektronik jemi njoftuar per skualifikimin e ofertes se paraqitur prej nesh dhe kualifikimin e ofertuesit te tjere pjesmarres ne kete procedure prokurimi si me poshte:*

*“Alko Impex General Construction” 543573407 skualifikuar*

*“Duka” 581685822 kualifikuar*

*Arsyeja e refuzimit të ofetës së paraqitur prej nesh është:*

*- Në pikën 3.3.4 të kritereve të vecanta të kualifikimit për lotin 1 është përcaktuar: ”Subjekti te jete i pajisur me licence nga QKB për kategorinë III.1.A Leje e thjeshte mjedisore për Shërbimi i pastrimit dhe i largimit të mbeturinave urbane, Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme”. Për të përmbushur këtë kriter prej shoqërisë ”ALKO-IMPEX GENERAL CONSTRUCTION” është paraqitur Leje PN-0928- 10-2015 me Kod III.1.A e lëshuar prej QKL me emërtim përshkrues të veprimtarisë ”Leje mjedisi e tipit C: Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme” e shoqëruar me Akt Miratimi nr.370 prot datë 28.09.2015. Subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion që të vërtetojë se disponon leje nga QKB për kategorinë III.1.A me emërtimin “Leje e thjeshte mjedisore për Shërbimi i pastrimit dhe i largimit të mbeturinave urbane”.*

*- Në pikën 3.3.10 të kritereve të vecanta të kualifikimit për lotin 1 është përcaktuar: ” Subjekti ofertues duhet te jete i pajisur me autorizim ose leje për përdorimin e burimeve ujore, per efekt te perdorimit te ujit me te cilin do te kryhen sherbimet objekt i ketij prokurimi”. Për të përmbushur këtë kriter prej shoqërisë ”ALKO-IMPEX GENERAL CONSTRUCTION” është paraqitur*

*• Autorizim nr.239 prot datë 11.11.2019 i lëshuar prej ”Ujësjellës Kanalizime Devoll” sh.a ku përcaktohet se autorizon shoqërinë ”ALKO-IMPEX GENERAL CONSTRUCTION” për përdorimin e burimeve ujore nën administrimin e e kësaj shoqërie. Ky dokument nuk e plotëson kriterin e kualifikimit për dy arsye pasi së pari burimet ujore të ndërmarrjeve të ujësjellës kanalizime janë të pijshme dhe për pasojë subjekti duhet të tarifohet si për përdorimin e ujit të pijshëm, kurse përdorimi i ujit për shërbimet komunale duhet të kryhet nga burimet ujore sipas VKM nr.662 datë 21.09.2016, së dyti përdorimi i ujit me të cilin do të kryhen shërbimet objekt i këtij prokurimi nevojitet për qytetin e Vlorës, ndërkohë që autorizimi është për Bashkinë Devoll.*

*• Shkresë Kthim përgjigje nr.1505/1 prot datë 11.12.2019 e lëshuar prej Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore ku sqarohet shoqëria ”ALKO-IMPEX GENERAL CONSTRUCTION” se ”pas plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor të përcaktuar në VKM nr.416 datë 13.05.2015 duhet të aplikojë pranë Zyrës së Administrimit të Basenit Ujor përkatës dhe më tej miratohen pranë Këshillit të Basenit Ujor. Lejet apo autorizimet lëshohen për një afat të caktuar kohor, sipas parashikimeve të pikës 5 të VKM nr.416 datë 13.05.2015”. Subjekti ofertues shoqëria ”ALKO-IMPEX GENERAL CONSTRUCTION” nuk rezulton të ketë paraqitur ndonjë dokumentacionin pranë Zyrës së Administrimit të Basenit Ujor sipas sqarimeve në shkresë për tu pajisur me lejë apo autorizim për përdorimin e burimeve ujore. Në bazë të pikës 4/b të VKM nr.416 datë 13.05.2015 ku përcaktohet shprehimisht se ”Lejet dhe autorizimet për përdorimin e ujit shqyrtohen nga Këshilli i Basenit Ujor (KBU), referuar nenit 50, të ligjit nr. 111/2012, i cili merr vendim jo më vonë se 2 (dy) muaj, nga data e paraqitjes së kërkesës”. Kjo procedurë prokurimi ka qenë e publikuar në SPE në datë 30.10.2019 dhe ofertat janë hapur në datë 06.01.2020, cka provon qartë se subjekti ofertues e ka patur kohën e nevojshme për të aplikuar për të përmbushur kriterin e kualifikimit.*

*- Në pikën 3.3.11 të kritereve të vecanta të kualifikimit për lotin 1 është përcaktuar: ”Shoqeria ofertuese duhet te disponoje dokumentacion qe per realizimin e kesaj kontrate te kete keto mjete (ne pronesi ose qira). Keto mjete duhet te jene te pajisur me dokumentacion sipas legjislacionit ne fuqi. Per mjetet qe jane me qira duhet te paraqitet edhe kontrata e qirase me nje afat vlefshmerie jo me pak se nje vit. Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), policen e sigurimit, taksat vjetore te mjetit, si dhe lejen e transportit nga bashkia per vete ose te trete. Mjetet duhet te paraqiten ne formen e nje deklarate ku te percaktohen targat, lloji, numri i shasise.” Dokumentacioni për të përmbushur këtë kriter i paraqitur prej shoqërisë ”ALKO-IMPEX GENERAL CONSTRUCTION”, për të gjitha mjetet e ngarkuar në SPE dhe të shoqëruar me deklaratën përkatëse, nuk përmban dokumentin për taksat vjetore te mjetit, sikurse përcaktohet në kriterin e kualifikimit për dokumentacionin që duhet të paraqesë.*

*- Në pikën 3.3.10 të kritereve të vecanta të kualifikimit për lotin 1 është përcaktuar: “Shoqeria ofertuese duhet te disponoje dokumentacion qe per realizimin e kesaj kontrate te kete keto mjete (ne pronesi ose qira): e. Autofshesa 3 cope (ne pronesi ose me qira) f. Mjet te posacem me goma qe kryen funksionin fshirje dhe larje njekohesisht 1 cope (ne pronesi ose me qira)” Bazuar në dokumentacionin e paraqitur në SPE prej shoqërisë ”ALKO-IMPEX GENERAL CONSTRUCTION” dhe të shoqëruar me deklaratën përkatëse, ka paraqitur mjetet me targa AA198TI, AGMT47, AGMT48 për të përmbushur kriterin 3.3.10.e, si dhe ka paraqitur mjetin me targa AA857XM për të përmbushur kriterin 3.3.10.f. Sikurse u sqarua edhe më sipër për këto mjete nuk ka paraqitur dokumentin për taksat vjetore te mjetit, por nga verifikimet e kryera zyrtarisht në Autoritetet Kontraktore ku ky subjekt ushtron aktivitet të ngjashëm me objektin e prokurimit, rezulton se:*

*• Mjeti me targa AA198TI me nr.shasie VF644ACA000013207 i deklaruar si “Autofshesë” në Bashkinë Vlorë, rezulton se është deklaruar për tu përdorur si kamion 7.5 – 18 ton në Bashkinë Kavajë, dhe për tu përdorur si Autobot në Bashkinë Tiranë. Bazuar në korrespodencën e mbajtur me këto institucione rezulton se jo vetëm që ky mjet nuk mund përdoret për realizimin e kontratës në Bashkinë Vlorë, pasi është në shërbim të njëkohshëm në dy Bashki të tjera, por edhe të dhënat për llojin dhe funksionin e mjetit janë kondradiktore, pasi në tre Bashki të ndryshme i njëjti mjet me të njëjtin shasi deklarohet njëkohësisht si autofshesë, si autobot, si kamion transportues.*

*• Mjeti me targa AGMT48 me nr.shasie SA92V5CXXA4068157 i deklaruar si “Autofshesë” në Bashkinë Vlorë, rezulton se është deklaruar edhe në Bashkinë Kavajë dhe në Bashkinë Tiranë. Bazuar në korrespodencën e mbajtur me këto institucione rezulton se ky mjet nuk mund përdoret për realizimin e kontratës në Bashkinë Vlorë, pasi është në shërbim të njëkohshëm në dy Bashki të tjera.*

*• Mjeti me targa AA857XM me nr.shasie VF644ACA000013903 i deklaruar si “Mjet te posacem me goma qe kryen funksionin fshirje dhe larje njekohesisht” në Bashkinë Vlorë, rezulton se është deklaruar për tu përdorur si kamion 7.5 – 18 ton në Bashkinë Kavajë. Bazuar në korrespodencën e mbajtur me këto institucione rezulton se jo vetëm që ky mjet nuk mund përdoret për realizimin e kontratës në Bashkinë Vlorë, pasi është në shërbim të njëkohshëm edhe në një Bashki tjetër, por edhe të dhënat për llojin dhe funksionin e mjetit janë kondradiktore, pasi në dy Bashki të ndryshme i njëjti mjet me të njëjtin shasi deklarohet njëkohësisht si mjet fshirës dhe si kamion transportues.*

*Për sa më lart, shoqëria "ALKO-IMPEX GENERAL CONSTRUCTION" jo vetëm nuk ka plotësuar kriterin e vecantë të kualifikimit për sasinë dhe llojet e mjeteve, por edhe bazuar në nenin 46/1/b të LPP-së, nuk ka vërtetuar se "zotëron makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës", si dhe bazuar në nenin 53/3 të LPP-së, oferta e paraqitur "nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit".*

*- Në pikën 3.3.10 të kritereve të vecanta të kualifikimit për lotin 1 është përcaktuar: "Shoqeria ofertuese duhet te disponoje dokumentacion qe per realizimin e kesaj kontrate te kete keto mjete (ne pronesi ose qira): b. Kamion me kapacitet transportues 15 - 25 ton 2 cope (ne pronesi ose me qira)" Bazuar në dokumentacionin e paraqitur në SPE prej shoqërisë "ALKO-IMPEX GENERAL CONSTRUCTION" dhe të shoqëruar me deklaratën përkatëse, ka paraqitur mjetet me targa AA081RS, AA539TI, AA631PB, AA865SD, AA871SD për të përmbushur kriterin 3.3.10.b. Sikurse u sqarua edhe më sipër për këto mjete nuk ka paraqitur dokumentin për taksat vjetore, por nga verifikimet e kryera zyrtarisht në Autoritetet Kontraktore ku ky subjekt ushtron aktivitet të ngjashëm me objektin e prokurimit rezulton se:*

- *Mjeti me targa AA081RS i deklaruar në deklaratën e mjeteve të paraqitur në Bashkinë Vlorë si kamion me kapacitet transportues 15 – 25 ton, bazuar në lejen e qarkullimit të paraqitur rezulton se është me kapacitet 27 ton (40000 kg me ngarkesë – 12912 kg pa ngarkesë). Ky mjet është mbi kapacitetin transportues të kërkuar në kriterin e kualifikimit.*
- *Mjeti me targa AA853NJ i deklaruar në deklaratën e mjeteve të paraqitur në Bashkinë Vlorë si kamion me kapacitet 20 ton, i marrë me qira me kontratën me nr.9778rep dhe nr.6809 kol, bazuar në dokumentin për pagimin e taksave vjetore të paraqitur rezulton se është lëshuar dhe paguar në datë 13.12.2018 që me një afat vlefshmërie prej 1 vit del që ka përfunduar në datë 12.12.2019, ndërkohë që afati për hapjen e ofertave të kësaj procedure ka qenë data 06.01.2020.*
- *Mjeti me targa AA539TI i deklaruar në deklaratën e mjeteve të paraqitur në Bashkinë Vlorë si kamion pastrimi, rezulton se është me kapacitet 6,8 ton ton (19000 kg me ngarkesë – 12150 kg pa ngarkesë). Ky mjet është nën kapacitetin e kërkuar në kriterin e kualifikimit. Për këtë mjet edhe pse shkruhet në deklaratën e mjeteve të paraqitur më emërtimin "kamion pastrimi", pa u sqaruar nëse është mjet teknologjik apo kamion, në të dyja rastet, si do që të jetë është nën kapacitetin e kërkuar në dst.*
- *Mjeti me targa AA631PB i deklaruar në deklaratën e mjeteve të paraqitur në Bashkinë Vlorë si kamion pastrimi, rezulton se është me kapacitet 5,8 ton ton (19000 kg me ngarkesë – 13200 kg pa ngarkesë). Ky mjet është nën kapacitetin e kërkuar në kriterin e kualifikimit. Për këtë mjet edhe pse shkruhet në deklaratën e mjeteve të paraqitur më emërtimin "kamion pastrimi", pa u sqaruar nëse është mjet teknologjik apo kamion, por që sipas fotots rezulton të jetë mjet teknologjik, në të dyja rastet, si do që të jetë është nën kapacitetin e kërkuar në dst.*
- *Mjeti me targa AA865SD i deklaruar në deklaratën e mjeteve të paraqitur në Bashkinë Vlorë, me emërtimin "kamion pastrimi", rezulton se është deklaruar për tu përdorur në Bashkinë Kavajë, rezulton se është deklaruar për tu përdorur si makinë teknologjike në Bashkinë Devoll, si dhe rezulton se është deklaruar për tu përdorur si kompatator në Bashkinë Tiranë. Bazuar në korrespodencën e mbajtur me këto institucione rezulton se jo vetëm që ky mjet nuk mund përdoret*

*për realizimin e kontratës në Bashkinë Vlorë, pasi është në shërbim të njëkohshëm në tre Bashki të tjera, por edhe të dhënat për llojin dhe funksionin e mjetit janë kontradiktore, pasi në katër Bashki të ndryshme i njëjti mjet me të njëjtin shasi deklarohet njëkohësisht si kamion transportues, si makinë teknologjike, si kompatator.*

*• Mjeti me targa AA871SD i deklaruar në deklaratën e mjeteve të paraqitur në Bashkinë Vlorë, me emërtimin "kamion pastrimi", rezulton se është deklaruar për tu përdorur në Bashkinë Kavajë, rezulton se është deklaruar për tu përdorur si makinë teknologjike në Bashkinë Devoll, si dhe rezulton se është deklaruar për tu përdorur si kompatator në Bashkinë Tiranë. Bazuar në korrespodencën e mbajtur me këto institucione rezulton se jo vetëm që ky mjet nuk mund përdoret për realizimin e kontratës në Bashkinë Vlorë, pasi është në shërbim të njëkohshëm në tre Bashki të tjera, por edhe të dhënat për llojin dhe funksionin e mjetit janë kontradiktore, pasi në katër Bashki të ndryshme i njëjti mjet me të njëjtin shasi deklarohet njëkohësisht si kamion transportues, si makinë teknologjike, si kompatator.*

*Për sa më lart, shoqëria "ALKO-IMPEX GENERAL CONSTRUCTION" jo vetëm nuk ka plotësuar kriterin e vecantë të kualifikimit për sasinë dhe llojet e mjeteve, por edhe bazuar në nenin 46/1/b të LPP-së, nuk ka vërtetuar se "zotëron makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës", si dhe bazuar në nenin 53/3 të LPP-së, oferta e paraqitur "nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit".*

*Duke vlerësuar se Vendimi i Autoritetit Kontraktor për skualifikimin e ofertës sonë ishtë në kundështim me ligjin dhe kriteret e përcaktuara në DST, OE ankimues paraqiti ankesë pranë AK-së datë 13.01.2020 duke kërkuar shfuqizimin e vendimit të KVO-së dhe kualifikimin e ofertës së paraqitur nga OE ankimues në këtë proceurë prokurimi.*

*Ak nëpërmjet shkresës Nr. 1560/2prot datë 19.02.2020 ka njoftuar OE ankimues lidhur me vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të ankesave në përfundim të së cilës rezulton se Autoriteti Kontraktor ka vendosur rrëzimin e saj. Duke mos qënë dakord me vendimin e AK-së mbi arsyete skualifikimit të ofertës sonë paraqesim këtë ankesë përpara jusgh duke argumentuar dhe analizuar mbështetur në dispozitat ligjore pse ankesa e paraqitur nga ana jonë duhet pranuar si e pabazuar në ligj dhe prova.*

*II. THEMELI I MOSMARRËVESHJES*

*MBI RESPEKTIMIN E AFATAVE TË ANKIMIT*

*Në nenin 63 të ligjit 9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar është parashikuar:*

*1. Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.*

*1.1 Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor*

*pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni.*

*2. Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji.*

*3. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi përpara skadimit të afatit kohor, të përcaktuara në pikat 5 dhe 6 të këtij neni.*

*4. Nëse është e nevojshme, autoriteti kontraktor zgjat afatet kohore të procedurës së prokurimit për periudhën e pezullimit, të përmendur në pikën 3 të këtij neni. Në rast se afatet kohore të procedurës së prokurimit, të njoftuara për ofertuesit, ndryshojnë për shkak të shqyrtimit të ankesës, autoriteti kontraktor duhet të njoftojë të gjithë ofertuesit për arsyet e zgjatjes së afatit kohor.*

*5. Autoriteti kontraktor shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t'ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës.*

*6. Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim e ankesës i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor.*

*7. Ankesa në Komisionin e Prokurimit Publik bëhet me formularin përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete, baza ligjore dhe përshkrimi i shkeljes, pretendimi i ankuesit për vendimin përfundimtar, shkallët e ankimit, shoqëruar me dokumentacionin përkatës dhe vendimin e autoritetit kontraktor" Elementet e mësipërme janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Komisioni i Prokurimit Publik e shqyrton ankesën në përputhje me këtë ligj, Kodin e Procedurave Administrative dhe rregullat e prokurimit publik. Mosndjekja e shkallëve të ankimit e bën ankesën të pavlefshme.*

*8. Me marrjen e ankesës së ankimuesit për në Komisionin e Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor mban të pezulluar procedurën e prokurimit, me përjashtim të rasteve kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos ndryshe, në përputhje me pikën 2, të nenit 64, të këtij ligji. Autoriteti kontraktor ia dërgon të gjithë informacionin që disponon për procedurën e prokurimit të ankimuar menjëherë, por, në çdo rast, jo më vonë se 5 ditë, Komisionit të Prokurimit Publik.*

*9. Me marrjen e ankesës me shkrim të ankimuesit, Komisioni i Prokurimit Publik përgjigjet me shkrim lidhur me përmbushjen e elementeve formale të ankimit, brenda 5 ditëve, duke filluar nga dita e nesërme e punës. Kur për shqyrtimin e ankesës i kërkohet informacion apo dokumentacion autoritetit kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik merr vendim, jo më vonë se 15 ditë pas marrjes së informacionit apo dokumentacionit të kërkuar.*
*Përjashtimisht, nëse Komisioni i Prokurimit Publik, për shkaqe të ligjshme, nuk arrin të marrë një vendim brenda afatit 15-ditor, duhet t'i bëjë të ditur palëve në proces, arsyet e mosmarrjes së këtij vendimi. Nga ky moment, brenda 15 ditëve, Komisioni i Prokurimit Publik ka detyrimin të dalë me vendimin përfundimtar për shqyrtimin e ankesës.*
*10. Çdo ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik bëhet kundrejt pagesës. Rregullat dhe tarifat e pagesës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave"*

*11. Për procedurat e prokurimit, për të cilat nuk bëhet njoftim publik, sipas nenit 38 të këtij ligji, nuk zbatohen dispozitat lidhur me procedurat e ankimit administrative.*

*Fillimisht sqarojmë se vendimi i KVO-së për skualifikimin e ofertës së paraqitur prej nesh në procedurën e prokurimit objekt gjykimi është kryer 10.02.2020. Brenda afatit të parashikuar në pikën 2 të dispozitës së sipërcituar, e konkretisht më datë 13.02.2020. Autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje OE ankimues me anë të shkresës nr. 1560/2prot datë 19.02.2020, marrë dijeni 22.02.2020(referuar gjurmimit postar), ndërkohë zarfi postar mban datën 21.02.2020 datë në të cilën rezulton se autoriteti kontraktor ka dërguar pranë Zyrave Postare shkresën e sipërpërmendur.*
*Pra rezulton se kthim përgjigjea nga Autoriteti Kontraktor është jashtë afatit 10 ditor të parashikuar nga pika 4 e nenit 63, afat i cili përfundonte më datë 19.02.2020.*
*Referuar pikës 5 të nenit 63, OE ankimues i lind e drejta dhe detyrimi i respektimit të afatit për paraqitjen e ankesës pranë KPP-së Brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës e përfundimit të afatit të shqyrtimit të ankesës nga AK, thënë ndryshe Brenda 10 ditëve nga e nesërmja e punës e datës 19.02.2020.*
*Afati përfundimtar për dorëzimin e ankesë pranë KPP-së rezulton data 29.02.2020.*
*Por nga data 29.02.2020 rezulton ditë pushimi (e shtunë) e si rrjedhojë afati shtyhet deri ditën vijuese të punës që është dita e Hnë e konkretisht data 02.03.2020, referuar nenit 62 të Kodit të Procedurës Administrative (pasi në rastin konkret ligji material nuk ka një parashikim të tillë i referohemi ligjit të përgjithshëm) në të cilin është parashikuar:*
*Neni 62*
*Llogaritja e afateve kohore*
*Ne llogaritjen e afateve kohore zbatohen rregullat e meposhtme:*
*a) Ne llogaritjen e afateve nuk perfshihet dita ne te cilen del akti;*
*b) llogaritja e afatit kohor pezullohet te shtunave, te dielave dhe diteve te festave zyrtare;*
*c) ne rastet kur perfundimi i afatit qellon ne nje dite kur administrata qe do te zbatoje aktin eshte e mbyllur ose funksionon me orare te reduktuara, zbatimi i aktit shtyhet per diten pasardhese te punes.*

*Sa më sipër sqaruam reaulton se ankesa e paraqitur është Brenda afateve ligjorëe të parashikuara nga neni 63 i ligjit 9643 dt. 20.11.2006 "Për prokurimin Publik", i ndryshuar.*

*MBI THEMELIN E MOSMARRËVESHJES*

3. *Lidhur me arsyen e parë të skualifikimit*

   *- Në pikën 3.3.4 të kritereve të vecanta të kualifikimit për lotin 1 është përcaktuar: "Subjekti te jete i pajisur me licence nga QKB për kategorinë III.1.A Leje e thjeshte mjedisore për Shërbimi i pastrimit dhe i largimit të mbeturinave urbane, Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme". Për të përmbushur këtë kriter prej shoqërisë "ALKO-IMPEX GENERAL CONSTRUCTION" është paraqitur Leje PN-0928- 10-2015 me Kod III.1.A e lëshuar prej QKL me emërtim përshkrues të veprimtarisë "Leje mjedisi e tipit C: Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme" e shoqëruar me Akt Miratimi nr.370 prot datë 28.09.2015. Subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion që të vërtetojë se disponon leje nga QKB për kategorinë III.1.A me emërtimin "Leje e thjeshte mjedisore për Shërbimi i pastrimit dhe i largimit të mbeturinave urbane". - Në pikën 3.3.10 të kritereve të vecanta të kualifikimit për lotin 1 është përcaktuar*

*Lidhur me këtë arsye gjykojmë se kjo arsye për skualifikimin e ofertës tonë nuk qëndron pasi:*

*Në nenin 46, pika 2 dhe 3 ligjit nr. 9643 dt. 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar parashikohet se:*

4. *Autoriteti kontraktor mund të kërkojë edhe certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit. 3. Kërkesat për kualifikim duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit public.*

*Ndërkohë dokumentat e tenderit është kërkuar:*

*Subjekti te jete i pajisur me licence nga QKBper kategorine III.1.A Leje e thjeshte mjedisore per Sherbimi i pastrimit dhe i largimit te mbeturinave urbane, Stacion transferimi per mbetje jo te rrezikshme*

*Referuar ligjit Nr. 10448 date 14.07.2011 "Per lejet e mjedisisit" te ndryshuar, por dhe ligjit Nr. 60/2014 "Per nje Ndryshim ne Ligjin 10448 date 14.07.2011", rezulton se nje Leje mjedisi me kete emertim nuk ekziston. Situata behet akoma me groteske kur pikerisht kerkimi i nje leje mjedisore qe nuk ezkiston ligjerisht perben shkak per skualifikimin e ofertes se paraqitur prej nesh.*

*Nuk rezulton te kete asnje leje me kod III.1.A me kete emertim.*

*Ne nenin 23 te ligjit nr. 9643/2006 "Per Prokurirnin Publik" i ndryshuar parashikohet se:*

*1. Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.*

*2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.*

*3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar:*

*a) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve;*

*b) kërkesave në terma funksionalë, kur një gjë e tillë kërkon t'u referohesh standardeve kombëtare ose ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;*

*c) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni për mallra, shërbime apo punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj*

*4. Përshkrimi i punimeve, mallrave apo shërbimeve duhet të përmbajë specifikimet teknike, që duhet të plotësohen në rast nevoje, edhe plane, vizatime, modele, makete etj. Në rast të përshkrimit funksional të punimeve apo të mallit, specifikimet teknike duhet të përshkruajnë në mënyrë të saktë dhe neutrale qëllimin e punimeve për njohjen e të gjitha kushteve dhe rrethanave me rëndësi për hartimin e ofertës.*

*Ne nenin 30 te VKM nr. 914 dt.29.12.2014 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", i ndryshuar parashikohet se:*

*"Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga sistemet e standardizimit kombëtar ose ndërkombëtar. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit."*

*2.Certifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.*

*Ne analize te dispozitave ligjore te cituara me siper, sqarojme se, Autoriteti Kontraktor gjate percaktimit te kritereve te vecanta duhet te shmangi cdo kerkese apo procedure qe lidhet me kualifikimin e operatoreve ekonornike, e cila perben diskriminim ndaj nje ose midis furnizuesve apo kontraktoreve ose ndaj kategorive te tyre. Por ne percaktimin/apo vendosjen e kritereve specifike, qe ne thelb konsiderohen si kritere fituese (aëard criteria), per shkak te rendesise qe kane, ligjvenesi i ka parashikuar kufizime autoritetit kontraktor brenda diskrecionit qe ka ne perzgjedhjen e tyre. Ne kete menyre, dispozitat e siperperrnendura, urdherojne se percaktimi i ketyre kritereve duhet te jete: (i) ne perpjesetim me natyren dhe permasat e kontrates qe do te prokurohet dhe (ii) jodiskriminuese, duke krijuar kushte per konkurrim te paanshern e te hapur nderrnjet te gjithe kandidateve e ofertuesve.*

*Ne nenin 46, pika 1, te ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: " 1. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese."*

*Eshte detyrim i autoretitet kontraktor te siguroje qe kerkesat/specifikimet teknike te jene te shkruara ne nje mënyrë te tille qe te hapin prokurimin publik ndaj konkurences, te lejojne akses te*

*barabarte për ofertuesitsi dhe nuk duhet te kene efektin e krijimit te pengesave të pajustifikuara në hapjen e prokurimit public ndaj konkurencës.*
*Si rrjedhoje, eshte detyrim qe ligjvenesi i ka vendosur autoriteteve kontratkore, te cilet ne perzgjedhjen e kritereve te vecanta duhet te argumentoje nevojen qe e dikton vendosja e nje kriteri te caktuar.*
*Vleresojme se kriteri i vecante i kualifikimit qe ka te beje me licensen e kerkuar me KOD III.1.A me emërtimin e kerkuar, bie ndesh me dispozitat urdheruese te ligjit nr. 9643/2006 "Per Prokurimin Publik" i ndryshuar, per shkak se ky kriter nuk argumentohet dhe nevojitet ne proceduren e prokurimit objekt gjvkimi e akoma me tej nuk rezulton që një leje/Iicense e tille te Ieshohet nga Qendra Kombetare e Licensimit sot Qendra Kombetare e Biznesit. Si i tille ky kriter eshte absolutisht i pavlefshm kjo sipas pikes i) te germes a) te nenit 108 te K.Pr. Administrativ e nuk mund te perbeje shkak per skualifikimin e OE ankimues.*
*Referuar ligjit Nr. 10448 date 14.07.2011 "Per lejet e mjedisit" te ndryshuar, por dhe ligjit Nr. 60/2014 Per nje Ndryshim ne Ligjin 10448 date 14.07.2011, e vetmja Leje e leshuar nga QKB qe lidhet ngushtesisht dhe pashmangerisht me kontraten objekt prokurimi (sherbim pastrimi) eshte ajo me KOD III.1.A. me objekt "Pastrim, larje, sprucim ose veshje e mbetjeve te ambalazhuara/paketimeve ose kontienrev qe menyre qe te riperdoren dhe KOD III.2.B ( Transport i mbetjeve jo te rrezikshme te cilat zotrerohen nga OE ankimues.*
*Ne nenin 23 pika 1, 2, 3 dhe 5 "Specifikimet teknike" te Ligjit nr.9643 date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik" i ndryshuar parashikohet se:'*
*c) te dyja metodave te percaktuara ne shkronjat "a" dhe "b" te pikes 3 te ketij neni per mallra, shërbime apo pune te ndryshme, te perfshira ne te njejtin objekt kontrate. Cdo reference duhet te shoqerohet nga fjalet "ose ekuivalenti i tij/saj. Si rrjedhoje ne permbushje te kriterit te kerkuar te vetmet dokumenta ligjor te leshuara nga QKL (sot QKB) jane ato te paraqitura nga OE ankimues. Ne veshtrim te faqes zyrtare te QKB-se rezulton se ofertuesi tjeter shoqeria DUKA shpk, zoteron nje autorizim mjedisor pikerisht me emertimin e kerkuar prej Jush. Kjo sjell dyshimin se percaktimi i ketij kriteri te kundraligjshem ka patur si qellim favorizimin e ketij subjekti dhe skualifikimin me pa te drejte te shoqerise sone. Akoma me tej bejme me dije se referuar ndryshimeve Iigjore ne fuqi autorizimet mjedisore jane te pavlefshme ne momentin e zhvillimit te procedures se prokurimit.*
*Keto autorizime mjedisore jane leshuar mbi Iigjin Nr. 8934 date 05.09.2002 "Per mbrojtjen e mjedisit", Iigji i cili eshte shfuqizuar dhe me ndryshimet ligjore OE DUKA shpk duhet te kishte here rishikimin e tyre bazuar ne ligjin 10448 date 14.07.2011 "Per lejet e mjedisit" neni 4 pika 3. Sa më sipër arsyeja e pretenduar për skualifikim nuk qëndron ose AK duhet të bëjë dhe skualifikimin e operatorit tjetër ekonomik pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi.*
*Pretendimi i AK-së në kthim përgjigje se lidhur me ligjshmërinë e kriterit nuk mund të shprehet pasi një hap i tillë duhet të ishte ndërmarrë nga ana e OE ankimues brenda 7 ditëve nga ana e publikimit të procedurës së prokurimit sqarojmë sërish se ky dokument i kërkuar nuk ekziston ligjërisht cka e bën këtë kriter absolutisht të pavlefshëm.*
*Nje kriter absolutisht i pavlefshern, qe nga momenti i nxjerrjes se tij, nuk krijon dhe as mund te krijoje pasojat juridike per te cilat ai eshte nxjerre, Nje kriter absolutisht i pavlefshern nuk eshte kriter, ai eshte nje nulitet i plote, i cili konsiderohet se nuk ka hyre ne fuqi asnjehere. Për shak të shkeljes së rëndë thelbësore të ligjit, pavlefshmëria absolute e kriteri nukmund të rregullohet në të ardhmen, as nga palët dhe as nga organi që e ka lëshuar aktin, pasi ky kriter konsiderohet*

*sikur nuk ka ekzistuar asnjëherë. Si i tille ai nuk mund te kete fuqi detyruese, as ndaj personave apo subjekteve, te cileve iu kundrejtohet dhe as ndaj organeve te tjera te administrates shteterore. Për të mbuluar paligjmërinë e veprimeve të KVO, KSHA nuk e bazon argurnentimin e saj në asnjë dispozitë ligjore por kërkon mbi mundësitë e pasjes së një leje të tillë nga subjekte të tjerë juridik tej atij të kualifikuar nga KVO.*

*Aq e dobët është përpjekja për të mbuluar paligjshmërinë sa në një vështrim të thjesht të këtyre "lejeve" të pretenduar si të rregullta vërehet se: 1. Të gjitha këto leje janë autorizime mjedisore dhe 2. Të gjitha janë nxjerrë para ndryshimeve ligjore e konkretisht ne ligjin 10448 date 14.07.2011 "Perlejet e mjedisit" neni 4 pika 3.*

*2.Lidhur me arsyen tjetër për skualifikim:*

*Subjekti ofertues duhet te jete i pajisur me autorizim ose leje për përdorimin e burimeve ujore, per efekt te perdorimit te ujit me te cilin do te kryhen sherbimet objekt i ketij prokurimi". Për të përmbushur këtë kriter prej shoqërisë "ALKO-IMPEX GENERAL CONSTRUCTION" është paraqitur Autorizim nr.239 prot datë 11.11.2019 i lëshuar prej "Ujësjellës Kanalizime Devoll" sh.a ku përcaktohet se autorizon shoqërinë "ALKO-IMPEX GENERAL CONSTRUCTION" për përdorimin e burimeve ujore nën administrimin e e kësaj shoqërie. Ky dokument nuk e plotëson kriterin e kualifikimit për dy arsye pasi së pari burimet ujore të ndërmarrjeve të ujësjellës kanalizime janë të pijshme dhe për pasojë subjekti duhet të tarifohet si për përdorimin e ujit të pijshëm, kurse përdorimi i ujit për shërbimet komunale duhet të kryhet nga burimet ujore sipas VKM nr.662 datë 21.09.2016, së dyti përdorimi i ujit me të cilin do të kryhen shërbimet objekt i këtij prokurimi nevojitet për qytetin e Vlorës, ndërkohë që autorizimi është për Bashkinë Devoll. Shkresë Kthim përgjigje nr.1505/1 prot datë 11.12.2019 e lëshuar prej Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore ku sqarohet shoqëria "ALKO-IMPEX GENERAL CONSTRUCTION" se "pas plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor të përcaktuar në VKM nr.416 datë 13.05.2015 duhet të aplikojë pranë Zyrës së Administrimit të Basenit Ujor përkatës dhe më tej miratohen pranë Këshillit të Basenit Ujor. Lejet apo autorizimet lëshohen për një afat të caktuar kohor, sipas parashikimeve të pikës 5 të VKM nr.416 datë 13.05.2015". Subjekti ofertues shoqëria "ALKO-IMPEX GENERAL CONSTRUCTION" nuk rezulton të ketë paraqitur ndonjë dokumentacionin pranë Zyrës së Administrimit të Basenit Ujor sipas sqarimeve në shkresë për tu pajisur me lejë apo autorizim për përdorimin e burimeve ujore. Në bazë të pikës 4/b të VKM nr.416 datë 13.05.2015 ku përcaktohet shprehimisht se "Lejet dhe autorizimet për përdorimin e ujit shqyrtohen nga Këshilli i Basenit Ujor (KBU), referuar nenit 50, të ligjit nr. 111/2012, i cili merr vendim jo më vonë se 2 (dy) muaj, nga data e paraqitjes së kërkesës". Kjo procedurë prokurimi ka qenë e publikuar në SPE në datë 30.10.2019 dhe ofertat janë hapur në datë 06.01.2020, cka provon qartë se subjekti ofertues e ka patur kohën e nevojshme për të aplikuar për të përmbushur kriterin e kualifikimit.*

*Nga autoriteti Kontraktor ne DST eshte kerkuar:*

*Subjekti ofertues duhet te jete i pajisur me autorizim e leje perperdorimin e burimeve ujore, per efekt te perdorimit te ujit me te cilin do le kryhen sherbimet objekt i ketij prokurimi*

*Nga ana e OE ankimues ne SPE eshte paraqitur dokumenti i emertuar: Autorizim*

*Në brendësi të këtij dokumenti gjenden:*

4. *Autorizim lëshuar nga Ujësjellës Kanalizime Devoll sha Nr. 239prot. datë 11.11.2019*

5. *Shkesë "Kthim përgjigje" lëshuar nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore Nr. 1505.1prot datë 11.12.2019.*

*Ne autorizimin e leshuar nga Ujesjelles Kanalizme Devoll sha eshte autorizuar shoqeria ALKO IMPEXGENERAL CONSTRUCTION dshh, per perdorimin e burimeve Ujore nën administratimin e Nderrnarrjes Ujesjelles Kanalizimeve Devoll shaper shkak te veprimtarisë së tij.*

*Autoriteti juaj pretendon se ky dokument nuk eshte i vlefshem pasi se pari shoqeria jone duhet se pari burimet ujore te ndermarrjes le ujsjelles kanalizimeve jane te pijshme dhe per pasoje subjekti duhet te tarifohet si per perdorimin e ujit të pijshem kurse perdorimimi i ujit per*
*sherbime komunale duhet te kryhet nga burimet ujore sipas VK.M-se Nr. 662, dale 21. 09. 2016, se*
*dyti perdorimi i ujit me te cilin do le kryhen sherbimet objeki i ketij prokurimi nevojitet per qytetin e Vlores, nderkohe qe autorizimi eshte per Bashkine Devoll.*

*Të dy këto pretendime janë sa të pavërteta aq dhe në kundështim me ligjin. Fillimisht sqarojmë se institucioni juaj e aq më pak Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nuk ka tagrat e duhura për të vlerësuar apo zhvleftësuar ligjshëmrinë e këtij dokumenti. Ai rezulton të jetë lëshuar nga organ i pavarur dhe dokumentat e lëshuara pej tij janë të vlefshme deri në shfuqizimin e tyre nga gjykata kompetente apo mënyra të tjera të parashikuaranë Kodin e Procedurës Administrative.*

*Së dyti tarifimi shoqërisë në lidhje me Ujin është një problematikë që nuk hyn në Juridiksionin apo kompetencës tuaj. Për Autoritetin Kontraktorv është e vlefshme që OE pjesmarrës të provojë se zotëron apo do të zotërojë kapacitete e duhura për realizimin me sukses të kontratës.*

*Së treti në asnjë fjalë të autorizimit, ndryshe nga sa KVO në mënyrë abuzive citon, nuk përmendet fakti se ky autorizim është i vlefshëm vetëm në qytetin e Devollit.*

*Së katërti tarifi dhe kosto e përballit të mbushjes së Ujit në Devoll dhe larja e qytetit në Vlorë është një risk i subjektit pjesmarrës dhe mbetet në diskrecionin e tij vleësimi i mundshëm i këtyre mundësive.*

*Së pesti në kërkesën e autoritetit kontraktor në Dst nuk specifikohet organi apo cili tip leje do të konsiderohet i vlefshëm apo jo për përmbushjen e kriterit të sipërcituar.*

*Nga verifikimi i dokumentave të tenderit, rezulton se janë përcaktuar kriteret e përgjithshme dhe kriteret e veçanta për kuaifikim , nga ku evidentohet të jetë përcaktuar vetëm kriteri që akt kërkohet një dokument (leje ose autorizim për përdorim të burimit ujor) dhe në asnjë rast nuk është përcaktuar ndonjë kërkesë në lidhje me faktin se kush është organ ii vetëm kompetentë apo që KVO vlerëson sit ë domosdoshëm për plotësimin e kriterit.*

*Në rastin konkret nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, rezulton se nga autoriteti kontraktor nuk është përcaktuar apo vendosur ndonjë kërkesë specifike në lidhje me autorizimin apo lejen, por është kërkuar thjesht paraqitja e këtij dokumenti pa ndonjë përcaktim tjetër të veçantëapo specific ndaj arsyeja e skualifikimit të dhënë nga ana e AK-së nuk qëndron, dhe një kriter i pakërkuar në dokumentat e tenderit nuk duhet të përbëjë shkak për skualifikim.*

*Autoriteti kontraktor duhet të bëjë vlerësimin e ofertave mbi bazën e kritereve të përcaktuara në dokumentat e tenderit, duke përjashtuar këtu vlerësimin mbi dokumenta shtesë të pakërkuara nga autoriteti kontraktor, të cilat për më tepër janë paraqitur nga OE nkimues. Për pasojë, operatorët ekonomikë pjesmarrës në nëjë procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosuara në dokumentat e tenderit e, rrjedhimisht vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.*

*Në rastin konkret, kur oferta e paraqitur është me çmim më të ulët dhe me leverdi ekonomike, duke kursyer buxhetin e shtetit në një vlerë të konsiderueshme autoriteti kontraktor nuk mund të skualifikojë OE ankimues duke kryer vetëm një vlerësim sipërfaqësordhe tendecioz. Ndaj OE ankimues.*
*Gjithashtu nga ana tjetër oe ankimues ka nënshkruar deklaratën e përmbushjes së specifikimeve teknike, ku deklaron plotësimin e të gjitha specifikimeve teknike, duke marrë përsipër nën përgjegjësinë e tij përmbushjen e këtyre të fundit, ka nënshkruar një sërë deklaratash , ku deklaron se përmbush të gjitha kriteret e kërkuara nga AK.*
*Sa më sipër autoriteti kontraktor duhet të udhëhiqet nga parimi i mirëpërdorimit të fondeve publike dhe përfitimi i një produkti me cilësi të mirë dhe me çmim më të ulët, si dhe nuk duhet të gjykojë në mënyrë sipërfaqësoree formale, aq më tepër në kushte kur kemi një përcaktim të qartë të kritereve dhe dokumentacionit që duhet të paraqitet, dokumentacion ky i cili provohet më së miri se operatori ekonomik ankimues e disponon.*
*Gjithashtu në bazë të nenit 62 "Detyrimet gjatë zbatimit të kontratës" të LPP-së, autoriteti kontraktor ka një rol të posaçëm, për vet cilësimin ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin me sukses të kontratës. Rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për tu siguruar nëse cilësia e mallit/shërbimit do të jetë e njëjtë me cilësinë dhe specifikimet teknike të premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë. Në këtë rast të shkeljes së kushteve të kërkuara, autoriteti kontraktor zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë, apo detyrimet, në mbështetje të nenit 62 të LPP-së, si më sipër cituar.*
*Së gjashtiAgjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, është organi më i lartë në fushën e menaxhimit të burimeve ujore. Ndërmjet shkresës së saj Nr. 1505.1prot, datë 11.12.2019 ka theksuar se subjektet që do të pajisen me leje apo autorizim për përdorimin e burimit ujorduhet të ushtrojnë veprimtarinë pas miratimit të saj. Pra, kushti për pajisjen me leje për përdorim të burimit ujor ndodh pas miratimit të veprimtarisë, më konkretisht pas lidhjes së kontratës administrative të rast të shpalljes fitues të kësaj procedure prokurimi.*
*Referuar ligjit nr. 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore" në asnjë dispozitë të saj nuk parashikohet marrja apo shfrytëzimi i këtyre burimeve ujore sipas pretendimeve të ngritura nga ana e Autoritetit Kontraktor. Edhe nëse i referohemi VKM-së nr. 416 datë 13.05.2015 "Për miratimin e kushteve të posaçme, dokumentet sghoqëruese, afatit të vlefshmërisë. Formularëve të Aplikimit për autorizim dhe leje, proçedurave të shqyrtimit e vendimarrjes dhe fomateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore" qartësisht kuptohet seautorizimi për marrjen e një leje apo autorizim të posaçëm që lidhet me ujin që do të shërbejë enkas për shërbimin e pastrimit të qytetit Vlorë, kryhet vetëm pas miratimit të kontratës (thënë ndryshe shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës përkatëse).*
*Edhe në këtë rast, ky kiter ka shërbyer për favorizimin e shoqërisë DUKA shpk. Në kushtet kur kjo shoqëri është dhe shoqëria që ka ushtruar dhe ka akoma në administrim shërbimin e pastrimit të Qytetit Vlorë, mbetet i vetmi subject juridik i mundshëm i cili të dispononte një dokument ekzaktësisht sipas pretendimeve tuaja. Dokumentat e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit Publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesmarrjen dhe konkurrencën e opeartorëve keonomikë, të stimulojnë pjesm,arrjen e biznesit të vogël e të mesëmsi dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të të gjithë*

*operatorët ekonomikë pjesmarrës në këto procedura, për realizimin me sukses t kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesmarrjes së operatorëve ekonomikë në respect të nenit 1 pika2të LPP-së i cili parashikon shprehimisht:*
*1. Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave që zbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve nga autoritetet kontraktore.*
*2. Qëllimi i këtij ligji është:*
*a) të rrisë efiçencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore;*
*b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
*c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
*ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
*d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
*Përsa i përket pretendimit të KSHA se në kushtet kur shërbimi i larjes dhe lagies në periudha të caktuara janë parashikuar për tu kryer përditë ose dy herë në ditë dhe pretendimi se rritja e kostos janë risk i subjketit pjesmarrës, janë pretendime që bazuar në nenin 45/1/b të LPP• së ulin besimin e Autoritetit Kontraktor..., sqarojmë se autoriteti kontratkor nuk mund të vlerësojë në mënyrë sipërfaqësore e formale por duhet të vlerësojë me objektivitet sidomos në kushtet kur kemi një ofertë ekonomike me leverdi për buxhetin e shtetit.*
*Ne nenin 46, pika 1, germa "c" te ligjit nr.9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: "Operatoret ekonomike, per te marre pjese ne procedurat e prokurimit, duhet te kualifikohen, pasi te kene permbushur te gjitha kriteret qe autoriteti kontraktor i vlereson te nevojshme, per sa kohe qe ato jane ne perpjestim me natyren dhe permasat e kontrates qe do te prokurohen dhe jodiskriminuese";*
*Kriteret e kualifikimit duhet te jene te qarta, te sakta dhe te rnirepercaktuara nga autoriteti kontraktor me qellim qe te jene sa me te kuptueshme jo vetem per operatoret ekonornike te interesuar per te gene pjesernarres, komisionin e vleresimit te ofertave ne menyre te tille qeprocesi i vlerësimit të mos kryhet me subjektivizëm, por të vendosë në situatë të barabartë edhe per personat me aftesi te kufizuar, duke mos penguar keshtu pjesemarrjen ne nje procedure prokurimi.*
*Ne piken 3 te nenit 27 te VKM nr. 914, date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar, eshte percaktuar: "Kerkesat e vecanta te kualifikimit duhet te perfshijne te gjitha kriteret specifike ne perputhje me nenin 46 te LPP. Kriteret duhet te Jene ne perpjesetim dhe le lidhura ngushte me aftesine zbatuese, natyren dhe vleren e kontrates. Ne cdo rast, autoriteti kontrakiues duhet te percaktoje dokumentet konkrete qe duhet te paraqesin opera tore! ekonomike per permbushjen e ketyre kritereve",*
*Ne piken 5 te nenit 28 te VKM-së nr. 914 date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar, percaktohet shprehimisht: "5. Per te provuar kapacitetet le/mike dhe profesionale, autoriteti koniraktor kerkon: a) licencat profesionale per realizimin e sherbimeve, objekt i kontrates, te leshuara nga autoritetet kompetente shteterore; dhe/ose b) nje liste te personelit kryesor, te nevojshem per te zbatuar objektin e prokurimit dhelose komponentet e saj. Lista e personelit kryesor duhet le perfshije CV-te e tyre dhe licencat profesionale, kur kane te tilla.dhe/ose c) deshmi per fuqine punetore te operatorit ekonomik te*

*nevojshem per ekzekutimin e objektit te prokurimit.dhe/ose c) deshmi per mjetet dhe pajisjet teknike qe ka ne dispozicion apo qe mund t 'i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik per te permbushur kontraten.*

*Sa me siper analizuar, gjykojmë se autoriteti kontraktor eshte organi pergjegjes per prokurimin e fondeve publike, ne perputhje me dispozitat ligjore e nenligjore ne fuqi. Ne kete kuader, percaktimi i kritereve te vecanta per kualifikim eshte lene nen pergjegjesine e autoritetit kontraktor, gjithnje ne perputhje e perpjesetim me objektin e natyren e kontrates objekt prokurimi. Në kete rast, autoriteti kontraktor ne kerkesen e tij duhet te jete i pojisur me autorizim e leje per perdorimin e burimeve ujore, per efekt te perdorimit te ujit .... ", nuk ka percaktuar dokumentacionin konkret qe duhet te paraqese operatori ekonomik ne perrnbushje te kriterit te mesiperm, pasi percaktimi i tille eshte i paqarte dhe nuk krijon nje panorame te qarte per autoritetin kontraktor mbi kapacitetet qe disponon nje operator ekonomik. Nje percaktim i tille evaziv le vend per keqinterpretim, pasi nuk eshte shprehur qartesisht se cilin dokument konkret duhet te dorezojne operatoret ekonornike per perrnbushjen e ketij kriteri, duke krijuar keshtu paqartesi si tek operatoret ekonomike gjate pergatitjes se ofertave te tyre ashtu edhe tek komisioni i vleresimit te ofertave gjate shqyrtimit dhe vleresimit te tyre. Si rrjedhojë në kushtet kur nuk kemi një përcaktim të saktë të institucionit përkatës me atë të së cilit autoriteti kontraktor njeh vlefshmërinë e dokumentit atëherë me dokumentacionin e paraqitur OE ankimues plotëson kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor.*

*Sa më sipër arsyeja e pretenduar për skualifikim nuk qëndron.*

*Lidhur me arsyet për skualifikim:*

*Në pikën 3.3.11 të kritereve të veçanta të kualifikimit për lotin 1 është përcaktuar "Shoqëria ofertuese duhet të disponojë dokumentacionin që për realizimin e kësaj kontrate të ketë këto mjete (në pronësi apo me qira). Këto mjete duhet të jenë të pajisur me dokumentacionin sipas legjislacionit në fuqi. Për mjetet me qira duhet të paraqitet dhe kontrata e qirasë dhe më një afat vlefshmërie jo më pak se një vit. Për mjetet që shënohen në regjistrat public duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton regjistrimin e mjetetit (leje qarkullimi), policën e sigurimit, taksat vjetore të mjetit, si dhe lejen e transportit nga bashkia për vete ose për të tretët. Mjetet duhet të paraqitet në formën e një deklarate ku të përcaktohet targa lloji numri i shasisë. Dokumentacioni për të përmbushur këtë kriter i paraqitur prej shoqërisë "Alko Impex General Construksion" për të gjitha mjetet e ngarkuara në SPE dhe të shoqëruar me deklaratën përkatëse , nuk përmban dokumentin për taksat vjetore të mjetit, sikurse përcaktohet në kriterin e kualifikimit për dokumentacionin që duhet të paraqesë.*

*Kjo arsye e pretenduar për skualifikim nuk qëndron. Në asnjë*

*Në ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008 "Për taksat kombëtare" i ndryshuar, neni 4 "Niveli i taksave kombëtare" ë shtë parashikuar:*

*"[...] e ardhura nga taksa për cdo rast mblidhet nga Strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, drejtorisë Rajonale, para kryerjes së kontrllit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit[...]"*

*Ndërsa në Udhëzimin nr. 8/1, datë 15.05.2013 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 26, datë 09.04.2008 "Për taksat kombëtare" i ndryshuar, thuhet:*

*“[….] Pagesa e taksës bëhet brenda afatit të vlefshmërisë, por gjithsesi përpra kryerjes së kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit pronari i mjetit i cili nuk kryen pagesën e kësaj tase Brenda 10 ditëve nga mbarimi i afatit të vlefshmërisë së parashikuar , deyrohet të paguajë një gjobë prej 5% të shumës së detyrimit të papaguar për cdo muaj , por jo më humë se 25% për cdo vit[…]”.*

*Bazuar sa më sipër gjykojmë se OE ankimuesi me dokumentacionin e paraqitur, plotëson kriterin e sipërcituar, pasi përpara se automjeti të kalojë procesin e kontrollit, duhet të jenë paguar taksat vjetore të automjetit.*

*Sa më sipër arsyeja e pretenduar për skualifikim nuk qëndron.*

*Pretendimi i KSHA në rastin konkret është abuziv dhe nxjerr nga kontekti dispozitën përkatëse. Dispozita e sipërpërmendur nuk ka pasuar asnjë ndryshim ligjor e si njehdojë pretendimi i KSHA është i pabazuar në ligj .*

*Lidhur me arsyet për skualifikim:*

*Në pikën 3.3.10 të kritereve të vecanta të kualifikimit për lotin 1 është përcaktuar: “Shoqeria ofertuese duhet te disponoje dokumentacion qe per realizimin e kesaj kontrate te kete keto mjete (ne pronesi ose qira): e. Autofshesa 3 cope (ne pronesi ose me qira) f. Mjet te posacem me goma qe kryen funksionin fshirje dhe larje njekohesisht 1 cope (ne pronesi ose me qira)” Bazuar në dokumentacionin e paraqitur në SPE prej shoqërisë ”ALKO-IMPEX GENERAL CONSTRUCTION” dhe të shoqëruar me deklaratën përkatëse, ka paraqitur mjetet me targa AA198TI, AGMT47, AGMT48 për të përmbushur kriterin 3.3.10.e, si dhe ka paraqitur mjetin me targa AA857XM për të përmbushur kriterin 3.3.10.f. Sikurse u sqarua edhe më sipër për këto mjete nuk ka paraqitur dokumentin për taksat vjetore te mjetit, por nga verifikimet e kryera zyrtarisht në Autoritetet Kontraktore ku ky subjekt ushtron aktivitet të ngjashëm me objektin e prokurimit, rezulton se:*

*Mjeti me targa AA198TI me nr.shasie VF644ACA000013207 i deklaruar si “Autofshesë” në Bashkinë Vlorë, rezulton se është deklaruar për tu përdorur si kamion 7.5 – 18 ton në Bashkinë Kavajë, dhe për tu përdorur si Autobot në Bashkinë Tiranë. Bazuar në korrespodencën e mbajtur me këto institucione rezulton se jo vetëm që ky mjet nuk mund përdoret për realizimin e kontratës në Bashkinë Vlorë, pasi është në shërbim të njëkohshëm në dy Bashki të tjera, por edhe të dhënat për llojin dhe funksionin e mjetit janë kondradiktore, pasi në tre Bashki të ndryshme i njëjti mjet me të njëjtin shasi deklarohet njëkohësisht si autofshesë, si autobot, si kamion transportues.*

*Mjeti me targa AGMT48 me nr.shasie SA92V5CXXA4068157 i deklaruar si “Autofshesë” në Bashkinë Vlorë, rezulton se është deklaruar edhe në Bashkinë Kavajë dhe në Bashkinë Tiranë. Bazuar në korrespodencën e mbajtur me këto institucione rezulton se ky mjet nuk mund përdoret për realizimin e kontratës në Bashkinë Vlorë, pasi është në shërbim të njëkohshëm në dy Bashki të tjera.*

*Mjeti me targa AA857XM me nr.shasie VF644ACA000013903 i deklaruar si “Mjet te posacem me goma qe kryen funksionin fshirje dhe larje njekohesisht” në Bashkinë Vlorë, rezulton se është deklaruar për tu përdorur si kamion 7.5 – 18 ton në Bashkinë Kavajë. Bazuar në korrespodencën e mbajtur me këto institucione rezulton se jo vetëm që ky mjet nuk mund përdoret për realizimin e kontratës në Bashkinë Vlorë, pasi është në shërbim të njëkohshëm edhe në një Bashki tjetër, por edhe të dhënat për llojin dhe funksionin e mjetit janë kondradiktore, pasi në dy Bashki të ndryshme*

*i njëjti mjet me të njëjtin shasi deklarohet njëkohësisht si mjet fshirës dhe si kamion transportues. Për sa më lart, shoqëria "ALKO-IMPEX GENERAL CONSTRUCTION" jo vetëm nuk ka plotësuar kriterin e vecantë të kualifikimit për sasinë dhe llojet e mjeteve, por edhe bazuar në nenin 46/1/b të LPP-së, nuk ka vërtetuar se "zotëron makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës", si dhe bazuar në nenin 53/3 të LPP-së, oferta e paraqitur "nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit".*

*Së pari përsa i përket pretendimit nga ana e autoritetit kontrator për pagimin e taksave vjetore është një argument i mirë trajtuar më sipër.*
*Se dyti, nga ana e autoritetit kontraktor per asnje cast nuk eshte trajtuar apo kerkuar ne DST se mjetet e paraqitura ne momentin e pjesmarrjes ne proceduren e prokurimit nuk jane te angazhuara ne kontrate te tjera. Nese i referohemi DST ne kete eshte kerkuar nga ana e AK:*
*1. Shoqeria ofertuese duh.et te disponoje dokumentacion qe per realizitnin e kesaj kontrate te kete keto mjete (ne pronesi ose qira):*
*- ..... Keto mjete duhet te jene te pajisur me dokumentacion sipas legjislacionit ne fuqi. Per mjetet qe jane me qira duhet te paraqitet edhe kontrata e qirase me nje afat vlefshmerie jo me pak se nje vit. Per mjetet qe shenohen ne regjistra publike duhet te paraqitet dokumenti qe verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), policen e sigurimit, taksat vjetore te mjetit, si dhe lejen e transportit nga bashkia per vete ose të trete.*
*- Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten re verifikoje dhe kontrolloje ne cdo kohe deri ne perfundimin e kontrates mjetet e pajisjet teknike të deklaruara.*
*- Mjetet duhet te paraqiten ne formen e nje deklarate ku te percaktohen targat, lloji, numri i shasise.*
*Ne rast se mjetet jane me kontrata qiraje, afati i tyre duhet te jete minimalisht nje vit nga dita e lidhjes se kontratës*
*Pra nga leximi i kriterit te percaktuar nga AK ne DST ne asnje rast nuk parashikohet apo te nenkupohet se mjetet ne momentin e aplikimit ne proceduren e prokurimit nuk duhet te jene te angazhuara ne kontrata te tjera.*
*Autoriteti kontraktor duhet te beje vleresimin e ofertave mbi bazen e kritereve te percaktuara ne dokumentat e tenderit, duke perjashtuar ketu vleresimin mbi dokumenta shtese te pakerkuara nga autoriteti kontraktor.*
*Ne nenin 53, pika 3 te ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet: "Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.*
*Ne asnje rast autoriteti kontraktor nuk mund te skualifikoje apo te vleresoje nje oferte tej atyre te parashikuara ne DST. Kritetert e parashikuara ne DST jane kufiri maksimal i kritereve te kerkuara nga AK dhe cdo konstatim apo kerkim i AK-se tej atyre te parashikuara ne DST eshte ne kundershtim me ligjin dhe absolutisht i pavlefshern.*
*Gjithashtu, ne SPE, rezulton se OE ankimues ka paraqitur dokumentacion si me poshte:*

*- Deklarate mbi disponueshmerine e mjeteve, ku jane percaktuar mjetet qe do te jene ne dispozicion per kryerjen e ketij sherbimi;*
*- Deklarate mbi mjetet ku percaktohet se autoriteti kontraktor rezervon te drejten per verifikimin fizik.*
*- Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike.*
*Nga verifikimi i dokuemntave të tenderit , rezulton se janë përcaktuar kriteret e përgjithshme dhe kriteret e vecanta për kualifikim, nga ku evidentohet të jetë përcaktuar vetëm kriteri mbi disponimin e mjeteve të cilat duhet të shoqërohet me dokumentacion përkatës dhe në asnjë rast nuk është përcaktuar ndonjë kërkesë në lidhje me angazhimin ose jo të këtyre mjeteve në kontrata të tjera.*
*Autoriteti kontraktor duhet te beje vleresimin e ofertave mbi bazen e kritereve te percaktuara ne dokumentat e tenderit, duke perjashtuar ketu vleresimin mbi dokumenta shtese te pakerkuara nga autoriteti kontraktor,*
III.1.10. Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, parashikohet: "*Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...".*
III.1.11. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi.
Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se një ndër parimet kryesore të përzgjedhjes referuar edhe nenit 2 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, është edhe mosdiskriminimi dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve.
III.1.12. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.
III.1.13. Komisioni i Prokurimit Publik, referuar pretendimit të operatorit ekonomik ankimues se ligji 8934 datë 05.02.2002 "Për mbrotjejn e mjedisit", është shfuqizuar, sqaron se, aktualisht është në fuqi ligji nr. 10431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", i ndryshuar, i cili në nenin 73 përcakton shprehimisht se:
*1. Ligji nr. 8934, datë 5.9.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit", i ndryshuar, shfuqizohet me hyrjen në fuqi të këtij ligji, me përjashtim sa parashikohet në pikat 2 deri në 7 të këtij neni.*
*2. Pa rënë ndesh me nenin 24 të këtij ligji, dispozitat e kreut IV dhe neni 35 i ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit", të ndryshuar, vazhdojnë të kenë efekt për sa i takon Vlerësimit Strategjik Mjedisor deri në çastin e shfuqizimit të tyre me ligj të posaçëm.*

*3. Pa rënë ndesh me nenin 25 të këtij ligji, dispozitat e kreut IV dhe neni 35 i ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit", të ndryshuar, vazhdojnë të kenë efekt për sa i takon vlerësimit të ndikimit në mjedis deri në çastin e shfuqizimit të tyre me ligj të posaçëm.*
*4. Pa rënë ndesh me nenin 29 të këtij ligji, nenet 34, 36-46 dhe 51/1 të ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit", të ndryshuar, për lejen, autorizimin dhe pëlqimin mjedisor, vazhdojnë të kenë efekt deri në çastin e shfuqizimit të tyre me ligj të posaçëm.*
*5. Pa rënë ndesh me nenin 30 të këtij ligji, neni 49 i ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit", të ndryshuar, për parandalimin e aksidenteve industriale, vazhdon të ketë efekt deri në çastin e shfuqizimit të tij me ligj të posaçëm.*
*6. Pa rënë ndesh me nenin 33 të këtij ligji, nenet 20-24 të ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit", të ndryshuar, për menaxhimin e mbetjeve, vazhdojnë të kenë efekt deri në çastin e shfuqizimit të tyre me ligj të posaçëm.*
*7. Pa rënë ndesh me nenin 34 të këtij ligji, nenet 20 dhe 23 të ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit", të ndryshuar, për importimin dhe transitin e lëndëve të rrezikshme, vazhdojnë të kenë efekt deri në çastin e shfuqizimit të tyre me ligj të posaçëm.*
III.1.14. Pra sa më sipër, operatori ekonomik ankimues ka pasur detyrimin për të paraqitur të gjithë dokumentacionin në sistemin e prokurimeve elektronike në përputhje me përcaktimet ligjore si më sipër cituar, si edhe në përputhje me kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor.
Në rastin konkret, referuar pretendimit të ankimuesit se përcaktimi i këtij kriteri është i kundraligjshëm, KPP gjykon se, përsa kohë që baza ligjore si më sipër cituar në lidhje me lejet, licencat, lejet mjedisore etj., nenet përkatëse që bëjnë përcaktimet lidhur me pajisjen e tyre, janë ende në fuqi, ankimuesi duhet të kishte paraqitur në sistemin e prokurimeve elektronike të gjithë dokumentacionin e kërkuar. Në rast se, ankimuesi do të ishte i paqartë për mënyrën e përmbushjes së këtij kriteri, ose do të kishte pretendime për vendosjen e tij, ka pasur në dispozicion të gjithë momentin e duhur procedurial për të ezauruar ankimimin si një të drejtë legjitime të përcaktuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik. Operatori ekonomik ankimues nuk mund të përdorë argumenta për kundërshtimin e skualifikimit të tij duke ngritur pretendime për kriteret, në një fazë që ka të bëjë vetëm me vlerësimin e ofertave të paraqitura në procedurën e prokurimit.
Operatori ekonomik ankimues nuk ka arritur të paraqesë dokumentacionin e kërkuar nga autoriteti kontraktor në lidhje me kriterin për leje të thjeshtë mjedisore duke mos përmbushur kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.
Sqarojmë se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi janë të detyruar të përgatisin ofertat e tyre në përputhje me kriteret dhe kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.
Gjithashtu, bazuar edhe në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, barra e provës për të vërtetuar plotësimin e kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, bie mbi operatorin ekonomik, i cili në rastin konkret ka dështuar ta vërtetojë atë.
Nuk mund të lejohet kualifikimi i një operatori ekonomik në rast se ai ka mungesë dokumentacioni dhe nuk plotëson kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor.
III.1.15. Operatori ekonomik ankimues duhej të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve para hapjes së ofertave.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion.

Në rastin konkret, dokumentacioni i paraqitur nga ana e ankimuesit në këtë procedurë prokurimi, objekt shqyrtimi, nuk është i rregullt dhe për shkak të mangësive që ka nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor.

III.1.16. KPP gjykon se, në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte pretendime në lidhje me kërkesën e mësipërme të autoritetit kontraktor, ka patur në dispozicion momentin procedurial të paraqitjes së ankesës në lidhje me pretendimet e tij parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP, ku parashikohet se *"Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik.*

*Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni".*

Gjithashtu, në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ai mund të paraqiste kërkesë për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave të parashikuar nga neni 42 i LPP-së, ku parashikohet se: *" [...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkese për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave.*

*Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]".*

Rrjedhimisht, sa më sipër argumentuar, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues "Alko Impex General Construction" sh.p.k. nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimuse se arsyeja e skualifikimit "- *Në pikën 3.3.10 të kritereve të vecanta të kualifikimit për lotin 1 është përcaktuar: " Subjekti ofertues duhet te jete i pajisur me autorizim ose leje për përdorimin e burimeve ujore, per efekt te perdorimit te ujit me te cilin do te kryhen sherbimet objekt i ketij prokurimi". Për të përmbushur këtë kriter prej shoqërisë "ALKO-IMPEX GENERAL CONSTRUCTION" është paraqitur*

*• Autorizim nr.239 prot datë 11.11.2019 i lëshuar prej "Ujësjellës Kanalizime Devoll" sh.a ku përcaktohet se autorizon shoqërinë "ALKO-IMPEX GENERAL CONSTRUCTION" për përdorimin e burimeve ujore nën administrimin e e kësaj shoqërie.*

*Ky dokument nuk e plotëson kriterin e kualifikimit për dy arsye pasi së pari burimet ujore të ndërmarrjeve të ujësjellës kanalizime janë të pijshme dhe për pasojë subjekti duhet të tarifohet si për përdorimin e ujit të pijshëm, kurse përdorimi i ujit për shërbimet komunale duhet të kryhet nga burimet ujore sipas VKM nr.662 datë 21.09.2016, së dyti përdorimi i ujit me të cilin do të kryhen shërbimet objekt i këtij prokurimi nevojitet për qytetin e Vlorës, ndërkohë që autorizimi është për Bashkinë Devoll.*

*• Shkresë Kthim përgjigje nr.1505/1 prot datë 11.12.2019 e lëshuar prej Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore ku sqarohet shoqëria ”ALKO-IMPEX GENERAL CONSTRUCTION” se ”pas plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor të përcaktuar në VKM nr.416 datë 13.05.2015 duhet të aplikojë pranë Zyrës së Administrimit të Basenit Ujor përkatës dhe më tej miratohen pranë Këshillit të Basenit Ujor. Lejet apo autorizimet lëshohen për një afat të caktuar kohor, sipas parashikimeve të pikës 5 të VKM nr.416 datë 13.05.2015”. Subjekti ofertues shoqëria ”ALKO-IMPEX GENERAL CONSTRUCTION” nuk rezulton të ketë paraqitur ndonjë dokumentacionin pranë Zyrës së Administrimit të Basenit Ujor sipas sqarimeve në shkresë për tu pajisur me lejë apo autorizim për përdorimin e burimeve ujore. Në bazë të pikës 4/b të VKM nr.416 datë 13.05.2015 ku përcaktohet shprehimisht se ”Lejet dhe autorizimet për përdorimin e ujit shqyrtohen nga Këshilli i Basenit Ujor (KBU), referuar nenit 50, të ligjit nr. 111/2012, i cili merr vendim jo më vonë se 2 (dy) muaj, nga data e paraqitjes së kërkesës”. Kjo procedurë prokurimi ka qenë e publikuar në SPE në datë 30.10.2019 dhe ofertat janë hapur në datë 06.01.2020, cka provon qartë se subjekti ofertues e ka patur kohën e nevojshme për të aplikuar për të përmbushur kriterin e kualifikimit”,* nuk qëndron, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.2.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 8, pika 3.3. Kapaciteti teknik, pika 10, nga ana e autoritetit kontraktor, është përcaktuar kriteri: *"Subjekti ofertues duhet te jete i pajisur me autorizim ose leje për përdorimin e burimeve ujore, per efekt te perdorimit te ujit me te cilin do te kryhen sherbimet objekt i ketij prokurimi".*

III.2.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik ”Alko Impex General Construction” d.sh.h., të ngarkuar në sistemin e prokurimeve elektronike, konstatohet se është paraqitur dokumentacioni i mëposhtëm:

- Autorizim me nr. 239 prot., datë 11.11.2019, lëshuar nga Ujësjellës Kanalizime Devoll sh.a. ku citohet se: ”*Ndërmarrja Ujësjellës Kanalizime Devoll sh.a. me administrator....., nëpërmjet këtij dokumenti, autorizon shoqërinë ”Alko Impex General Construction” për përdorimin e burimeve ujore nën administrimin e Ndërmarrjes Ujësjellës Kanalizime Devoll, për shkak të veprimtarisë së tij".*
- Shkresa me nr. 1505/1 prot., datë 11.12.2019, lëshuar nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, ku sqarohet se: ”*Organet e administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore (Këshilli Kombëtar i Ujit dhe Këshillat e Baseneve Ujore) miratojnë leje apo autorizime në përputhje me ligjin 111/2012 ”Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", i ndryshuar, neni 38, 41, 42, 44, 56, 64, 73, 77, 78 si dhe VKM-në nr. 416, datë 13.5.2015 për ”Miratimin e kushteve të posaçme, dokumentave shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit dhe vendimmarrjes, si dhe formateve të autorizimit dhe lejes për përdorim të burimeve*

*ujore". Subjekti pas plotësimit të gjithë dokumentacionit tekniko – ligjor, të përcaktuar në VKM-në nr. 416, datë 13.5.2015 duhet të aplikojnë pranë Zyrës së Administrimit të Basenit Ujor përkatës dhe më tej miratohen pranë Këshillit të Basenit Ujor. Lejet apo autorizimeve lëshohen për një afat të caktuar kohor, sipas parashikimeve të pikës 5 të VKM-së 416, datë 13.5.2015. Subjektet që do të pajisen me leje apo autorizim për përdorimin e burimit ujor duhet të ushtrojnë veprimtarinë, pas miratimit të saj".*

III.2.3. Operatori ekonomik ankimues në ankesën e paraqitur pretendon se: "*2.Lidhur me arsyen tjetër për skualifikim:*

*Subjekti ofertues duhet te jete i pajisur me autorizim ose leje për përdorimin e burimeve ujore, per efekt te perdorimit te ujit me te cilin do te kryhen sherbimet objekt i ketij prokurimi". Për të përmbushur këtë kriter prej shoqërisë "ALKO-IMPEX GENERAL CONSTRUCTION" është paraqitur Autorizim nr.239 prot datë 11.11.2019 i lëshuar prej "Ujësjellës Kanalizime Devoll" sh.a ku përcaktohet se autorizon shoqërinë "ALKO-IMPEX GENERAL CONSTRUCTION" për përdorimin e burimeve ujore nën administrimin e e kësaj shoqërie. Ky dokument nuk e plotëson kriterin e kualifikimit për dy arsye pasi së pari burimet ujore të ndërmarrjeve të ujësjellës kanalizime janë të pijshme dhe për pasojë subjekti duhet të tarifohet si për përdorimin e ujit të pijshëm, kurse përdorimi i ujit për shërbimet komunale duhet të kryhet nga burimet ujore sipas VKM nr.662 datë 21.09.2016, së dyti përdorimi i ujit me të cilin do të kryhen shërbimet objekt i këtij prokurimi nevojitet për qytetin e Vlorës, ndërkohë që autorizimi është për Bashkinë Devoll.*

*Shkresë Kthim përgjigje nr.1505/1 prot datë 11.12.2019 e lëshuar prej Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore ku sqarohet shoqëria "ALKO-IMPEX GENERAL CONSTRUCTION" se "pas plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor të përcaktuar në VKM nr.416 datë 13.05.2015 duhet të aplikojë pranë Zyrës së Administrimit të Basenit Ujor përkatës dhe më tej miratohen pranë Këshillit të Basenit Ujor. Lejet apo autorizimet lëshohen për një afat të caktuar kohor, sipas parashikimeve të pikës 5 të VKM nr.416 datë 13.05.2015". Subjekti ofertues shoqëria "ALKO-IMPEX GENERAL CONSTRUCTION" nuk rezulton të ketë paraqitur ndonjë dokumentacionin pranë Zyrës së Administrimit të Basenit Ujor sipas sqarimeve në shkresë për tu pajisur me lejë apo autorizim për përdorimin e burimeve ujore. Në bazë të pikës 4/b të VKM nr.416 datë 13.05.2015 ku përcaktohet shprehimisht se "Lejet dhe autorizimet për përdorimin e ujit shqyrtohen nga Këshilli i Basenit Ujor (KBU), referuar nenit 50, të ligjit nr. 111/2012, i cili merr vendim jo më vonë se 2 (dy) muaj, nga data e paraqitjes së kërkesës". Kjo procedurë prokurimi ka qenë e publikuar në SPE në datë 30.10.2019 dhe ofertat janë hapur në datë 06.01.2020, cka provon qartë se subjekti ofertues e ka patur kohën e nevojshme për të aplikuar për të përmbushur kriterin e kualifikimit.*

*Nga autoriteti Kontraktor ne DST eshte kerkuar:*

*Subjekti ofertues duhet te jete i pajisur me autorizim e leje perperdorimin e burimeve ujore, per efekt te perdorimit te ujit me te cilin do le kryhen sherbimet objekt i ketij prokurimi*

*Nga ana e OE ankimues ne SPE eshte paraqitur dokumenti i emertuar: Autorizim*

*Në brendësi të këtij dokumenti gjenden:*

1. *Autorizim lëshuar nga Ujësjellës Kanalizime Devoll sha Nr. 239prot. datë 11.11.2019*
2. *Shkesë "Kthim përgjigje" lëshuar nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore Nr. 1505.1prot datë 11.12.2019.*

*Ne autorizimin e leshuar nga Ujesjelles Kanalizme Devoll sha eshte autorizuar shoqeria ALKO IMPEXGENERAL CONSTRUCTION dshh, per perdorimin e burimeve Ujore nën administratimin e Nderrnarrjes Ujesjelles Kanalizimeve Devoll shaper shkak te veprimtarisë së tij.*
*Autoriteti juaj pretendon se ky dokument nuk eshte i vlefshem pasi se pari shoqeria jone duhet se pari burimet ujore te ndermarrjes te ujsjelles kanalizimeve jane te pijshme dhe per pasoje subjekti duhet te tarifohet si per perdorimin e ujit të pijshem kurse perdorimimi i ujit per sherbime komunale duhet te kryhet nga burimet ujore sipas VK.M-se Nr. 662, dale 21. 09. 2016,*
*Se dyti perdorimi i ujit me te cilin do le kryhen sherbimet objeki i ketij prokurimi nevojitet per qytetin e Vlores, nderkohe qe autorizimi eshte per Bashkine Devoll.*
*Të dy këto pretendime janë sa të pavërteta aq dhe në kundështim me ligjin. Fillimisht sqarojmë se institucioni juaj e aq më pak Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nuk ka tagrat e duhura për të vlerësuar apo zhvleftësuar ligjshëmrinë e këtij dokumenti. Ai rezulton të jetë lëshuar nga organ i pavarur dhe dokumentat e lëshuara pej tij janë të vlefshme deri në shfuqizimin e tyre nga gjykata kompetente apo mënyra të tjera të parashikuaranë Kodin e Procedurës Administrative.*
*Së dyti tarifimi shoqërisë në lidhje me Ujin është një problematikë që nuk hyn në Juridiksionin apo kompetencës tuaj. Për Autoritetin Kontraktorv është e vlefshme që OE pjesmarrës të provojë se zotëron apo do të zotërojë kapacitete e duhura për realizimin me sukses të kontratës.*
*Së treti në asnjë fjalë të autorizimit, ndryshe nga sa KVO në mënyrë abuzive citon, nuk përmendet fakti se ky autorizim është i vlefshëm vetëm në qytetin e Devollit.*
*Së katërti tarifi dhe kosto e përballit të mbushjes së Ujit në Devoll dhe larja e qytetit në Vlorë është një risk i subjektit pjesmarrës dhe mbetet në diskrecionin e tij vleësimi i mundshëm i këtyre mundësive.*
*Së pesti në kërkesën e autoritetit kontraktor në Dst nuk specifikohet organi apo cili tip leje do të konsiderohet i vlefshëm apo jo për përmbushjen e kriterit të sipërcituar.*
*Nga verifikimi i dokumentave të tenderit, rezulton se janë përcaktuar kriteret e përgjithshme dhe kriteret e veçanta për kuaifikim , nga ku evidentohet të jetë përcaktuar vetëm kriteri që akt kërkohet një dokument (leje ose autorizim për përdorim të burimit ujor) dhe në asnjë rast nuk është përcaktuar ndonjë kërkesë në lidhje me faktin se kush është organ ii vetëm kompetentë apo që KVO vlerëson sit ë domosdoshëm për plotësimin e kriterit.*
*Në rastin konkret nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, rezulton se nga autoriteti kontraktor nuk është përcaktuar apo vendosur ndonjë kërkesë specifike në lidhje me autorizimin apo lejen, por është kërkuar thjesht paraqitja e këtij dokumenti pa ndonjë përcaktim tjetër të veçantëapo specific ndaj arsyeja e skualifikimit të dhënë nga ana e AK-së nuk qëndron, dhe një kriter i pakërkuar në dokumentat e tenderit nuk duhet të përbëjë shkak për skualifikim.*
*Autoriteti kontraktor duhet të bëjë vlerësimin e ofertave mbi bazën e kritereve të përcaktuara në dokumentat e tenderit, duke përjashtuar këtu vlerësimin mbi dokumenta shtesë të pakërkuara nga autoriteti kontraktor, të cilat për më tepër janë paraqitur nga OE nkimues.*

*Për pasojë, operatorët ekonomikë pjesmarrës në nëjë procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosuara në dokumentat e tenderit e, rrjedhimisht vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.*

*Në rastin konkret, kur oferta e paraqitur është me çmim më të ulët dhe me leverdi ekonomike, duke kursyer buxhetin e shtetit në një vlerë të konsiderueshme autoriteti kontraktor nuk mund të skualifikojë OE ankimues duke kryer vetëm një vlerësim sipërfaqësordhe tendecioz. Ndaj OE ankimues.*

*Gjithashtu nga ana tjetër oe ankimues ka nënshkruar deklaratën e përmbushjes së specifikimeve teknike, ku deklaron plotësimin e të gjitha specifikimeve teknike, duke marrë përsipër nën përgjegjësinë e tij përmbushjen e këtyre të fundit, ka nënshkruar një sërë deklaratash , ku deklaron se përmbush të gjitha kriteret e kërkuara nga AK.*

*Sa më sipër autoriteti kontraktor duhet të udhëhiqet nga parimi i mirëpërdorimit të fondeve publike dhe përfitimi i një produkti me cilësi të mirë dhe me çmim më të ulët, si dhe nuk duhet të gjykojë në mënyrë sipërfaqësoree formale, aq më tepër në kushte kur kemi një përcaktim të qartë të kritereve dhe dokumentacionit që duhet të paraqitet, dokumentacion ky i cili provohet më së miri se operatori ekonomik ankimues e disponon.*

*Gjithashtu në bazë të nenit 62 "Detyrimet gjatë zbatimit të kontratës" të LPP-së, autoriteti kontraktor ka një rol të posaçëm, për vet cilësimin ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin me sukses të kontratës. Rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për tu siguruar nëse cilësia e mallit/shërbimit do të jetë e njëjtë me cilësinë dhe specifikimet teknike të premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë. Në këtë rast të shkeljes së kushteve të kërkuara, autoriteti kontraktor zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë, apo detyrimet, në mbështetje të nenit 62 të LPP-së, si më sipër cituar.*

*Së gjashtiAgjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, është organi më i lartë në fushën e menaxhimit të burimeve ujore. Ndërmjet shkresës së saj Nr. 1505.1prot, datë 11.12.2019 ka theksuar se subjektet që do të pajisen me leje apo autorizim për përdorimin e burimit ujorduhet të ushtrojnë veprimtarinë pas miratimit të saj. Pra, kushti për pajisjen me leje për përdorim të burimit ujor ndodh pas miratimit të veprimtarisë, më konkretisht pas lidhjes së kontratës administrative të rast të shpalljes fitues të kësaj procedure prokurimi.*

*Referuar ligjit nr. 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore" në asnjë dispozitë të saj nuk parashikohet marrja apo shfrytëzimi i këtyre burimeve ujore sipas pretendimeve të ngritura nga ana e Autoritetit Kontraktor. Edhe nëse i referohemi VKM-së nr. 416 datë 13.05.2015 "Për miratimin e kushteve të posaçme, dokumentet sghoqëruese, afatit të vlefshmërisë. Formularëve të Aplikimit për autorizim dhe leje, proçedurave të shqyrtimit e vendimarrjes dhe fomateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore" qartësisht kuptohet seautorizimi për marrjen e një leje apo autorizim të posaçëm që lidhet me ujin që do të shërbejë enkas për shërbimin e pastrimit të qytetit Vlorë, kryhet vetëm pas miratimit të kontratës (thënë ndryshe shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës përkatëse).*

*Edhe në këtë rast, ky kiter ka shërbyer për favorizimin e shoqërisë DUKA shpk. Në kushtet kur kjo shoqëri është dhe shoqëria që ka ushtruar dhe ka akoma në administrim shërbimin e pastrimit të Qytetit Vlorë, mbetet i vetmi subject juridik i mundshëm i cili të disponpremia një dokument ekzaktësisht sipas pretendimeve tuaja. Dokumentat e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit Publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesmarrjen dhe konkurrencën e opeartorëve keonomikë, të stimulojnë pjesmarrjen e biznesit të*

*vogël e të mesëmsi dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të të gjithë operatorët ekonomikë pjesmarrës në këto procedura, për realizimin me sukses t kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesmarrjes së operatorëve ekonomikë në respect të nenit 1 pika2të LPP-së i cili parashikon shprehimisht:*

*1. Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave që zbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve nga autoritetet kontraktore.*

*2. Qëllimi i këtij ligji është:*

*a) të rrisë efiçencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore;*

*b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*

*c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*

*ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*

*d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*

*Përsa i përket pretendimit të KSHA se në kushtet kur shërbimi i larjes dhe lagies në periudha të caktuara janë parashikuar për tu kryer përditë ose dy herë në ditë dhe pretendimi se rritja e kostos janë risk i subjketit pjesmarrës, janë pretendime që bazuar në nenin 45/1/b të LPP• së ulin besimin e Autoritetit Kontraktor..., sqarojmë se autoriteti kontratkor nuk mund të vlerësojë në mënyrë sipërfaqësore e formale por duhet të vlerësojë me objektivitet sidomos në kushtet kur kemi një ofertë ekonomike me leverdi për buxhetin e shtetit.*

*Ne nenin 46, pika 1, germa "c" te ligjit nr.9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: "Operatoret ekonomike, per te marre pjese ne procedurat e prokurimit, duhet te kualifikohen, pasi te kene permbushur te gjitha kriteret qe autoriteti kontraktor i vlereson te nevojshme, per sa kohe qe ato jane ne perpjestim me natyren dhe permasat e kontrates qe do te prokurohen dhe jodiskriminuese";*

*Kriteret e kualifikimit duhet te jene te qarta, te sakta dhe te rnirepercaktuara nga autoriteti kontraktor me qellim qe te jene sa me te kuptueshme jo vetem per operatoret ekonornike te interesuar per te gene pjesernarres, komisionin e vleresimit te ofertave ne menyre te tille qeprocesi i vlerësimit të mos kryhet me subjektivizëm, por të vendosë në situatë të barabartë edhe per personat me aftesi te kufizuar, duke mos penguar keshtu pjesemarrjen ne nje procedure prokurimi.*

*Ne piken 3 te nenit 27 te VKM nr. 914, date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar, eshte percaktuar: "Kerkesat e vecanta te kualifikimit duhet te perfshijne te gjitha kriteret specifike ne perputhje me nenin 46 te LPP. Kriteret duhet te Jene ne perpjesetim dhe le lidhura ngushte me aftesine zbatuese, natyren dhe vleren e kontrates. Ne cdo rast, autoriteti kontrakiues duhet te percaktoje dokumentet konkrete qe duhet te paraqesin opera tore! ekonomike per permbushjen e ketyre kritereve",*

*Ne piken 5 te nenit 28 te VKM-së nr. 914 date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar, percaktohet shprehimisht: "5. Per te provuar kapacitetet le/mike dhe profesionale, autoriteti koniraktor kerkon: a) licencat profesionale per realizimin e sherbimeve, objekt i kontrates, te leshuara nga autoritetet kompetente shteterore; dhe/ose b) nje liste te personelit kryesor, te nevojshem per te zbatuar objektin e prokurimit dhelose komponentet e saj. Lista e personelit kryesor duhet le perfshije CV-te e tyre dhe licencat*

*profesionale, kur kane te tilla.dhe/ose c) deshmi per fuqine punetore te operatorit ekonomik te nevojshem per ekzekutimin e objektit te prokurimit.dhe/ose c) deshmi per mjetet dhe pajisjet teknike qe ka ne dispozicion apo qe mund t 'i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik per te permbushur kontraten.*

*Sa me siper analizuar, gjykojmë se autoriteti kontraktor eshte organi pergjegjes per prokurimin e fondeve publike, ne perputhje me dispozitat ligjore e nenligjore ne fuqi. Ne kete kuader, percaktimi i kritereve te vecanta per kualifikim eshte lene nen pergjegjesine e autoritetit kontraktor, gjithnje ne perputhje e perpjesetim me objektin e natyren e kontrates objekt prokurimi. Në kete rast, autoriteti kontraktor ne kerkesen e tij duhet te jete i pojisur me autorizim e leje per perdorimin e burimeve ujore, per efekt te perdorimit te ujit .... ", nuk ka percaktuar dokumentacionin konkret qe duhet te paraqese operatori ekonomik ne perrnbushje te kriterit te mesiperm, pasi percaktimi i tille eshte i paqarte dhe nuk krijon nje panorame te qarte per autoritetin kontraktor mbi kapacitetet qe disponon nje operator ekonomik. Nje percaktim i tille evaziv le vend per keqinterpretim, pasi nuk eshte shprehur qartesisht se cilin dokument konkret duhet te dorezojne operatoret ekonornike per perrnbushjen e ketij kriteri, duke krijuar keshtu paqartesi si tek operatoret ekonomike gjate pergatitjes se ofertave te tyre ashtu edhe tek komisioni i vleresimit te ofertave gjate shqyrtimit dhe vleresimit te tyre. Si rrjedhojë në kushtet kur nuk kemi një përcaktim të saktë të institucionit përkatës me atë të së cilit autoriteti kontraktor njeh vlefshmërinë e dokumentit atëherë me dokumentacionin e paraqitur OE ankimues plotëson kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor.*

*Sa më sipër arsyeja e pretenduar për skualifikim nuk qëndron.*

III.2.4. Autoriteti kontraktor në dokumentacionin dhe informacionin e depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, ndër të tjera argumenton: *"[...]*

*2. Ne ankese ne faqen 10 - 13 jane paraqitur argumentat ne lidhje me piken e dyte te skualifikimit, ku krahas te tjerave jane ngritur pretendimet:*

*Se pari KVO nuk ka tagrat e duhur per te vleresuar apo zhvleftesuar ligjshmerine e dokumentit .*

*Se dyti, tarifimi i shoqerise ne lidhje me ujin eshte nje problematike qe nuk hyn ne juridisksionin apo kompetencen tuaj. Per autoritetin kontraktor eshte e vlefshme qe OE pjesemarres te provoje se zoteron kapacitetet e duhura per realizimin me sukses te kontrates.*

*Se treti, ne asnje jjale ne autorizimin, ndryshe nga sa KVO ne menyre abuzive citon, nuk permendet fakti se ky autorizim eshte i vlefshem vetem per qytetin e Devollit.*

*Se katerti, tarifa dhe kosto e perballimit te mbushjes se Ujit ne Devoll dhe larja e qytetit ne Vlore eshte nje risk i subjektit pjesemarres dhe mbetet ne diskrecionin e tij vleresimi i mundshem i ketyre mundesive.*

*Se pesti, ne kerkesen e autoritetit kontraktor ne dst nuk specifikohet organi apo cili tip leje do te konsiderohet i vlefshem apo jo per permbushjen e kriterit te sipercituar.*

*Se gjashti, Agjencia e Menaxhimit te Burimeve Ujore, eshte organi me i larte ne fushen e menaxhimit te burimit te ujore. Nepermjet shkreses se saj nr.15 05/ 1 prot date 11.12.2019 ka theksuar se subjektet qe do te pajisen me leje apo autorizim per perdorimin e burimit ujor duhet te ushtrojne veprimtarine pas miratimit te tij.*

*Nga shqyrtimi i ketij pretendimi, KSHA eshte njohur me kopje te dokumentave standarte te tenderit, si dhe dokumentacionin e paraqitur nga shoqeria ankimuese. Ne piken 3.3.10 te kritereve te vecanta te kualifikimit per lotin 1 eshte percaktuar:*

*"Subjekti ofertues duhet te jete i pajisur me autorizim ose leje per perdorimin e burimeve ujore, per efekt te perdorimit te ujit me te cilin do te kryhen sherbimet objekt i ketij prokurimi".*
*Per te plotesuar kete kriter, prej shoqerise "Aiko - Impex General Construction" eshte paraqitur:*
*a. Autorizim nr.239 prot date 11.11.2019 i leshuar prej "Ujesjelles Kanalizime Devoll" sh.a ku percaktohet se autorizon shoqerine "Aiko - Impex General Construction" per perdorimin e burimeve ujore nen administrimin e kesaj shoqerie,*
*b. Shkrese Kthim pergjigje nr.1505/1 prot date 11.12.2019 e leshuar prej Agjencise se Menaxhimit te Burimeve Ujore.*
*Pretendimet e ngritura ne ankese, nuk qendrojne dhe jane te pabazuara ne dokumentacionin e paraqitur dhe legjislacionin ne fuqi.*
*Ne lidhje me pretendimet e ngritura ne pikat 1-4 (per shkakun e dyte te skualifikimit) vlen per tu sqaruar, se KVO nuk ka zhvleftesuar ligjshmërinë e ketyre dokumenteve, por ka gjykuar mbi përmbajtjen e tyre. Përdorimi i ujit per sherbimet komunale duhet te kryhet nga burimet ujore sipas VKM nr.662 date 21.09.2016 "Per miratimin e tarifave te perdorimit te ujit dhe te shkarkimeve te Iengeta", kurse lejimi/autorizimi per perdorimin e ketyre burimeve miratohet ne baze te ligjin nr. 111/2012 "Per menaxhimin e integruar te burimeve ujore" dhe akteve nenligjore te nxjerra ne zbatim te tij. Ndernarrjet e Ujesjelles Kanalizimeve per perdorirnin e burimeve ujore, pajisen per veten e tyre me leje dhe licence nga autoritetet perkatese, por nuk kane asnje tager te pajisin te trete per perdorimin e burimeve ujore per kryerjen e sherbimeve kornunale, pasi kjo eshte kornpetence e Zyres se Administrimit te Basenit Ujor perkates. Konkretisht nga verifikimet e kryera ne faqen http://ëëë.erru.al/doc/Vendiim _51_2017 UK Devoll.pdf eshte e publikuar licenca e kesaj shoqerie [...]*
*Ne perrnbajtjen e kesaj licence percaktohet qartazi se Operatori Sh.a Ujesjelles Kanalizime Devoll autorizohet te kryeje veprimtarinë perkatese te kualifikuar ne kategorine: Kategoria A, per grumbullimin dhe shperndarjen e ujit per konsum publik; Kategoria C, per largimin e ujerave te ndotura. Ky argumentim tregon qarte se Sh.a Ujesjelles Kanalizime Devoll nuk mund te autorizoje persona te trete per perdorirnin e burimeve ujore, kur nuk e ka vete kete kompetence dhe nuk eshte e licencuar per te kryer veprime te tilla.*

*Ne rastin konkret ngritja e pretendimeve te natyres qe "botet do furnizohen me uje ne Devoll dhe do vijne te kryejne sherbim ne Vlore", ne kushtet kur sherbimet e larjes dhe lagies ne periudha te caktuara, jane parashikuar per tu kryer perdite ose dy here ne dite, apo pretendimi se "rritja e kostos eshte risk; subjektit pjesemarres", jane pretendime qe bazuar ne nenin 46/1/b te LPP-se, ulin besimin e Autoritetit Kontraktor mbi reputacionin dhe besueshmerine, per te zbatuar kontraten, siç eshte pershkruar nga autoriteti kontraktor ne njoftimin e objektit te kontrates", pasi jane pretendime krejt te pabazuara ne jo vetem persa eshte argumentuar me siper, por edhe per shkak te realizimit te detyrimeve nga pikepamja faktike. Ne lidhje me pretendimet e ngritura ne piken e peste (per shkakun e dyte te skualifikimit) vlen per te sqaruar operatorin ekonomik ankimues se nga shqyrtimi kritereve te kualifikirnit per lotin e pare, nuk rezulton te jene percaktuar institucionet qe leshojne dokumentet, por ne baze te legjislacionit ne fuqi, operatoret ekonomikë, plotesojne dokumentacionin e kerkuar, Konkretisht ne piken 3.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar, percaktohet se operatori duhet te paraqese*
*a. Kopje te vertetuar te bilancit, te viteve 2017 - 2018 te konfirmuar prane autoriteteve perkatese.*

*b. Kopje te deklarimit te xhiros vjetore per vitet 2017 - 2018.*
*Ne pikat a) dhe b) te ketij kriteri kualifikimit, nuk percaktohet autoriteti qe miraton apo konfirmon bi lancet, apo qe leshon deklarimet e xhiros, por eshte evidente se ne baze te legjislacionit ne fuqi, qe presupozohet se njihet edhe prej operatori ekonomik, keto dokumente leshohen prej Degeve Rajonale te Tatimeve, ashtu sikurse eshte paraqitur i plote edhe i rregullt nga shoqeria ankimuese.*
*I njejti arsyetim vlen edhe per piken c) ku nuk eshte percaktuar termi "ne cdo vend te ushtrimit te aktivitetit", pasi ne vaze te legjislacionit ne fuqi, pagimi i taksave vendore nuk nenkupton pagesen pjeserisht te tyre, por pagesen e plote ne cdo vend te ushtrimit te aktivitetit, sikurse eshte vepruar edhe prej operatorit ekonomik ne rastin konkret dhe eshte konsideruar i plote prej KVO.*
*Ndodhur ne keto kushte edhe per kriterin e kualifikimit te percaktuar ne piken 3.3.10 te kritereve te vecanta te kualifikimit per lotin 1, percaktohet qartesisht dokumentacioni qe kerkohet per permbushjen e kriterit, por eshte legjislacioni qe e percakton se kush jane autoritetet qe leshojne keto dokumenta. Per me teper ne shkresen nr. nr.1505/1 prot date 11.12.2019 e leshuar prej Agjencise se Menaxhimit te Burimeve Ujore, eshte sqaruar qartesisht se kush jane autoritetet e autorizuara me akte ligjore e nenligjore per leshirnin e ketij dokumentacioni. Pervec kesaj, operatori ekonomik i ka patur te gjitha mundesite dhe kohen e nevojshme per te kerkuar sqarime prane Autoritetit Kontraktor per kete kerkese apo te tjera, sikurse percaktohet ne nenin 42 te ligjit nr.9643/2006 "Per Prokurimin Publik".*
*Ne ligjin nr. 111/2012 "Per menaxhimin e integruar te burimeve ujore", i ndryshuar, neni 50 pika5 percakton se :*
*5. Autorizimet, lejet dhe koncesionet per perdorimin e ujerave:*
*a) jane personale dhe i takojne titullarit te licences, autorizimit, lejes, koncesionit perkates;*
*b) nuk mund te transferohenpa miratimine organevete administrimidt he menaxhimitte burimeve*
*c) Jane te vlefshme per nje afat te caktuar dhe rinovohen sipas rye procedure te percaktuar;*
*c) mund te ndryshohen, te refuzohen, te pezullohen ose te shfuqizohen ne haze te ketij ligji dhe akteve nenligjore ne zbatim te tij;*
*d) leshohen pas pagimit te nje tarife per shpenzimet administrative;*
*dh) regjistrohen ne Regjistrin Kombetar te LeJeve dhe Autorizimeve, sipas parashikimeve ligjore e nenligjore perkatese;*
*e) nuk mund te refuzohenpa nje vendim te arsyetuarte organlt administrativ qe shqyrton kerkesen per autorizim ose leje.*
*Ne VKM nr. 416, date 13.5.2015 percaktohen kushteve te pergjithshrne e te posacme, dokumenteve shoqeruese, afatit te vlefshmerise, formulareve te aplikimit per autorizim dhe leje, procedurave te shqyrtirnit e vendimmarrjes dhe formateve te autorizimit e lejes per perdorim te burimeve ujore.*
*Keto dispozita ligjore e nenligjore detyrojne cdo subjekt qe te mos perdore ujin e pijshem per qellime publike, si lagie e larje te rrugeve, shesheve e trotuareve, por te perdore burimet e tjera ujore.*
*Keto argumenta rrezojne lehtesisht pretendimin e ngritur ne piken e peste (per shkakun e dyte te skualifikimit) ne ankese se ne kerkesen e autoritetit kontraktor ne dst nuk specifikohet organi apo cili tip leje do te konsiderohet i vlefshem apo jo per permbushjen e kriterit te sipercituar.*
*Ne lidhje me pretendimet e ngritura ne piken e gjashte (per shkakun e dyte te skualifikimit) vlen per tu sqaruar se ne shkresen kthim pergjigje nr.1505/1 prot date 11.12.2019 e leshuar prej*

*Agjencise se Menaxhirnit te Burimeve Ujore, sqarohet qartesisht shoqeria "Aiko - Impex General Construction" se "pas plotesimit te dokumentacionit tekniko-ligjor te percaktuar ne VKM nr. 416 date 13.05.2015 duhet te aplikoje prane Zyres se Administrimit te Basenit Ujor perkates dhe me tej miratohen prane Keshillit te Basenit Ujor. Lejet apo autorizimet leshohen per nje afat te caktuar kohor, sipas parashikimeve te pikes 5 te VKM nr.416 date 13.05.2015".*
*Ne fund te shkreses shkruhet nje fjali se "Subjektet qe pajisen me autorizim per perdorimin e burimit ujor duhet te ushtrojne veprimtarine, pas miratimit te saj". Kjo fjali rrezon krejtesisht vertetimin e leshuar prej Nderrnarrjes se Ujesjelles Kanalizimeve Devoll ku lejon nje subjekt privat (shoqerine "Aiko - Impex General Construction") per perdorirnin e burimeve ujore, nderkohe qe ky subjekt duhet ta ushtroje veprirntarine per perdorirnin e ketyre burimeve pas pajisjes me autorizim nga Zyra se Administrimit te Basenit Ujor perkates.*
*Shkresa kthim pergjigje nr.1505/1 prot date 11.12.2019 e leshuar prej Agjencise se Menaxhimit te Burimeve Ujore, nuk eshte nje akt administrativ qe sjell pasoja juridike, por eshte nje kthim pergjigje i zakonshem, gjate ushtrimit te veprirntarise se perditshme te administrates publike, i nje kerkese qe nuk kemi dijeni se cfare i eshte kerkuar. Sidoqofte ne rast se shoqeria ankimuese ka pretendime ne lidhje me ligjshmerine e ketij kriteri, i ka patur te gjitha mundesite dhe afatet e nevojshme per te bere kundershtirnin e tij, ne rast te kundert ka gene i detyruar ta plotesoje ate sikurse percaktohet ne kriteret e kualifikimit. Pretendimet e ngritura ne fillim te faqes 13 te ankeses, nuk mund te ngrihen ne kete faze te procedures se prokurimit. Ne permbledhje per sa eshte sqaruar me lart, ne kriterin e kualifikimit eshte e percaktuar qarte se subjekti duhet të disponoje autorizim ose leje per perdorirnin e burimeve ujore, per te realizuar sherbimet objekt te kesaj kontrate. Prej operatorit ofertues nuk eshte bere asnje perpjekje per sigurimin e ketij dokumentacioni, edhe pse i ka patur mundesite dhe kohen e mjaftueshme per ta siguruar kete dokument. Ne baze te pikes 4/b te VKM nr.416 date 13.05.2015 ku percaktohet shprehimisht se "Lejet dhe autorizimet per perdorimin e ujit shqyrtohen nga Keshilli i Basenit Ujor (KBU), referuar nenit 50, te ligjit nr. 111/2012, i cili merr vendim jo me vone se 2 (dy) muaj, nga data e paraqitjes se kerkeses". Kjo procedure prokurimi ka qene e publikuar ne SPE ne date 30.10.2019 dhe ofertat jane hapur ne date 06.01.2020, cka provon qarte se subjekti ofertues e ka patur kohen e nevojshme per të aplikuar per te permbushur kriterin e kualifikimit. Ne lidhje me aludimet e ngritura ne ankese se ky kriter eshte vendosur per favorizimin e shoqerise "DUKA", sqarojme se kjo shoqeri eshte pajisur me kete dokumentacion pas publikimit te njoftimit te kontrates, ashtu sikurse mund te pajisjej edhe cdo subjekt tjeter qe do te ishte seriozisht i interesuar per plotesimin e ketij dokumentacioni dhe jo te ngreje pretendime qe nuk tregojne aspak seriozisht per kryerjen e sherbimit. Ritheksojme se lejet dhe autorizimet per perdorimin e ujit shqyrtohen nga Keshilli i Basenit Ujor (KBU), i cili merr vendim jo me vone se 2 (dy) muaj, nga data e paraqitjes se kerkeses.*
*Ne lidhje me kete shkak skualifikimi, konstatojme se vendimi i KVO eshte i drejte, pasi operatori ekonomik i ka patur te gjitha mundesite ligjore per te kundershtuar dokumentet e tenderit, ose te kerkonte sqarime prane Autoritetit Kontraktor. Operatori ekonomik nuk ka plotesuar dokumentacionin ne perputhje me kriteret e vecanta te kualifikimit.*

III.2.5. Në nenin 28, pika 5, gërma “a” të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për Rregullat e Prokurimit Publik”,* i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*"Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore".*

III.2.6. Në nenin 46, pika 1, gërma "b" të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: "*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese".*

III.2.7. Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, parashikohet: "*Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...".*

III.2.8. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi.

Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se një ndër parimet kryesore të përzgjedhjes referuar edhe nenit 2 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar është edhe mosdiskriminimi dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve.

III.2.9. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapacitetetеve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.2.10. Komisioni i Prokurimit Publik, referuar dokumentacionit të paraqitur konstaton se, operatori ekonomik ankimues ka mangësi në plotësimin e tyre sipas kritereve të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit ka përcaktuar kriterin që duhet të plotësohet nga operatorët ekonomikë dhe këta të fundit duhet të përmbushin këto kritere me qëllim kualifikimin në një procedurë prokurimi. Konkretisht, në kushtet kur operatori ekonomik kundërshton kriterin e hartuar, sqarojmë se, ky pretendim nuk lidhet me këtë fazë të vlerësimit të ofertave, por me fazën e hartimit të dokumentave të tenderit nga ana e autoritetit kontraktor dhe operatori ekonomik ankimues ka pasur në dispozicion të gjithë kohën e duhur për të ushtruar të drejtën e tij të ankimit në lidhje me këto kritere në respekt të nenit 63 të ligjit për prokurimin publik, si edhe për të ushtruar të drejtën për sqarim bazuar në nenin 42 të ligjit për prokurimin publik.

Referuar pretendimit të ankimuesit se, autoriteti kontraktor nuk e ka përcaktuar në dokumentat e tenderit se kush është autoriteti që e lëshon një dokument të tillë, konstatojmë se me të drejtë autoriteti kontraktor ka argumentuar, se edhe për kritere të tjera të përcaktuara në kapacitetin teknik

të dokumentave të tenderit nuk është përcaktuar institucioni që lëshon aktin, pasi në bazë të legjislacionit në fuqi, operatorët ekonomikë drejtohen në organet përkatëse që operojnë në atë fushë dhe që lëshojnë aktet përkatëse.
Për më tepër, konstatojmë se, referuar dokumentacionit të paraqitur nga vetë ankimuesi në sistemin e prokurimeve elektronike, shkresa me nr. 1505/1 prot., datë 11.12.2019 lëshuar nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, sqaron shumë qartë ankimuesin për mënyrën e pajisjes me një dokument të tillë, si edhe organet që e lëshojnë atë. Gjithashtu, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore sqaron qartësisht se "*Subjektet që do të pajisen me leje apo autorizim për përdorimin e burimit ujor duhet të ushtrojnë veprimtarinë, pas miratimit të saj", (*pra një subjekt pas miratimit të lejes ose autorizimit përkatës duhet të ushtrojë veprimtarinë e tij) pra në çdo rast, leja apo autorizimi është dokumenti që meret detyrimisht që në fazën e parë që përfshin procesin e pajisjes së një shoqërie që do të ushtrojë një veprimtari në këtë fushë.
Nga sa më sipër, konstatojmë se operatori ekonomik ankimues ka qenë i qartë në lidhje me mënyrën e plotësimit të këtij kriteri dhe e ka marrë përgjigjen, siç konstatohet nga shkresa e paraqitur, brenda ditës së protokollimit të saj pranë Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, fakt i cili vërteton më së miri se ankimuesi ka patur në dispozicion të gjithë kohën e mjaftueshme për të paraqitur ankim apo kërkesë për sqarim pranë autoritetit kontraktr në përputhje me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik.
III.2.10. Në nenin 9 të ligjit nr. 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore2", i *ndryshuar, përcaktohet se:*
*1. Këshilli Kombëtar i Ujit është organi qendror vendimmarrës, përgjegjës për administri min e burimeve ujore.*
*2. Këshilli Kombëtar i Ujit është organ ndërministror që kryesohet nga Kryeministri dhe trajton çështjet e administrimit dhe menaxhimit të integruar të burimeve ujore.*
*3. Kompetencat e Këshillit Kombëtar të Ujit janë:*
*a) miraton planet dhe projektet, ndërrajonale dhe kombëtare, në fushën e bujqësisë, urbanistikës, zhvillimit industrial e territorial, kur ato lidhen me ruajtjen dhe menaxhimin e ujërave;*
*b) merr masat e duhura për zbatimin e çdo marrëveshjeje ndërkombëtare, konvente për burimet ujore, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë;*
*c) jep leje dhe autorizime për përdorimin e ujit dhe për shkarkimet, kur veprimtaria kryhet jashtë kufirit të një baseni të vetëm;*
*ç) miraton në parim kërkesën për dhënie koncesioni për burimet ujore për rastet e parashikuara në vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave. Pas lidhjes së kontratës koncesionare, pajis koncesionarin me lejen për përdorimin e burimit ujor, të nënshkruar nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Ujit.*
*Kur këto burime ujore kanë rëndësi kombëtare, sipas përcaktimeve të Këshillit të Ministrave, marrëveshja e koncesionit hyn në fuqi pas ratifikimit nga Kuvendi;*
*d) miraton rregulloren e Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit, të këshillit të basenit ujor dhe të agjencisë së basenit ujor.*

Në nenin 12 të po këtij ligji është përcaktuar:

*"Këshilli i basenit ujor*

*1. Këshilli i basenit ujor është organi përgjegjës për menaxhimin e integruar të burimeve ujore në basenin përkatës, në nivel vendor.*
*2. Këshilli i basenit ujor ka këto detyra:*
*a) siguron ruajtjen dhe zhvillimin sa më racional të burimeve ujore brenda kufijve të basenit përkatës ujor;*
*b) siguron shpërndarjen e drejtë të burimeve ujore brenda kufirit të basenit përkatës ujor, sipas qëllimeve të përdorimit dhe drejtimin e administrimin e efektshëm të tyre;*
*c) siguron mbrojtjen e burimeve ujore nga ndotjet, shpërdorimet dhe dëmtimet që prekin cilësinë dhe sasinë e tyre;*
*ç) identifikon trupat ujorë përkatës që kanë nevojë për mbrojtje.*
*2. Këshilli i basenit ujor ka status juridik publik dhe varet nga Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit.*
*Basenet ujore*
*1. Territori i Republikës së Shqipërisë, për qëllime të menaxhimit të burimeve ujore, ndahet në basene ujore.*
*2. Ujërat nëntokësore, kur nuk ndjekin plotësisht një basen ujor të veçantë, identifikohen dhe i caktohen basenit ujor më të afërt.*
*3. Ujërat bregdetare identifikohen dhe i caktohen basenit ujor më të afërt.*

Neni 38 përcakton se:

*"Burimet ujore përdoren për:*
*a) qëllimet shtëpiake, komunale, bujqësore, përfshirë ujitjen dhe ujin për blegtorinë;*
*b) akuakulturë, transport ujor, industrial, prodhim hidroenergjetik;*
*c) tregti;*
*ç) turizëm, argëtim, përfshirë lundrimin për argëtim;*
*d) qëllime të tjera, të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Ujërave.*

Neni 41 përcakton se:

*Përdorimi me leje i ujit*
*1. Veprimtaritë e mëposhtme, që mund të kryhen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, do të ushtrohen në bazë të lejes administrative të lëshuar nga organet e administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore.*
*a) Përdorimi i ujit, kur ky realizohet me instalime të përhershme.*
*b) Ujitja.*
*c) Përdorime industriale të ujit sipërfaqësor. ç) Ujë për pishina.*
*d) Ujë i ambalazhuar.*
*dh) Ujërat kurative, minerale, termominerale dhe gjeotermale.*
*e) Shfrytëzimi i ujërave nëntokësore për qëllime të ndryshme.*
*ë) Dhënia në përdorim e burimeve ujore për zhvillimin e akuakulturës.*
*2. Për përdorimet e mëposhtme kërkohet leja përkatëse e Këshillit Kombëtar të Ujit.*

*a) Lundrueshmëria.*
*b) Ndërtimi i strukturave ankoruese, portuale, i veprave mbrojtëse bregdetare dhe ishujve artificialë në det.*
*c) Përdorimi i ujërave detare për prodhim hidroenergjie.*
*3. Këshilli i Ministrave, me propozim të Këshillit Kombëtar të Ujit, miraton formularin e kërkesës për leje për përdorim të burimeve ujore.*

Neni 42

*Përdorimi i ujit me autorizim*
*1. Veprimtaritë e mëposhtme mund të kryhen vetëm pasi subjektet përkatëse të pajisen me autorizim nga organet e administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore:*
*a) dhënia e ujit bagëtive, kur shoqërohet me instalime tubacionesh dhe ndërtime objektesh;*
*b) shfrytëzimi i ujërave nëntokësore për qëllime familjare;*
*c) përdorimi ose ripërdorimi i ujërave të përdorura, përfshirë aplikimin e tyre në tokë.*
*2. Përdorimi i burimeve ujore për qëllime dhe aktivitete peshkimi përcaktohet me akte ligjore e nënligjore që rregullojnë këto veprimtari.*
*3. Të gjitha llojet e kërkimeve, studimeve dhe eksplorimeve në ujërat sipërfaqësore e nëntokësore, edhe kur nuk kanë për objekt ujin, kryhen me autorizim nga organet përkatëse të ujit, për një zonë dhe për një afat të caktuar.*
*4. Përjashtohen nga kjo kërkesë institucionet monitoruese të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, si dhe institucionet shkencore, veprimtaritë e të cilave nuk ndikojnë në prishjen e ekuilibrave sasiorë dhe cilësorë të ujërave.*
*5. Këshilli i Ministrave, me propozim të Këshillit Kombëtar të Ujit, miraton formularin e kërkesës për autorizim për përdorim të burimeve ujore.*

Në nenin 50 po këtu është përcaktuar:

*"Organet e administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore që lëshojnë autorizime, leje dhe japin koncesione*
*1. Organet e administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore japin autorizime, leje dhe lidhin kontrata koncesioni për përdorimin e ujërave, duke u bazuar në parimet e proporcionalitetit, efiçencës dhe deburokratizimit, në zvogëlimin e barrierave administrative, si dhe në përputhje me procedurat e përcaktuara me ligj të veçantë ose me vendim të Këshillit të Ministrave, në zbatim të këtij kreu.*
*2. Këshilli i basenit ujor lëshon autorizimet dhe lejet në rastet kur aktiviteti do të kryhet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe brenda kufijve të një baseni të vetëm.*
*3. Këshilli Kombëtar i Ujit lëshon leje dhe autorizime në rastet kur aktiviteti do të kryhet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, por në një zonë që i kalon kufijtë e një baseni.*
*4. Ministria identifikon projektin koncesionar në bazë të klasifikimit të burimeve ujore, planit të menaxhimit të basenit ujor dhe sipas procedurave, kritereve dhe kushteve të përcaktuara me akte ligjore e nënligjore.*
*5. Autorizimet, lejet dhe koncesionet për përdorimin e ujërave:*

*a) janë personale dhe i takojnë titullarit të licencës, autorizimit, lejes, koncesionit përkatës;*
*b) nuk mund të transferohen pa miratimin e organeve të administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore;*
*c) janë të vlefshme për një afat të caktuar dhe rinovohen sipas një procedure të përcaktuar;*
*ç) mund të ndryshohen, të refuzohen, të pezullohen ose të shfuqizohen në bazë të këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij;*
*d) lëshohen pas pagimit të një tarife për shpenzimet administrative;*
*dh) regjistrohen në Regjistrin Kombëtar të Lejeve dhe Autorizimeve, sipas parashikimeve ligjore e nënligjore përkatëse;*
*e) nuk mund të refuzohen pa një vendim të arsyetuar të organit administrativ që shqyrton kërkesën për autorizim ose leje.*
*6. Këshilli i Ministrave, në zbatim të këtij ligji dhe ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, përcakton:*
*a) kushtet e posaçme të licencimit, të autorizimit dhe lejimit dhe dokumentet shoqëruese, të nevojshme, që paraqiten për këtë qëllim;*
*b) afatin e vlefshmërisë së licencës, të autorizimit dhe lejes;*
*c) procedurat dhe afatet e shqyrtimit dhe të vendimmarrjes administrative; ç) procedurat e revokimit nga organet administrative.*

Në nenin 73 përcaktohet se:
*Shkarkimet e lëngshme*
*1. Shkarkimet në ujë, tokë, nëntokë bëhen me leje ose autorizim, të lëshuar nga organet e menaxhimit dhe administrimit të burimeve ujore, në përputhje me legjislacionin në fuqi.*
*2. Këshilli Ministrave, me propozim të ministrit, miraton normat e shkarkimeve të lëngshme dhe kërkesat e përgjithshme e specifike për lloje të ndryshme të veprimtarive, si rezultat i të cilave kryhen shkarkime të lëngshme në mjedis.*
III.2.11. Në rastin konkret sa më sipër analizuar, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur dokumentin e lëshuar nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, nëpërmjet të cilit ka marrë të gjithë informacionin e duhur dhe sqarimet përkatëse se si aplikohet dhe pajiset me lejen/autorizimin për përdorimin e burimeve ujore, si edhe dokumentin e lëshuar nga Ujësjellës – Kanalizime Devoll sh.a. i cili është vetëm një shkresë e thjeshtë dhe nuk rezulton të jetë një dokument i mirëfilltë "Leje për përdorim të burimeve ujore" lëshuar nga organet përkatëse të Këshillit të Basenit Ujor, që, sikurse analizuam më sipër, është përcaktuar në legjislacionin përkatës në fuqi për pajisjen me leje ose autorizime subjektet e ndryshme.
Komisioni i Prokurimit Publik, referuar sa më sipër, sqaron se qëllimi i burimeve ujore për të cilën kërkohet leja apo autorizimi përkatës, përfshin dhe "qëllime të tjera" të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Ujërave, ndërmjet të cilave futet edhe qëllimi i këtij objekti prokurimi, pasi "qëllime të tjera" është një term gjithëpërfshirës ndaj në këtë përcaktim futet edhe objekti i veprimtarisë së procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi.
III.2.12. Referuar legjislacionit si më sipër cituar, si edhe korrespondencës së ankimuesit me Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore, është përcaktuar qartësisht mënyra e aplikimit dhe organet përkatëse me anë të së cilës një operator ekonomik mund të pajiset me lejen e kërkuar në

dokumentat e tenderit, si edhe me anë të të cilit ankimuesi ka qenë në dijeni të mënyrës së përmbushjes së tij.
Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për zhvillimin e një procedure prokurimi ndaj edhe përcaktimi i kritereve dhe kërkesave të dokumentave të tenderit bëhet në përputhje me objektin dhe natyrën e saj.
III.2.13. Në lidhje me dokumentin e lëshuar nga Ujësjellës Kanalizime Devoll sh.a., nga verifikimet e kryera në faqen zyrtare të Entit Rregullator të Ujit, konstatohet se Ujësjellës Kanalizime Devoll sh.a. është pajisur me Vendimin nr. 51, datë 23.11.2017 "Për licencimin e SH.A. Ujësjellës Kanalizime Devoll", lëshuar nga Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura, Komisioni Kombëtar Rregullator, nëpërmjet të cilit autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategorinë: Kategoria A për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik; Kategoria C, për largimin e ujërave të ndotura.
Kjo licencë rezulton të jetë dhënë bazuar në nenin 14, pika 1/a dhe neni 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", si edhe në VKM nr. 958, date 06.05.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence", në të cilët përcaktohet përkatësisht:
Neni 14 pika 1/a e ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 përcakton se:
*"Kompetenca të përgjithshme të komisionit*
*(1) Për të përmbushur mandatin e tij sipas këtij ligji, komisioni do të ketë kompetencat e mëposhtme:*
*a) të japë licensa për entet komerciale që janë të angazhuara në kryerjen e shërbimit të furnizimit me ujë në të mirë të popullatës;*

Neni 17 po në këtë ligj përcakton se:

*Dhënia e licencave nga komisioni*
*(1) Komisioni, pas aplikimit të bërë në atë formë që ka caktuar ai vetë dhe pas pagesës së një tarife nga aplikanti, jep*
*licencën e cila autorizon një person të kualifikuar që:*
*a) të grumbullojë dhe të trajtojë ujin në impiantet e tij;*
*b) të shpërndajë ujin për konsum publik;*
*c) të largojë dhe të përpunojë ujërat e ndotura.*
*(2) Kategoritë e licencave dhe procedurat e aplikimit për licenca do të përcaktohen me një urdhër të veçantë të Këshillit*
*të Ministrave.*
*(3) Komisioni ka të drejtë të modifikojë apo të bëjë amendamente në licenca, gjithnjë duke i dhënë mundësi të*
*licencuarit të shprehë mendimet e tij për këto ndryshime.*

Vendimi nr. 958, datë 6.5.2009 "*Për miratimin e kategorive të licencave dhe të procedurave të aplikimit për licencë, të personave, fizikë dhe juridikë, që ushtrojnë veprimtari në sistemet e*

*furnizimit me ujë dhe të largimit e përpunimit të ujërave të ndotura",* përcakton ndërmjet të tjerave se:

*"Këshilli i Ministrave vendosi:*

*1. Miratimin e kategorive të licencave për personat fizikë dhe juridikë, që ushtrojnë apo do të ushtrojnë veprimtari në menaxhimin e sistemeve të furnizimit me ujë dhe të largimit e përpunimit të ujërave të ndotura si më poshtë vijon:*

*a) Kategoria A për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;*

*b) Kategoria B për përpunimin e ujit për konsum publik*

*c) Kategoria C për largimin e ujërave të ndotura;*

*ç) Kategoria D për përpunimin e ujërave të ndotura.*

*2. Personat fizikë apo juridikë, për t'u pajisur me licencë për ushtrimin e veprimtarisë në sistemet e furnizimit me ujë dhe të largimit e përpunimit të ujërave të ndotura duhet të dorëzojnë, pranë ERRU-së, dokumentet e mëposhtme[...]".*

III.2.14. Sa më sipër, nisur nga pretendimi i ankimuesit, referuar licencës së lëshuar nga ERRU konstatohet se veprimtaria e Ujësjellës Kanalizime Devoll sh.a., është për kategorinë A për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik dhe Kategorinë C për largimin e ujërave të ndotura, e si rrjedhim në këtë rast vetë Ujësjellës Kanalizime Devoll sh.a. ushtron aktivitet bazuar vetëm në këto dy kategori: atë të grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik dhe atë të largimit të ujërave të ndotura, pra është me një funksion të përcaktuar e të kufizuar sipas kategorive të miratura në licencën përkatëse, ndërkohë që për përdorimin e burimeve ujore lëshohen leje dhe autorizime nga organet e Këshillit të Basenit Ujor, i cili ka detyrë funksionale sigurimin për ruajtjen dhe zhvillimin sa më racional të burimeve ujore brenda kufijve të basenit përkatës ujor; shpërndarjen e drejtë të burimeve ujore brenda kufirit të basenit përkatës ujor, sipas qëllimeve të përdorimit dhe drejtimin e administrimin e efektshëm të tyre; mbrojtjen e burimeve ujore nga ndotjet, shpërdorimet dhe dëmtimet që prekin cilësinë dhe sasinë e tyre.

Marrëdhënia që operatori ekonomik ankimues mund të ketë me Ujësjellës Kanalizime Devoll sh.a. mund të jetë në cilësinë e konsumatorit, marrëdhënie që nuk është e ndaluar, por që në këtë rast ankimuesi shfaqet si çdo konsumator tjetër familjar, subjekt privat etj., por që nuk mund të lejohet për përdorimin e burimeve ujore në kuptim të ligjit si më sipër cituar përsa kohë që nuk është i pajisuar me lejen / autorizimin e lëshuar nga organi kompetent përkatës i caktuar për këtë qëllim.

Për sa më sipër, rezulton se, operatori ekonomik ankimues nuk ka arritur të përmbushë kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, pasi ka mungesë në dokumentacion dhe mungesa e qoftë edhe të një dokumenti të vetëm e bën ofertën të pavleshme.

III.2.15. KPP gjykon se në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte pretendime në lidhje me kërkesën e mësipërme të autoritetit kontraktor, ka patur në dispozicion momentin procedurial të paraqitjes së ankesës në lidhje me pretendimet e tij parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP, ku parashikohet se *"Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik.*

*Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor*

*mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni".*

Gjithashtu, në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ai mund të paraqiste kërkesë për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave të parashikuar nga neni 42 i LPP-së, ku parashikohet se: *" [...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkese për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave.*

*Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]".*

Rrjedhimisht, sa më sipër argumentuar, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues "Alko Impex General Construction" sh.p.k. nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se arsyeja e skualifikimit: "- *Në pikën 3.3.10 të kritereve të vecanta të kualifikimit për lotin 1 është përcaktuar: "Shoqeria ofertuese duhet te disponoje dokumentacion qe per realizimin e kesaj kontrate te kete keto mjete (ne pronesi ose qira): b. Kamion me kapacitet transportues 15 - 25 ton 2 cope (ne pronesi ose me qira)" Bazuar në dokumentacionin e paraqitur në SPE prej shoqërisë "ALKO-IMPEX GENERAL CONSTRUCTION" dhe të shoqëruar me deklaratën përkatëse, ka paraqitur mjetet me targa AA081RS, AA539TI, AA631PB, AA865SD, AA871SD për të përmbushur kriterin 3.3.10.b. Sikurse u sqarua edhe më sipër për këto mjete nuk ka paraqitur dokumentin për taksat vjetore, por nga verifikimet e kryera zyrtarisht në Autoritetet Kontraktore ku ky subjekt ushtron aktivitet të ngjashëm me objektin e prokurimit rezulton se:*

*• Mjeti me targa AA081RS i deklaruar në deklaratën e mjeteve të paraqitur në Bashkinë Vlorë si kamion me kapacitet transportues 15 – 25 ton, bazuar në lejen e qarkullimit të paraqitur rezulton se është me kapacitet 27 ton (40000 kg me ngarkesë – 12912 kg pa ngarkesë). Ky mjet është mbi kapacitetin transportues të kërkuar në kriterin e kualifikimit",* nuk qëndron, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.3.1. Në dokumentat e tenderit Shtojca 9, pika 3.3. Kapaciteti teknik, pika 11 është përcaktuar kriteri:

"

1. *Shoqeria ofertuese duhet te disponoje dokumentacion qe per realizimin e kesaj kontrate te kete keto mjete (ne pronesi ose qira):*
   a. *Mjete/makina teknologjike per terheqjen e mbetjeve urbane me kapacitet mbajtes 8-15 m3 me raport kompaktimi 1:4-1:6 8 cope (ne pronesi ose me qira)*
   b. *Kamion me kapacitet transportues 15 - 25 ton 2 cope (ne pronesi ose me qira)*
   c. *Mjete me kapacitet 800 kg - 1,5 t 3 cope (ne pronesi ose me qira)*
   d. *Mjete autobote me kapacitet mbajtes 16-18 m3 4 cope (ne pronesi ose me qira)*

e. *Autofshesa* *3 cope (ne pronesi ose me qira)*
f. *Mjet te posacem me goma qe kryen funksionin fshirje dhe larje njekohesisht 1 cope (ne pronesi ose me qira)*
g. *Fadrome me goma* *2 cope (ne pronesi ose me qira)*
h. *Buldozier me zinxhire* *1 cope (ne pronesi ose me qira)*
i. *pajisje lavazhoje + gjenerator* *2 cope (ne pronesi ose me qira)*

- *Keto mjete duhet te jene te pajisur me dokumentacion sipas legjislacionit ne fuqi. Per mjetet qe jane me qira duhet te paraqitet edhe kontrata e qirase me nje afat vlefshmerie jo me pak se nje vit. Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), policen e sigurimit, taksat vjetore te mjetit, si dhe lejen e transportit nga bashkia per vete ose te trete.*
- *Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara.*
- *Mjetet duhet te paraqiten ne formen e nje deklarate ku te percaktohen targat, lloji, numri i shasise.*
- *Ne rast se mjetet jane me kontrata qiraje, afati i tyre duhet te jete minimalisht nje vit nga dita e lidhjes se kontrates.*

III.3.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik ankimues rezulton se është paraqitur në sistemin e prokurimeve elektronike:

- Deklaratë mbi disponimin e makinerive në të cilën janë deklaruar mjetet në pronësi dhe me qera ku janë deklaruar mjetet si më poshtë vijon:

| Ne pronesi | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Lloji i Mjetit** | **Targa** | **Nr. Lejes qarkullimit** | **Nr. Shasise** | **Te tjera** |
| Mjete teknologjike per terheqjen e mbetjeve urbane me kapacitet mbajtes 8-15 m3 | AA 630 PB | TRDA 5653216 | VF622AXB000100590 | |
| Mjete teknologjike per terheqjen e mbetjeve urbane me kapacitet mbajtes 8-15 m3 | AA 632 PB | TRDA 5653416 | VF622AXB000100100 | |
| Mjete teknologjike per terheqjen e mbetjeve urbane me kapacitet mbajtes 8-15 m3 | AA 633 PB | TRDA 5653816 | VF622AVA000103496 | |
| Mjete teknologjike per terheqjen e mbetjeve urbane me kapacitet mbajtes 8-15 m3 | AA 634 PB | TRDA 5653916 | VF622AVA000103483 | |
| Mjete teknologjike per terheqjen e mbetjeve urbane me kapacitet mbajtes 8-15 m3 | AA 864 SD | TRDA 3606917 | VF629CHB000000373 | |
| Mjete teknologjike per terheqjen e mbetjeve urbane me kapacitet mbajtes 8-15 m3 | AA 526 TI | TRDA0904818 | VF622AVA000108725 | |
| Kamion Pastrimi | AA 865 SD | TRDA 3607117 | VF644AHH000001717 | |
| Kamion Pastrimi | AA 871 SD | TRDA 3644217 | VF629AHB000000200 | |
| Kamion Pastrimi | AA 631 PB | TRDA 5653316 | VF622AXB000100090 | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Kamion Pastrimi | AA 539 TI | TRDA 0925518 | VF622ACB000102434 | |
| Kamion me kapacitet transportues 15 - 25 ton | AA 081 RS | TRDA 2275317 | VF622CVA000109072 | |
| Mjete me kapacitet 800 kg - 1,5 t | AA 675 PI | TRDA 6542416 | WF0CXXGBFC1B7715 4 | |
| Mjete me kapacitet 800 kg - 1,5 t | AA 047 KM | TRDA 9429814 | Wf0FXXBDFF8B65738 | |
| Mjete me kapacitet 800 kg - 1,5 t | AA 618 GM | TRF 0659313 | SFAAXXBDYASL1621 4 | |
| Autobot | AA 149 NZ | TRDA 2655616 | ZÇFA1TJ0102371804 | |
| Autobot | AA 593 MS | TRDA 8969915 | VF622AVA000108492 | |
| Autobot | AA 629 RD | TRDA 1469417 | VF622ACA000106087 | |
| Autobot | AA 863 SD | TRDA 3606817 | VF622AVA000108492 | |
| Autofshesa | AA 198 TI | TRDA0903418 | VF644CA000013207 | |
| Autofshesa | AGMT 47 | TRDA0924918 | SA92V4CXX73068384 | |
| Autofshesa | AGMT 48 | TRDA0925018 | SA92V5CXXA4068157 | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Mjet te posacem me goma qe kryen funksionin fshirje dhe larje njekohesish | AA 857 XM | TRDA 0901518 | VF644ACA000013903 | |
| Fadrome me goma | ADMT03 | TRDA5197619 | CAT0432DCWEP01979 | |

Dhe

| Me qera | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Lloji i Mjetit** | **Targa e mjetit** | **Nr. Lejes së qarkulli mit të mjetit** | **Nr. Shasisë së mjetit** | **Nr. Kont së qerasë (noterisë)** | **Afati i kontratës së qerasë (Data e fillimit dhe mbarimit)** |
| Mjete teknologjik e per terheqjen e mbetjeve urbane me kapacitet mbajtes 8-15 m3 | AA 786YT | TRDA51 99419 | VF622AVA0 00108727 | NR.9777REP. NR.6808KOL. | 5 vjet |
| Mjete teknologjik e per terheqjen e mbetjeve urbane me kapacitet mbajtes 8-15 m3 | AA391Z I | TRDA61 30819 | VF629CHB00 0000969 | NR.9777REP. NR.6808KOL. | 5 vjet |
| Mjete teknologjik e per terheqjen e mbetjeve urbane me kapacitet mbajtes 8-15 m3 | AA 875XI | TRDA13 45919 | VF624APB00 0000053 | NR.9777REP. NR.6808KOL. | 5 vjet |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Mjete teknologjike per terheqjen e mbetjeve urbane me kapacitet mbajtes 8-15 m3 | AA 392ZI | TRDA6130919 | VF622ACB000101561 | NR.9777REP. NR.6808KOL. | 5 vjet |
| Autobot Uji | AA634 YP | TRDA4304119 | VF644AHL000003774 | NR.9777REP. NR.6808KOL. | 5 vjet |
| Mjet me kapacitet 1.4 t | AA 631YP | TRDA4297319 | VF1HDC1K639618357 | NR.9777REP. NR.6808KOL. | 5 vjet |
| Mjet me kapacitet 1.4 t | AA 632YP | TRDA4298419 | VF1HDCUK632858347 | NR.9777REP. NR.6808KOL. | 5 vjet |
| Mjet me kapacitet 1.4 t | AA 633YP | TRDA4298819 | VF1HDCUK635552524 | NR.9777REP. NR.6808KOL. | 5 vjet |
| Mjete autobote me kapacitet mbajtes 16-18 m3 | 03-601-XB | 0901561 | WKK69600001010281 | Bashkangjitur ne sistem me kontrate Dt:12.12.19 | Afat 1 vjecar me te drejte me mundesi riperteritje |
| Mjete autobote me kapacitet mbajtes 16-18 m3 | 03-813-CB | 0534613 | WDB65802815910817 | Bashkangjitur ne sistem me kontrate Dt:12.12.19 | Afat 1 vjecar me te drejte me mundesi riperteritje |
| Mjete autobote me kapacitet mbajtes 16-18 m3 | 03-335-EO | 0729708 | 0729708 | Bashkangjitur ne sistem me kontrate Dt:12.12.19 | Afat 1 vjecar me te drejte me mundesi riperteritje |
| Mjete autobote me kapacitet mbajtes 16-18 m3 | 03-713-AK | 0992612 | WDB62500915455196 | Bashkangjitur ne sistem me kontrate Dt:12.12.19 | Afat 1 vjecar me te drejte me mundesi riperteritje |
| Mjete autobote me kapacitet | 03-621-XB | | 76711722 | Bashkangjitur ne sistem me kontrate Dt:12.12.19 | Afat 1 vjecar me te drejte me mundesi riperteritje |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| mbajtes 16-18 m3 | | | | | |
| Mjete autobote me kapacitet mbajtes 16-18 m3 | TR6550T | TRF1423415 | WDB9502031K378227 | Nr.Rep:9623 Nr.Kol: 6684 | 3 vjet me te drejte riperteritje 3 te tjera |
| Mjete autobote me kapacitet mbajtes 16-18 m3 | AA619SM | DRD1610417 | YS2R6X20031294044 | Nr.Rep:9626 Nr.Kol: 6687 | 3 vjet me te drejte riperteritje 3 te tjera |
| Mjete autobote me kapacitet mbajtes 16-18 m3 | AA620SM | DRD1610207 | YV2J4CKC93A571184 | Nr.Rep: 9626 Nr.Kol: 6687 | 3 vjet me te drejte riperteritje 3 te tjera |
| Mjete autobote me kapacitet mbajtes 16-18 m3 | AA568SJ | TRDA4190217 | WMAH17ZZZ3W050818 | Nr.Rep: 9603 Nr.Kol: 6674 | 3 vjet me te drejte riperitje 3 te tjera |
| Paisje lavazhi+Gjeneratore | | | | Nr. 9778Rep. Nr.6809 Kol. | 5 VJET |
| Buldozer | | | | Nr. 9778Rep. Nr.6809 Kol. | 5 VJET |
| Kamion 20 t | AA853NJ | TRF0549316 | WJMS3TSS00C003254 | Nr. 9778Rep. Nr.6809 Kol. | 5 VJET |
| Fadrome me goma | AFMT29 | VLD0264817 | JCB3XCPCK60975027 | Nr. 9778Rep. Nr.6809 Kol. | 5 VJET |
| Gjenerator 4 cope | | | | Nr. 9778Rep. Nr.6809 Kol. | 5 VJET |
| Kamioncine | AA564RD | TRDA1459817 | WDB9061351N535338 | Nr. 9778Rep. Nr.6809 Kol. | 5 VJET |
| Kamioncine | AA565RD | TRDA1461417 | WDB9062331N530586 | Nr. 9778Rep. Nr.6809 Kol. | 5 VJET |
| Kamioncine | AA710TG | TRDA0586418 | WDB9062531N371617 | Nr. 9778Rep. Nr.6809 Kol. | 5 VJET |
| Fadromw | ACMT06 | TRDA2706315 | 940107 | Nr. 9349Rep. Nr.2908.1 Kol. | 5 VJET |

III.3.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike në përmbushje të këtij kriteri operatori ekonomik ankimues, referuar deklaratës së mësipërme, ndërmjet të tjerave është paraqitur dokumentacioni si më poshtë:

Mjete në pronësi:

- Kamion pastrimi (sipas emërtimit tek deklarata) - Leje qarkullimi për mjetin me targë AA 539 TI me kapacitet mbajtës 6.85 ton, shoqëruar me policë sigurimi, çertifikatë e kontrollit teknik, foto;
- Kamion pastrimi (sipas emërtimit tek deklarata) - Leje qarkullimi për mjetin me targë AA 631 PB me kapacitet mbajtës 5.8 ton, shoqëruar me policën e sigurimit, çertifikatë pronësie, çertifikatë e kontrollit teknik, foto;

- Kamion pastrimi (sipas emërtimit tek deklarata) – Leje qarkullim për mjetin me targë AA 865 SD me kapacitet mbajtës 7.85 ton, çertifikatë e kontrollit teknik, policë sigurimi, çertifikatë pronësie, foto;
- Kamion pastrimi (sipas emërtimit tek deklarata) – Leje qarkullimi për mjetin me targë AA 871 SD me kapacitet mbajtës 7.44 ton, çertifikatë e kontrollit teknik, policë sigurimi, çertifikatë pronësie, foto
- Kamion me kapacitet transportues 15-25 ton (sipas emërtimit tek deklarata) – Leje qarkullimi për mjetin me targë AA 081 RS me kapacitet transportues 27,088 ton, çertifikatë e kontrollit teknik, policë sigurimi, çertifikatë pronësie, çertifikatë transport mallrash për llogari të vet në përdorim të Alko Impex General Contruction;

  Me qera:

1. Kamion 20 t (sipas emërtimit tek deklarata) – Kontratë Qiraje nr.9778 rep, nr. kol. 6809, datë 20.12.2019, me palë qiradhënëse shoqëria "2T" sh.p.k. dhe qiramarrës shoqëria "Alko Impex General Contruction" sh.p.k., objek i së cilës ndër të tjera është edhe dhënia me qera e mjetit me targë AA 853 NJ, shoqëruar me leje qarkullimi me kapacitet mbajtës 20.1 ton, policë sigurimi, çertifikatë e kontrollit teknik, taksa vjetore e datës 13.12.2018, çertifikatë për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet në përdorim të shoqërisë "2 T" sh.p.k., foto.

III.3.4. Në nenin 46, pika 1, gërma "b" të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: "*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese".*

III.3.5. Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, parashikohet: "*Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...".*

III.3.6. Neni 28, pika 5 e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

*Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:*

*a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*

*b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose*

*c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*

*ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

*d) Në rastin e procedurës së prokurimit "Shërbim konsulence", stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.*

III.3.7. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, një ndër parimet kryesore të përzgjedhjes referuar edhe nenit 2 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar është edhe mosdiskriminimi dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve.
III.3.8. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.
III.3.9. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të paraqitur nga ankimuesi për përmbushjen e kriterit për makineritë dhe mjetet, konkretisht ato të deklaruara prej tij në deklaratën mbi disponimin e makinerive, si edhe dokumentacionit të paraqitur për mjetet e deklaruara, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se ka mangësi në përmbushje të kriterit sipas përcaktimit të bërë në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor.
Konkretisht ka mangësi në plotësimin me dokumentacion, pasi për mjetet e mësipërme nuk janë paraqitur të gjitha dokumentat e kërkuar dhe ka mangësi në dokumentacion të tilla si certifikatë e transportit nga bashkia për vete ose të tretë. Nga mjetet e deklaruara në deklaratën mbi disponimin e makinerive, si edhe referuar dokumentacionit të tyre dhe konkretisht lejes së qarkullimit, rezulton se mjeti me targë AA 081 RS, i cili është deklaruar në deklaratën e disponimit të makinerive të ngarkuar në sistemin e prokurimeve elektronike nga ankimuesi si mjet me kapacitet 15 – 25 ton, referuar parametrave të mjetit të përshkruara në lejen e qarkullimit, ndërmjet të cilave edhe kapaciteti mbajtës referuar të dhënave me numër rendor 23 dhe 24 që janë përkatësisht masa maksimale e autorizuar (kg) dhe masa e mjetit bosh (kg), nuk është me kapacitetin e kërkuar në dokumentat e tenderit, pasi kapaciteti mbajtës i mjetit me targë AA 081 RS është 27.088 ton. Fakti se mjeti me targë AA 081 RS është me kapacitet mbajtës më shumë se ai i kërkuar në dokumentat e tenderit nga ana e autoritetit kontraktor, pasi fakti i mosplotësimit të kriterit sipas përcaktimeve të dokumentave të tenderit është i pranuar edhe nga ana e vetë operatorit ekonomik ankimues, i cili, në ankesën e paraqitur pretendon se, ky është një devijim i vogël dhe se janë ndryshime të cilat në thelb nuk ndryshojnë karakteristikat e mjetit apo kapacitetit të tyre. Gjithashtu edhe mjetet e tjera, të listuara më lart, kanë mangësi fizike të dokumentacionit, pasi nuk janë sipas përcaktimit në dokumentat e tenderit: çertifikata e transportit nga bashkia për vete ose për të tretë nuk është në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi, pasi disa e kanë mangësi fizike, ndërsa disa të tjera dhe konkretisht mjeti me targë AA853NJ i cili është mjet me qera, çertifikata e transportit lëshuar nga Bashkia është për llogari të vet, në kundërshtim me përcaktimet ligjore në ligjin 8378 datë 22.07.1998 "Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe ligji nr. 8308, datë 18.03.1998 "Për transportet rrugore".

Konkretisht, në nenin 81, pika 1, 2, 3, 4, 5 dhe 7, 8 "*Destinacioni dhe Përdorimi i Mjeteve*" i ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 "*Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar parashikohet se:
*"[...] 1. Me destinacion të mjetit nënkuptohet përdorimi i tij në bazë të karakteristikave teknike.*
*2. Me përdorim të mjetit nënkuptohet shfrytëzimi i tij ekonomik*
*3. Mjetet mund të caktohen për përdorim vetjak ose për përdorim nga të tretët.*
*4. Quhet përdorim nga -të tretët kur mjetet shfrytëzohen, kundrejt pagesës përkatëse, nga persona të tjerë të ndryshëm nga titullari i lejes së qarkullimit. Për rastet e tjera nënkuptohet përdorimi vetjak i mjetit.*
*5. Përdorimi nga të tretët përfshin: a) dhënien me qira pa drejtues mjeti; b) dhënien me qira me drejtues mjeti dhe shërbimi taksi për transport njerëzish; c) shërbimin e linjës për transport pasagjerësh; d) shërbimin e transportit të mallrave për llogari të të treteve; e) shërbimin e linjës për transportin e mallrave; f) shërbimin taksi për transportin e mallrave për llogari të të tretëve.*
*....*
*7.Në aktet në zbatim janë përcaktuar karakteristikat konstruktive të mjetit në lidhje me destinacionin ose përdorimet, për të cilat ai mund të caktohet.*
*8. Duke përjashtuar dispozitat e ligjeve të posaçme, cilido që shfrytëzon një mjet me një destinacion ose për një përdorim të ndryshëm nga ato të treguara në lejen e transportit, ndëshkohet me masë dministrative me gjobë nga pesë mijë deri në njëzet mijë lekë. [...]".*
Në nenin 3, pargrafi 3.13 dhe 3.14 të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998 "Për transportet rrugore", i ndryshuar, parashikohet se: *"[...] 3.13. Transport për vete: transporti i mallrave me kamion, në ardhje ose në kthim, vetëm për llogari të veprimtarisë së vet. Në këtë rast transporti është vetëm një veprimtari ndihmëse e veprimtarisë kryesore, e cila vërtetohet sipas ligjeve në fuqi. 3.14. Transport për të tretë dhe me qira: transporti i mallrave me kamion për persona fizikë a juridikë të tjerë ose dhënia e kamionit me qira. [...]".*
Në nenin 41, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998 "Për transportet rrugore", i ndryshuar, parashikohet se: "*Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse."*
III.3.10. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, ligji "Për Transportet Rrugore", bën qartësisht ndarjen midis çertifikatës së lëshuar për "Transport për vete" përmes të cilës subjektet mund të kryejnë transport të mallrave me kamion, në ardhje ose në kthim, vetëm për llogari të veprimtarisë së vet, ku në këtë rast transporti është vetëm një veprimtari ndihmëse e veprimtarisë kryesore, e cila vërtetohet sipas ligjeve në fuqi; si edhe çertifikatës së lëshuar për "Transport për të tretë dhe me qira" përmes të cilës subjektet mund të kryejnë transport të mallrave me kamion për persona fizikë a juridikë të tjerë ose dhënia e kamionit me qira. Në rastin konkret përmes dokumentacionit të dorëzuar vërtetohet se çertifikata e mjetit të sipërcituar të marrë me qera, i cili sipas lejes së qarkullimit e disponon shoqëria qeradhënëse, është specifike dhe lëshuar vetëm për transport për vete, përmes së cilës është i licencuar vetëm ky subjekt qeradhënës dhe është dhënë në përdorim në emër të personave fizikë qeradhënës, për transport të mallrave me kamion, brenda vendit, vetëm për llogari të veprimtarisë së vet. Në këtë mënyrë, kryerja e transportit nga ana e shoqërisë "Alko Impex General Construction" d.sh.h. të mallrave/shërbimeve me kamionët e shoqërise qeradhënëse do të jetë në kushtet e kryerjes së transportit të mallrave me qira dhe për të tretë pa licencën përkatëse, transport i cili në zbatim të nenit 41 të ligjit "Për Transportet Rrugore" është i ndaluar.

K.P.P gjykon se certifikata e mësipërme është pjesë e dokumenteve të nevojshme që vërtetojnë se mjeti është në përdorim nga operatorët ekonomikë. Mungesa e këtij dokumenti, vërteton vetëm faktin se mjeti mund të jetë në pronësi, por përdorimi i tij do të ishte i pamundur në zbatim të dispozitave të sipërcituar të Kodit Rrugor të RSh-së dhe të ligjit "Për Transportin Rrugor", pasi mjetet nuk do të kishin mundësi të qarkullonin.

III.3.11. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, operatori ekonomik ankimues nuk e përmbush kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për paraqitjen e dy mjeteve me kapacitet mbajtës 15-25 ton. Konstatohet se, asnjë nga mjetet e deklaruara nga operatori ekonomik si kamion apo kamion pastrimi në shtojcën për deklarimin e makinerive, për të cilët ka paraqitur edhe dokumentacionin përkatës sipas kërkesave të dokumentave të tenderit, plotëson këtë kapacitet përsa i përket kapacitetit mbajtës së parashikuar nga autoriteti në dokumentat e tenderit. Gjykojmë se është barrë e operatorit ekonomik ankimues pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekti shqyrtimi, të vërtetojë se disponon kapacitetet teknike në lidhje me mjetet. Sqarojmë se, kriteri për mjetet duhet parë dhe vlerësuar në tërësinë e tij, me të gjithë elementët e kërkuar dhe përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, pasi, referuar mangësive dhe pasaktësirave të konstatuara në dokumentacion nuk arrihet të plotësohet tonazhi i kërkuar i mjeteve, parë kjo në këndvështrimin e vlerësimit të të gjitha të dhënave të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

III.3.12. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

Në rastin konkret, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike (makineritë), në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumetat e tenderit. Në këto kushte, KPP gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor në pikën 11 të shtojcës 8, "Kapaciteti teknik", në dokumentat standarte të tenderit, nuk mund të konsiderohet i përmbushur, pasi nga ankimuesi nuk është arritur të paraqitet dokumentacioni për disponimin e dy mjeteve me kapacitet transportues 15-25 ton.

III.3.13. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit. Kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor veçanërisht për mjetet dhe kapacitet e tyre duhet të përmbushen nga operatorët ekonomikë pasi në rastin konkret, jo më kot autoriteti konraktor ka përcaktuar kriterin për mjete me kapacitete të ndryshme kjo në përputhje e në përpjesëtim me natyrën, objektin e specifikën e procedurës së prokurimit, pasi në të kundërt nuk do të kishte kuptim ky përcaktim me fasha kapaciteti tonazhi, pasi përcaktimi në rastin në shqyrtim "mjet me kapacitet transportues 15-25 ton" ka kuptimin në interpretimin gjuhësor që duhet të jetë me kapacitet brenda këtij diapazoni, kjo e parë në kushtet ku, kur dhe si do të kryhet shërbimi i pastrimit të qytetit.

III.3.14. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion.Në rastin konkret, dokumentacioni i paraqitur nga ana e ankimuesit në këtë procedurë prokurimi, objekt shqyrtimi, nuk është i rregullt dhe për shkak të mangësive që ka nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe si i tillë konsiderohet i pavlefshëm.

III.3.15. Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, në rast se, operatori ekonomik ankimues do të kishte pretendime në lidhje me kerkesën e mësipërme të autoritetit kontraktor, ka patur në dispozicion momentin procedurial të paraqitjes së ankesës mbi hartimin e dokumenteve dhe kritereve të veçanta të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar parashikohet se "*Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni".*

Gjithashtu, kuadri ligjor, parashikon një sërë elementësh, si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me intepretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kritereve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka në dispozicion momentin procedurial të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, parashikohet se *"[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë 44 sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkese për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]".*

Rrjedhimisht, sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.4. Në lidhje me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues "Alko Impex General Construction" d.sh.h. për skualifikimin e padrejtë të tij, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se nuk kanë ndikim mbi fatin e çështjes, tashmë që nuk i janë pranuar disa prej pretendimeve të tij dhe gjendja faktike e juridike e këtij operatori nuk do të ndryshojë, por do të mbetet i skualifikuar nga procedura e prokurimit në fjalë, e për rrjedhojë duke mos përmbushur interesat e ankimuesit, ndaj edhe nuk do të merren në shqyrtim, për ekonomi të procedurës.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *"Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 "*Për miratimin e rregullave* "*Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*", Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

**Vendos**

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "Alko Impex General Construction" d.sh.h., për procedurën e prokurimit "*Procedurë e hapur",* me nr. *REF-41658-10-30-2019*, Loti I, me objekt "*Shërbimi i pastrimit në Qytetin Vlorë",* me fond limit 584.587.476 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 06.01.2020, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në gjykatën përkatëse për shqyrtimin e mosmarrëveshjes administrative.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 258 Protokolli**
**Datë 02.03.2020**

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

| Anëtar | Anëtar | Anëtar |
|---|---|---|
| **Vilma Zhupaj** | **Lindita Skeja** | **Merita Zeqaj** |

**Nënkryetar**
**Enkeleda Bega**